



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E
MBAJTUR MË 12 QERSHR 2009

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
12. JUNA 2009. GODINE

Qershor – Juni
2009

Seancën e kryesoi **Xhavit HALITI**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Konstatohet që në sallë mjaftojnë deputetët e pranishëm, që janë 54 momentalisht, për ta filluar debatin.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Pikë e veçantë e rendit të ditës për seancën e sotme është:

- **Shqyrtimi i Raportit financiar të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008**

Pjesa e mbetur e pakryer e seancës së djeshme, sipas vendimit që është marrë në Kryesi, vazhdon pas përfundimit të kësaj pike për arsyet që dihen. Grupet parlamentare kanë qenë të interesuara që të debatohet prej mëngjesit, do të thotë të startohet me pikë të veçantë për raportin financiar, prandaj po e zbatojmë vendimin e Kryesisë. Mocion nuk ka pasur për ta ndryshuar vendimin.

Raporti financiar për buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 u është dhënë dhe shpërndarë deputetëve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin dhe ka rekomanduar që të procedohet për diskutim dhe miratim në seancë plenare.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin financiar për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008. E ka fjalën zoti Shala, ministër i Ekonomisë dhe Financave.

MINSITRI AHMET SHALA: I nderuar, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar të pranishëm,

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që para jush sot të paraqes Raportin financiar të Buxhetit të Kosovës për vitin 2008.

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësi, numër 03-L/48, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave paraqet përmes Qeverisë Raportin e Buxhetit të vitit 2008 dhe konsideroj që ky buxhet paraqet performancën e të gjitha institucioneve të Kosovës gjatë vitit 2008, çmimet e të cilave ne i kemi proceduar me kohë të ju dhe të cilat do përpiqem që në pika të shkurtra t'i referoj këtu para jush.

Përveç të arriturve përmbajtjesore në strukturën e buxhetit të aprovuar në muajin shkurt të vitit 2008, e veçanta e këtij raporti është se prezanton performancën e pakontestueshme të institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të pasurisë së taksapaguesve kosovarë.

Në muajin shkurt të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka aprovuar Rregulloren 2008/13 për Buxhetin e vitit 2008 si dhe në muajin gusht rishikimin buxhetor

me ligjin numër 03-L/93. Plani buxhetor i të hyrave vjetore për vitin 2008 ka qenë 880.900.000 euro. Plani buxhetor për shpenzimet vjetore ka qenë 1 miliard e 177.944 euro, duke përfshirë të hyrat vetjake të bartura nga viti 2007 të cilat nuk janë planifikuar me Rregulloren e Buxhetit.

Më lejoni t'i shpreh disa veçori kualitative të këtij raporti dhe në përgjithësi të menaxhimit të financave publike gjatë vitit 2008.

Në përgjithësi gjatë vitit 2008 reflektohen ngritje substanciale të hyrave: tejkalim i planit të hyrave, ngritje kualitative në kategorinë e investimeve kapitale, ngritje simbolike e shpenzimeve në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, përkundër zgjerimit të dukshëm të fushëveprimit të institucioneve të reja të Republikës së Kosovës, si rezultat, natyrisht, i marrjes së përgjegjësisë shtesë dhe i zgjerimit të institucioneve të Kosovës brenda dhe jashtë vendit. Andaj, më lejoni që të paraqes një përmbledhje të këtij raporti të pasqyruar në formë analitike dhe të krahasuar me periudhën në fjalë.

Të hyrat, përkatësisht pranimet.

Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2008, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve, si dhe Fondin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit, përkatësisht Agjencionit Kosovar të Privatizimit kanë qenë 942.525.000 euro dhe paraqesin se 106% të hyrave të përgjithshme vjetore të planifikuara. Kjo tregon një rritje vjetore të hyrave prej 6%, krahasuar me planin vjetor, ndërsa një ngritje prej 14%, krahasuar me vitin 2007.

Të hyrat e mbledhura në kufij, përkatësisht nga Dogana, arrijnë 64% të hyrave të përgjithshme dhe kapin shumën prej 604.196.000 euro, gjë që tregon tejkalim të planit për 4% dhe 13,7% tejkalim të planit karshi vitit paraprak.

Të hyrat e brendshme, përkatësisht të hyrat e mbledhura nga Administrata Tatimore, arrijnë 21% të hyrave të përgjithshme dhe shprehur në masë monetare kanë qenë 200.834.000 euro. Edhe në këtë kategori të hyrave është tejkaluar plani për 4% dhe është tejkaluar një ngritje prej 10%, karshi me vitin paraprak.

Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë me 5% në shumën prej 42.784.000 euro, me një tejkalim të planit buxhetor prej 12% dhe një tejkalim në vitin paraprak për 46,3%. Konsideroj se këtu kanë qenë të arriturat më të suksesshme në gjithë të hyrat e brendshme.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror në totalin e përgjithshëm të hyrave marrin pjesë më 3% dhe janë në shumën prej 29.66.000 euro, ndërsa krahasuar me vitin paraprak kanë pasur një ngritje prej 13%.

Të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 7% të hyrave të përgjithshme dhe janë në shumën prej 65.645.000, që paraqet një tejkalim të planit buxhetor për 29%. Në kuadër të kësaj kategorie bëjnë pjesë edhe të hyrat dhe gjobat të cilat mblidhen nga komunat dhe evidentohen si të hyra jo tatimore, krahasuar me vitin paraprak rritja ka qenë 11,4%.

Më lejoni që t'i përmbledh në përgjithësi të hyrat, qoftë nga kufijtë, qoftë nga të hyrat e brendshme, kanë pasur një ngritje të konsiderueshme dhe kjo konsideroj se ka qenë një

meritë e të gjithë qytetarëve të Kosovës, e Qeverisë së Kosovës dhe e të gjitha institucioneve dhe ngritje e vetëdijes dhe efikasitetit të gjithë juve të pranishëm këtu për të mbështetur Qeverinë e Kosovës në përkushtimin e saj për performancë më të mirë.

Më lejoni tani t'i paraqes shpenzimet, përkatësisht të dalat. Të dalat gjatë vitit 2008, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve dhe fondet e mirëbesimit, kanë qenë 950.526.000 euro dhe paraqesin 80,7% të planit të përgjithshëm vjetor. Krahësuar me vitin paraprak shihet një rritje kualitative vjetore e të dalave prej 44%, kryesisht në kategorinë e investimeve kapitale që kanë tejkaluar vitin paraprak prej 124%.

Të dalat nga kategoria e pagave dhe e mëditjeve, janë 227. 091.000 euro ose 24% të dalave të përgjithshme, ndërsa krahasuar me planin vjetor për këtë kategori ato janë realizuar 96%. Në vitin 2007 shpenzimet në këtë kategori kanë qenë 208.000.000 euro.

Të dalat nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë 139. 371.000 eurove ose 15% e të dalave të përgjithshme, me një realizim prej 83% të planit vjetor.

Të dalat në kategoritë e shërbimeve komunale janë në shumën prej 13.481.000 euro apo 2% e të dalave të përgjithshme, ndërsa realizimi ndaj planit ka qenë 86%.

Subvencionet e transferet janë 209.769.000 euro ose 22% të dalave të përgjithshme, me një realizim vjetor prej 95%.

Shpenzimet kapitale kapin shumën prej 347.103.000 euro ose 37% e të dalave të përgjithshme dhe një realizim vjetor prej 80%, përkatësisht një tejkalim krahasuar me vitin paraprak për 124%.

Grandet e përcaktuara të donatorëve.

Fondi i granteve të përcaktuara të donatorëve të bartura nga viti 2007 në vitin 2008 ka qenë 11.274.000 euro, ndërsa, të hyrat nga grandet gjatë vitit 2008 janë në shumë prej 17.685.000 euro. Fondi i përgjithshëm i granteve të përcaktuara për vitin 2008, duke përfshirë edhe bartjet nga viti 2007, është në shumën prej 28.959.000 euro. Nga ky fond, gjatë vitit 2008 janë shpenzuar 15.826.000 euro dhe janë bërë kthime në shumë prej 335.000 euro dhe gjendja e fondeve të granteve të përcaktuara të donatorëve më 31.12.2008 është prej 12.798.000 euro.

Gjendja e fondeve në përgjithësi, pra më 31.12.2008 ka qenë si vijon:

- Fondi i donatorëve 12.798.000 euro,
- Të hyrat vetjake 35.690.000 euro,
- Huaja e KEK-ut 70.689.000 euro,
- Fondi i AKM-së, përkatësisht i AKP-së 403.546.000 euro.

Ju e dini që AKM ka funksionuar deri më 30 qershor të vitit të kaluar dhe pastaj është transferuar në Agjencionin Kosovar të Privatizimit.

- Fondet e tjera në mirëbesim, 12. 956.000 euro.

Nga kjo shihet se gjendja e fondeve në Bankën Qendrore të Kosovës, përkatësisht të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës në Bankën Qendrore, më 31 dhjetor 2008, është në

shumën prej 288.000.372 euro, shumë e cila ka destinacionet e caktuara sipas Buxhetit të aprovuar për vitin 2009.

Në fund më lejoni të them se raporti është edhe një tregues lehtësisht i matshëm për suksesin e institucioneve të Republikës së Kosovës në këtë periudhë raportuese dhe një dëshmi e pakontestueshme për potencialin në rritje në rrugëtimin e sforcimit të pushtetit të Kosovës me qëllim të arritjes së misionit tonë të gjithëmbarshtëm për ngritjen e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A do ta vazhdojë edhe pak? Faleminderit! Sipas radhës fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit zoti kryesues!

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin për shpenzimet e buxhetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2008 dhe ka ardhur në këto përfundime, se ky raport i plotëson kushtet ligjore të raportimit të cilat mbështeten në standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe në të gjitha ligjet që përcaktojnë menaxhimin e financave publike të Republikës së Kosovës.

Dua të them këtu që Komisioni për Buxhet dhe Financa ka kërkuar nga Qeveria edhe një material shtesë të këtij raporti, gjë që nuk ka qenë detyrim ose obligim ligjor dhe të cilën kërkesë e ka plotësuar për Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe për të gjithë deputetët, domethënë, listën e të gjitha projekteve kapitale të realizuara në vitin 2008, të ndara sipas agjencioneve shpenzuese buxhetore dhe që shihet qartë, pa dashur t'i përsëris ato që i tha edhe ministri që ka një performancë të mirë, si në aspektin e realizimit të projeksioneve buxhetore, po ashtu edhe në atë të shpenzimeve buxhetore dhe në këtë drejtim Komisioni i ka dhënë mbështetje këtij raporti që të shqyrtohet dhe të miratohet në Kuvend.

Nuk dua të lëshohem në shifra dhe në ato sukseset dhe rezultatet ose mospjekjet që i kemi theksuar edhe në Komisionin për Buxhet, le të mbetet pjesë e diskutimeve të deputetëve në këtë sallë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit. Tani radhën e kanë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritje për ministrat,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar për vitin 2008 dhe përkrah rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa se ky raport teknikisht është më i avancuar dhe është në përputhje me standardet e kontabilitetit.

Nëse i analizojmë me kujdes të gjitha pozicionet dhe bëjmë krahasime me vitet e kaluara, vërehet se është bërë një menaxhim më me efikasitet dhe më me efektivitet i buxhetit.

Nga të dhënat e prezantuara në raport shihet se të hyrat për vitin 2008 kanë pasur një performancë të mirë. Nuk duhet nënvlerësuar tejkalimi i të hyrave në krahasim me atë që është planifikuar për 6%, kurse në krahasim me vitin 2007 për 14%. Jemi mësuar që në raportet që na kanë ardhur në të kaluarën të kemi rënie të hyrave vetjake komunale, kurse në vitin 2008 kemi një rritje të hyrave komunale për 46.3%, në krahasim me vitin 2007.

Janë të dukshme rezultatet në Administratën Tatimore gjatë vitit të kaluar si rezultat i rritjes së vetë deklarimit, transparencës, komunikimit më të mirë me tatimpaguesit që ka reflektuar në rritjen e besueshmërisë tek ata, gjë që ka bërë që të realizohen 10% më shumë të hyra se në vitin paraprak.

Buxheti hartohet nga Qeveria për t'u menaxhuar në mënyrën më të mirë të mundshme tërësia e burimeve financiare publike në favor të përmirësimit të jetës së qytetarëve. Buxheti hartohet për t'u shpenzuar, por problemi është si të shfrytëzohet me eficiencë dhe efikasitet.

Gjatë vitit 2008 janë bërë hapa pozitiv në këtë drejtim, sepse në këtë vit kemi filluar të shkëputemi nga buxheti tërësisht konsumues dhe nëse analizojmë kujdesshëm raportin vërejmë se është bërë një hap pozitiv në drejtim të ndikimit të buxhetit në zhvillimin ekonomik, megjithëse mbetet shumë për t'u bërë që buxheti të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen.

Në vitin 2008 edhe përkundër rritjes së të ardhurave të mësimdhënësve janë shpenzuar 23.8% të mjeteve për paga e mëditje, kurse në vitin 2007 janë shpenzuar 32% të mjeteve të buxhetit për këtë kategori.

14.66% të buxhetit janë shpenzuar për mallra dhe shërbime, kurse në vitin 2007 shpenzime për këtë kategori ka pasur 19% në strukturën e përgjithshme të buxhetit. Për subvencione janë shpenzuar në vitin 2008, 22% të buxhetit, kurse në vitin 2007, 23% të buxhetit.

Në vitin 2007, vetëm 23% të buxhetit janë shpenzuar për investime kapitale, kurse në vitin 2008 janë shpenzuar 36% për investime kapitale, ku në përgjithësi ka një përmirësim të dukshëm në strukturën e shpenzimeve të buxhetit, kërkesë kjo e kamotshme e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në vitin 2008 janë zvogëluar shpenzimet operative dhe janë rritur shpenzimet kapitale për 124.3%, krahasuar me vitin 2007. Pra, në vitin 2007 janë shpenzuar vetëm 154 milionë euro apo 70% e mjeteve të planifikuara për këtë kategori, kurse në vitin 2008 janë shpenzuar 347 milionë euro, çka do të thotë se mjetet e mbledhura nga qytetarët kanë filluar të orientohen në drejtimin e duhur – t'u kthehen atyre në formë të mirave publike.

Se është bërë një menaxhim i mirë i mjeteve, po marr për shembull vetëm disa ministri, investimet e të cilave ndikojnë direkt në jetën e qytetarëve dhe në rrjedhat e zhvillimit ekonomik.

Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, në vitin 2008 ka shpenzuar 90% të buxhetit për shpenzime kapitale, pra, nga 126 milionë ka shpenzuar 114 milionë dhe i ka zotuar edhe 12 milionë euro për projektin në realizim e sipër, kurse nëse bëjmë krahasim me vitin 2007, mjetet për investime kapitale në këtë ministri janë shpenzuar vetëm 51%. Kjo ministri ka pasur në disponim 24.900.000 euro e i ka shpenzuar vetëm 12 milionë, kurse pjesën tjetër të mjeteve e ka dërguar në suficit.

Ministria e Bujqësisë ka shpenzuar mjetet për investime kapitale 94%, nga 4.200.000 euro, ka shpenzuar 3.900.000 euro dhe ka zotuar edhe 258.000 për projekte në vazhdimësi, kurse në vitin 2007 ka shpenzuar vetëm 86% të buxhetit për këtë kategori.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ka shpenzuar buxhetin për investime kapitale 88%. Nga 40 milionë të planifikuara, ka shpenzuar 35.6 milionë euro, kurse i ka zotuar edhe 4 milionë, kurse në vitin 2007 për këtë kategori është shpenzuar buxheti vetëm 62%, pra nga 19 milionë euro ka shpenzuar 11.865.000 euro, ka zotuar 5.449.000 euro, kurse 1.700.000 euro kjo ministri i ka dërguar në vitin 2007 në suficit.

Megjithatë, edhe përkundër një performace të mirë në realizimin e investimeve kapitale pothuajse në të gjitha ministritë dhe komunat i mbetet shumë Qeverisë për të bërë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore që bëjnë planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e mjeteve kapitale. Sidomos, agjencionet e pavarura, buxheti i të cilave është i pasqyruar në këtë raport duhet të angazhohen shumë në ngritjen e kapaciteteve të cilat bëjnë planifikimin e buxhetit.

Po marr vetëm dy shembuj. Komisioni i Pavarur për Minerale dhe Miniera, në kategorinë mallrat dhe shërbime në 13 kategori të shpenzimeve ka shpenzuar më shumë se sa që janë planifikuar, apo po marr shembull Zyrën e Rregullatorit të Energjisë shpenzon vetëm të buxhetit të planifikuar për paga dhe mëditje, 850.000 euro, 19% të buxhetit të planifikuar, planifikon për paga dhe mëditje 885.000 euro, kurse shpenzon vetëm 245.000 euro. Për mallra dhe shërbime planifikon 1 milion e 288.000 euro dhe shpenzon vetëm 183.000 euro, planifikon 80.000 euro për shpenzime kapitale, kurse i shpenzon 0 euro për këto shpenzime.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Raportin dhe i jep përkrahje Kryeministrit dhe Qeverisë të vazhdojnë me kontrollin e rrjedhës së parasë publike si dhe të jenë edhe më efikas në luftimin e dukurive negative të trashëguara ashtu që t'i hapim rrugë zhvillimit ekonomik dhe perspektivës së jetës së qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin financiar për vitin 2008. Raporti është në përputhje të plotë me kërkesat juridike të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me të cilin plotësohen kushtet për diskutim dhe raportim.

Përformancën e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe për investimet kapitale me paranë publike, deputetët e LDK-së do t'i plotësojnë me diskutimet dhe sugjerimet e tyre.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e vlerëson si raport që është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe i jep përkrahje në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini. Regjia, ju lutemi ia jepni fjalën deputetit Gjini.

Diçka ka defekt me teknikën, s'e di çka është puna!

A ka mundësi 5 minuta pauzë se s'është diçka në rregull.

KRYESUESI: Edhe një herë ju lus që t'i ristartoni kartelat e juaja për shkak të defekteve në teknikën e Kuvendit.

Konstatohet që janë prezentë numri i mjaftueshëm i deputetëve për të vazhduar debati në Kuvend. Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Lajm i mirë që teknika është prapë në rregull.

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të nderuar kolegë e ka marrë raportin e shpenzimeve të buxhetit për vitin 2008 dhe me shumë kujdes e ka shqyrtuar.

Është dashur që t'i ndajnë punët për shkak se nuk do të mjaftonin shumë orë të flasim për gjithë atë që është gjetur në këtë raport. Shumë kolegë do të lëshohen në detaje të tjera, unë do të flas me disa shembuj për mënyrën e menaxhimit të parasë publike për të cilën foli ministri i Financave.

Janë disa pyetje esenciale që na kanë dalë neve, domethënë, si total se si është menaxhuar para publike, e do t'ia nisi me disa. Për shembull, për ne është e çuditshme për të parë që krejt vlerat janë rritur për nga 300-400% po na duket si në kohën e Enver Hoxhës kur ata të shkretit punonin për vitin 2010 e nuk ishin kërka. Një çështje tjetër që na bënë shumë kureshtar është si ka mundur një abetare t'i kushtojë buxhetit të Kosovës 15 euro me shumicë. Shihni shifrat pasi po i lypni për t'i parë edhe le të më tregoj dikush qysh bënë të kushtojë një abetare 15 euro me shumicë në Kosovë? Ky është menaxhim i parasë publike.

Çështja tjetër është, qysh bënë të shtrohet rruga në mars e të prishët në shtator, me para publike. Edhe ky është menaxhim i parasë publike. Çështja qysh bënë të hapën tenderët për punë të kryera, mbasi që është kryer puna, qoftë shkolla, qoftë rruga, çka do qoftë, të hapet tenderi, qysh bënë ashtu? Për Izbicë, për shembull, çështje tjetër që duhet ta përmend shumë me rëndësi është, për shembull 266.476.000 euro që kanë dalë jashtë Kosovës prej buxhetit dhe janë marrë letra me vlerë dhe raporti për 266.476.994 është ky, e kam nxjerrë dhe e kam prerë. Ky është Raporti që e sjell Qeveria e Kosovës për 266 milionë e gjysmë euro. Asnjë vendim. Kush e ka marrë vendimin? Dhe a e dini sa është profiti i Kosovës prej 266 milionë eurosh që i kanë shkuar një institucionit ndërkombëtar... është 2 milionë e 524 mijë, domethënë pak më pak se 1%. A e dini çfarë kamate japin bankat vendore për 266 milionë, a mundeni ta merrni me mend çfarë kamate kishin dhënë bankat vendore? Domethënë më pak se 1% interes i Kosovës për

266 milionë në krizën më të madhe financiare ndoshta në 70 vjetët e fundit. Ky është menaxhim i parasë publike.

Çështje tjetër është se Konferenca e Donatorëve është mbajtur vitin e kaluar, do të vijmë te kjo pikë edhe në të ardhmen, por dikush duhet të na tregoj se me çfarë pompoziteti kanë ardhur 1 miliardë e 200 milionë euro, a ka ardhur edhe pse nuk ka ardhur ndonjë euro prej Konferencës së donatorëve? Dikush duhet të përgjigjet, ministri duhet për t'u përgjigjur.

Tash po kalojmë te çështjet shumë teknike, për të cilat shumë deputetë gjithmonë kanë qenë tepër të interesuar për t' u marrë në të kaluarën dhe në të tashmen. Telefonat për shembull, çmimi i operimit, domethënë tarifat e telefonisë kanë rënë për gjysmë prej vitit 2007, janë ulur për shkak të konkurrencës e tjera, e tjera. Vlera e shpenzuar për telefona është rritur, do të thotë Qeveria në esencë ka shpenzuar tri herë më shumë se paraprakisht për telefona. E njëjta gjë është për benzinë për automjete. Çmimi i benzinës në dhjetor të vitit 2007 ka qenë diku 1.3 euro, mesatarisht për litër, sot është 80 cent, 85 cent për litër dhe prapë shpenzimi për benzinë është rritur, që keni pasur shumë dëshirë për t' i ditur këto sende. Për orendi, shikoni çka ka ndodhur me orendi, është blerë veç një fotele, veç një vitrinë, veç një tavolinë për të mos qenë në total, për të mos figuruar si shpenzime të mëdha, ju i dini vlerat e shpenzimeve të mëdha të cilat janë, nëse ulet vlera, atëherë shkojnë shumë çuditshëm krejt këto çështje.

Për qira, e keni dëgjuar Kryeministrin e Kosovë të dalë e të na thotë neve nuk ka më për të paguar qira, që një vit e gjysmë, vazhdon për të paguar qira, jo vetëm që vazhdon, por e ka rritur edhe vlerën e qirasë që Qeveria paguan për institucionet e veta.

Çmimi i tenderëve, nëse i shihni vlerat keni me u çuditur. Në Kosovë gjithmonë zgjidhet vlera më e madhja, esenca e tenderit është për kualitet dhe për çmim të ulët, përderisa te na vlera ma e madhja zgjidhet, do me thënë edhe dikush sheh seri çka po i ndodhë këtij vendi.

Janë bërë pagesa të dyfishta për një projekt është paguar dy herë. Kanë me treguar kolegët e mi në detaje, hiq mos keni dert ju. Objekti i Ministrisë së Arsimit për shembull, vlerësohet një metër katror e fasadës 260 euro, ndërsa vendoset kualiteti 60 euro. Ndërtesa e Ministrisë i ka 5000 metra katrorë fasadë, skontoja është 1 milionë euro vetëm në fasadë. Fundi i fundit ne këtë e quajmë një sakatim total i sistemit të menaxhimit të parasë publike. Me siguri se në të ardhmen edhe do të ngritën padi dhe për ta përfunduar do t'u them vetëm një fakt që ju e dini të gjithë. Një kompanie vendore i kanë kaluar pak më shumë se 3 milionë euro në konto të thesarit të Kosovës pa tender, pa qenë vijë buxhetore për një projekt që ju vetë keni votuar kundër. Ministri i Financave ka lejuar për t' i dalë një kompanie 3 milionë euro të Thesarit pa qenë në buxhet, edhe tash ju e dini qysh mund të hapët tenderi kur nuk ka vijë buxhetore, për çka hapet tenderi? Qysh i kalojnë një kompanie 3 milionë euro për një punë kur nuk është në buxhet? Ne thjesht nuk kemi përgjigje për këto pyetje, ministri i Financave duhet t' i japë këto përgjigje, shpresojmë që Auditori i Pavarur do t'i rishikojë të gjitha këto që ka ndodhur dhe me siguri se do të ketë fletë padi penale për shumë njerëz. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar materialin dhe natyrisht ai është në përputhje me dispozitat ligjore, i përmbush ato kriteret themelore që janë të domosdoshme për t'i

përmëshur, por natyrisht ka shumë çka brendapërbrenda që lë vend për debat dhe sigurisht që në pjesën e debatit ne do të diskutojmë më detajisht. Dhe ajo që në fakt e bën këtë dokument goxha deskriptiv dhe hap vend, domethënë, për të kërkuar sqarime shtesë nga hartuesit e këtij dokumenti është se kemi shumë shifra pa dhënë sqarime plotësuese, do të thotë, se si kemi ardhur te këto shifra? Pastaj pjesa që konsiderohet se është në një farë mënyre çalon ky dokument dhe përgjithësisht puna që ka bërë Qeveria është realizimi i projekteve. Ne jemi përafërsisht në gjysmën e vitit dhe do të duhej që projektet e parapara nga Qeveria për t'u realizuar në këtë periudhë kohore të vitit të ishin diku rreth 50% dhe mendoj kemi shumë dikastere të kësaj Qeverie dhe shumë njësi buxhetore që janë larg realizimit të projekteve të parapara mbi bazën e cilave është ndarë edhe buxheti.

Kjo na sjell do të thotë ose është një indikator që na jep një farë mënyre mundësinë hipotetike për të parashikuar se ne do të kemi edhe në këtë vit një suficit të madh.

Pastaj është çështja të shpenzimet kapitale, edhe përfaqësuesi, domethënë i partisë më të madhe- për dokumentin e tha se është realizuar 88%, i përmendi disa shifra.

Unë konsideroj se realizimet janë të buxhetit të paraparë, domethënë, sipas projekteve janë realizuar të investimet kapitale, po kjo është mjaft indikative nëse nuk e kemi pjesa tjetër të realizuar në atë nivel.

Pastaj mjetet që janë bartur nga vitet e kaluara, unë e mora vetëm Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që ndjehem pak më i thirrur për të folur për të. Kemi bartjen në vitin 2009, 6 milionë 765 e ca euro, që kur i shton kësaj, edhe gjysmë viti që do të thotë jemi pikërisht në gjysmën e vitit, rezulton se të kjo ministri janë realizuar ose janë afër realizimit projektet që kanë të bëjnë me investimet kapitale. Po ne që jemi brenda një institucioni që është i lidhur drejtpërdrejt me këtë ministri e dimë këtë pjesën e shpenzimeve sa ka funksionuar mirë prokurimi dhe implementimi i buxhetit të paraparë për shembull për shpenzime dhe mallra. Pra, në fillim, kur është diskutuar projektbuxheti kemi pasur vërejtje pikërisht në këtë dikaster që për shembull për shkencë, investimet në shkencë kanë qenë aq simbolike dhe këtu nuk shohim parametra që madje është realizuar ndonjë cent për këtë destinacion, e kam fjalën të Universiteti i Prishtinës. Pra, këto janë çështje që thashë kanë të bëjnë me shërbime të ndryshme që procedurat e prokurimit dhe procedurat e realizimit të asaj paraje publike për t'i realizuar kërkesat elementare të njësive që janë brenda Universitetit të Prishtinës kanë mbetur ato para 5 vjetëve. P.sh. për letër po të kërkohet duhet të shkohet prapë përmes. Është folur me të madhe se Universitetit të Prishtinës do t'i rikthehet autonomia buxhetore. Kjo në praktikë nuk ka ndodhur. Madje, madje edhe një pjesë e të hyrave vetjake që i realizon Universiteti i Prishtinës sipas informacioneve që unë kam janë pezulluar, domethënë nga mundësia që të shfrytëzohen për destinacionin për çka janë aktualisht e të mos bëjmë fjalë pastaj për rikthimin e një autonomie të pjesërishtme, njësive akademike qysh janë fakultetet dhe institutet.

Thashë secili në pjesën e debatit do të diskutojë, ky në parim përmësh ato kriteret themelore, domethënë të kërkuara prej ligjit, po kishim kërkuar që të pjesa e realizimeve të projekteve të parapara që Qeveria në një farë mënyre me pompozitet i ka promovuar në fillim të vitit buxhetor dhe të vitit kur është aprovuar projektbuxheti për këtë vit, shohim se ka ngecje në implementimin në pjesë të madhe të tyre. Dhe kërkojmë që tash e kemi edhe një periudhë, po hymë në periudhën e pushimeve kur natyrisht mundësitë e realizimit të këtyre projekteve janë mjaft të kufizuara dhe hymë në pjesën e fundit të vitit i cili nuk garanton se do të thotë do të kemi... Nëse kemi kaq shumë bartje nga viti 2008

në këtë tabelë dhe kemi shkallë të ultë të realizimit të projekteve, atëherë shtrohet pyetja a do të jetë më i madh suficiti në këtë vit dhe sigurisht suficiti, unë nuk jam ekspert i fushës, por e dëmton ndjeshëm buxhetin e vitit të ardhshëm?

Kjo do të ishte për fillim, sigurisht edhe kolegët do të thonë më shumë.

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Është vërtetë që edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë i ka shqyrtuar me shumë vëmendje shpenzimet e parasë publike për vitin 2008 të Kosovës dhe realisht ky raport është shqetësues kur shohim se performanca e mënyrës së shpenzimit të parasë është më e dobët se sa në të kaluarën. Unë para se të fillojë të thirrem në raste konkrete po e bëj një përkthim kur ne e kemi shqyrtuar raportin 9 muajor të shpenzimeve të buxhetit të Kosovës kemi parë se kjo Qeveri ka arritur vetëm 40% t'i përmbyllë shpenzimet kapitale, ndërsa në vitin 2008 vetëm për 3 muaj, 40% të shpenzimeve të tjera i ka përfunduar, domethënë edhe pse 80% në total ka arritur për t'i realizuar investimet kapitale të planifikuara.

Çka thotë kjo? Kjo thotë se për 3 muajorin e fundit me këtë listë të cilën na keni pru gjëja keni përshkruar realizimin e projekteve kapitale në të cilat shumica prej tyre janë vetëm të futura këtu, ndërsa është e pamundshme ne të dalim në terren dhe t'i shohim të gjitha. Por, secili nga ne, me dhjetëra prej tyre shohin që vetëm janë futur këtu dhe askund në realitet në terren nuk ekzistojnë. Kjo është një shkas që vërtet t'i mbulon shpenzimet ose ta mbuloni korrupsionin i cili ka ndodhur në këtë Qeveri.

Realisht edhe në këtë Qeveri ose edhe në këtë buxhet për vitin 2008 ka suficit, performanca e shpenzimeve është e dobët.

Tek investimet kapitale, natyrisht i keni disa organizata buxhetore, sepse tashmë e dimë i ka përmbushur kriteret pastaj duke barazuar, duke marrë 80% total. Po në qoftë hyjmë organizatë për organizatë buxhetore për ta shikuar, po e marrë Kuvendin konkretisht, që jemi këtu edhe deputetë të kësaj organizate buxhetore, vetëm 20% për vitin 2008 ka realizuar investimet kapitale Kuvendi i Kosovës. Zero për qind Presidenca e Kosovës ka realizuar investimet kapitale, janë zotuar, por asnjë cent s'e ka shpenzuar.

Zyra e Kryeministrit, nëse i shkojmë projektet me radhë se çka ka futur në investimet e tij që vërtet nuk ish dashur me qenë fare në këtë organizatë buxhetore, ky ka arritur, faktikisht 92% për t'i realizuar shpenzimet edhe të lejuara edhe të palejuara.

Çka shohim tjetër këtu tek ky dokument? Shohim që realisht 20 milionë janë rritur pagat, jo që është ngritur paga e qytetarit të Kosovës, por, realisht, ka punësim dhe kur e shohim atje dokumentacionin, ka punësim me kontratë në vepër shumë punëtorë në organizatat buxhetore të Kosovës, të cilat nuk i lejon as ligji. Domethënë është dashur të punësohen familjarët e personave zyrtarë, është dashur të punësohen normalisht edhe anëtarët e partive të juaja.

Janë rritur shpenzimet e qirasë që keni premtuar se do të ketë ulje, përkundrazi janë rritur, shpenzimet operative, natyrisht, janë rritur, s'ka asgjë zbritje.

Mbi 1 milion euro janë avanset të pambyllura edhe këto të Kryeministri, të Kuvendi i Kosovës, e kështu me radhë. Kjo është e papranueshme.

Të nderuar kolegë deputetë,

Buxheti i Kosovës është dëmtuar po e marr shembull për 1 milion euro për policët serbë të cilët pas shpalljes së pavarësisë nuk kanë pranuar të jenë në strukturën e Shërbimit Policor të Kosovës dhe ata janë financuar edhe nga Qeveria e Serbisë, por edhe nga Qeveria e Kosovës për të kryer punë dhe për të funksionuar këtu si institucione të cilat ne e dimë se çfarë pune kanë kryer ata, ndërsa buxheti i Kosovës, qytetarët e Kosovës i kanë paguar këta policë mbi 1 milion euro dhe Qeveria e Kosovës ende s'ka marrë asnjë hap në këtë drejtim.

Janë njëkohësisht miliona euro për shkak se kjo Qeveri nuk ka mundur ta konstitujë KELP-in dhe i keni, i paguani edhe këshilltarët e juaj që i keni bërë sekretarë permanent e i paguani edhe sekretarët permanent e që rrinë dhe nuk qani kokën ju që ato janë para të buxhetit të Kosovës.

Natyrisht, në qoftë se pastaj kalojmë te komunat shohim mbi 60% të komunave që s'kanë mund të arrijnë as 60% t'i realizojnë shpenzimet kapitale dhe kjo është një performancë e kësaj Qeverie se çfarë forme janë shpenzuar dhe sa për qind keni pasur aftësi për t'i realizuar shpenzimet për të cilat i keni bërë zotimet?

Për të përfunduar unë them se ky raport faktikisht për kundër atyre përpjekjeve të juaja që keni bërë që të mundoheni ta arsyetoni shpenzimet e kësaj paraje, megjithatë, ky dokument edhe pse ka ardhur nga ju është tepër i dobët dhe është dokument me të cilin ne vërtet mund të thirremi në dëshmi se paraja publike e Kosovës shpenzohet pa kriterë dhe shpenzohet, të mos të bisedojmë pastaj për prioritetet e projekteve. Prioritetet e projekteve ju natyrisht se i shihni rrugicat e fshatrave që s'ka asgjë të keqe, por Kosova ende se ka asnjë autostradë me asnjë shtet fqinjë, dhe nuk e ka asnjë rrugë e cila gjeneron zhvillim ekonomik. Kosovës i shtrohen rrugët atje ku ka nevojë të merren votat dhe nuk mendon askush se cila rrugë gjeneron zhvillim ekonomik dhe me cilin shtet Kosova duhet të ketë natyrisht lidhje përmes rrugëve dhe infrastrukturës rrugore. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputetja Myfera Shinik.

MÜFERA ŞİNİK: Faleminderit!

Teşekkür ederim.

1 Ocak-31 Aralık 2008 yılı yıllık Kosova Bütçe Finansı Raporu görüşülmektedir.

Rapor hukuki şartları doldurmaktadır. İyi bir Rapor hazırlanmış. Bütçe Komisyonu olarak Finansı Bakanlığından geniş açıklamalı ek Rapor istemişiz. Finansı Bakanlığı bu Raporu ayan bir şekilde sunmuştur.

Raporda özelleştirmede 2007 yılında yüzde 14, 2008 yılında yüzde 26 planlanan gelir görülmektedir.

Demek ki gözle görülür bir artış var. Bundandır, özelleştirmeye yönelik daha geniş bir strateji yapılırsa, gelirlerde de artış görülebilir.

Yıllık planlanan giderler de yüzde 80,7 olarak görülmektedir.

Yatırımlarda 2008 yılında yüzde 44, 2007 yılında yüzde 26 olduğuna göre artış görülmektedir.

KEBTB bütçesi yüzde 88 harcanmıştır, oysa 2007 yılında bu harcama yüzde 62 oranındaydı.

7+ Parlamento Gurubu olarak Raporu kabul ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Uveženi kolege poslanici,

Uvaženi ministre Shalja,

Naravno, pošto pričamo o Izveštaju konsolidovanog budžeta za period od 1. januara do 31. decembra 2008. godine. Ja mislim da uopšte nijednog momenta ne može da bude sporno da li je on u skladu sa evropskim i međunarodnim standardima vezano za računovodstvo i u skladu sa Zakonom o menadžiranju javnih financija i odgovornosti. Sve je to u redu i mislim da tu nema puno priče.

Ovo što možemo pričati i voditi polemike, da li su sredstva utrošena, da li je stiglo da se utroše sredstva ili ne, svakog svoja muka najviše boli. Naravno, da uvek imate i nezadovoljnih građana i zadovoljnih, oni koji su dobili puteve, bolnice, škole, stanove, oni su zadovoljniji od onih koji nisu, ali ima vremena i u narednim godinama. Medjutim, ono što predstavlja činjenicu, meni stvarno nije namjera da bilo koga okrivljujem niti bilo koga posebno nešto da hvalim, ali ako uzmemo samo kako se usvaja budžet za narednu godinu, znači usvaja se godinu dana unapred. Vlada je zatekla znači i planirani budžet iz 2007. godine, budžet koji je trošen u 2007. godini i projekti su zatečeni, znači od planiranog budžeta iz 2007. godine, osim nekih stvari gde je bilo ušteda pa je Vlada morala da iterveniše. Što se tiče direktnih možda nekih optužbi na račun Vlade oko budžeta, to ćemo moći tek konkretno u 2009. godini, i ako ova Vlada nije znala dobro da izmenadžira budžet za 2009. godinu, koju mi planiramo sada i koju smo jedan deo rasprave imali juče. Uvek može bolje, naravno da nismo zadovoljni, jer je budžet mali, ali budžet nije mali zato što Vlada nije znala da napravi veći budžet, nego što su to realna finansijska sredstva kojima može budžet da se puni, takva kakva jesu, i mi pošto jesmo, moramo da se trudimo da razvijamo i privredu i ekonomiju, da dovučemo strane investicije, da otvorimo nova radna mesta, da bude budžet puniji pa će biti više investicija i više trošenja para, pa ćemo imati više zadovoljnih ljudi.

Ono što ja vidim kao činjenicu jeste da imam pravo da pričam u ime naše Parlamentarne grupe vezano za dva ministarstva koja menadžiraju naši ministri i ja mislim da svi ljudi na terenu mogu da vide da ima konkretnih rezultata, da su izgradjeni novi stanovi, škole i putevi, obdaništa, sportski tereni. To se po prvi put vidi praktično na delu, znači Vlada je odvojila određena sredstva. Opet kažem, nisu dovoljna koliko bi i možda trebala, ali to je opet u skladu sa nečim drugim, verovatno ni većinska zajednica nema dovoljno sredstava pa ćemo mi u skladu sa tim imati strpljenja, da se strpimo i da sačekamo još malo.

Medjutim, ono što mene brine jeste da nemamo jasan uvid vezan za sva ministarstva i njihovu ulaganje u zajednicama, jer ja mislim da bi mogli da promenimo praksu, da Ministarstvo za povratak i zajednice bude vlada u malom za ostale zajednice sa

nedovoljnim budžetom, a da se menadžiranje iz ostalih oblasti po ostalim porfelima ministarstva radi tako što ministar treba, kaže dialogom dobro da iskomunicira i menadžira sa ostalim ministarstvima. Ja mislim da kada su finansije u pitanju, nema tu nekog posebnog dijaloga, to treba regulisati zakonima, odredbama i budžetima, budžetskim linijama, kolike su po određenim linijama za zajednice i da možda u skladu i u dogovoru sa ministrom za zajednice i povratak, ta sredstva budu izmenadžirana u zajednicu, znači mislim i o Ministarstvu obrazovanja, Ministarstvo poljoprivrede, jer ja stvarno ne znam da li je u zajednice uloženo nešto iz budžeta Ministarstva poljoprivrede, Ministarstva zdravlja. Postoji tu problemi, ovde smo čuli malo pre izlaganje oko tih plata ljudi koji rade, ne rade, tu su ili nisu tu, imamo dosta nejasnu sliku. Ja upozoravam sve nas ovde da dobro povedemo računa o tome jer ne može neko podizati platu pri tome ne potpisuje i pri tome naravno najviše gubi moja zajednica, jer ako se vratim samo na trenutak i na te policajce, jesu izgubljena finansijska sredstva, ali je Vlada možda dobila odredjeni plus i odredjeni bonus koji je kod međunarodne zajednice vezano za strpljenje i toleranciju koja je imala prema policajcima, a oni koji su izgubili i ako imaju pravo da se ljude, to je upravo Srpska zajednica jer je bezbednost, znači neetnički motivisana, nego iz opšeg polja bezbednosti, znači sa krađom pokretne i nepokretne imovine, povećana upravo zbog toga što nije imao ko da štiti te ljude.

Naravno, ovaj, pohvalama sigurno ima puno mesto vezano za ovaj budžet, ima mesta i za puno kritika vezano za ovaj budžet. Nadam se će u 2009. godini biti još bolji, moramo da budemo svesni kada pričamo i da ovo gleda i narod ovde na Kosovu, i da vrlo treba da budemo obrazivi kakvu poruku njima prenosimo, znači ne treba da im dajemo lažna obećanja jer ako svetska ekonomska kriza vlada svuda, i mi ćemo osetiti to, naravno što manji ekonomski sistemi sporije osećaju i ekonomsku krizu, ali se zato i sporije oporavljaju od toga. Ne bih želeo puno da odužim, želim još jednom da dam podršku ovom izveštaju, mi ćemo kao poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržati ovaj izveštaj. Hvala, vam!

KRYESUESI: Faleminderit!

Grupet parlamentare ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kanë kryer radhën. Tani sipas paraqitjes dhe renditjes e kanë fjalën deputetët. Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

I nderuari Kryesues,

Të nderuar kolegë prezentë,

I nderuar ministër Shala, mbasi je i vetmi këtu,

Unë jam munduar pak në mënyrë reale ta shikoj këtë raport dhe mendoj se realizimi i të hyrave në krahasim me planin për 6% tregon se është një progres, pa hyrë në këtë temë të planit a ka qenë real apo ka mund ndryshe, por ne e kemi aprovuar?

Gjithashtu, sa i përket të hyrave është shënuar një progres edhe në të gjitha këto segmente duke filluar prej Doganës, Administratës Tatimore, nivelit qendror, nivelit komunal.

Po jam përcaktuar t'i them disa fjalë në lidhje me realizimin e të dalave, mendoj se ka vend për diskutim. Po shihet se të gjitha shpenzimet janë afër planifikimit, pos shpenzimeve kapitale. Në tërësi shpenzimet kapitale janë realizuar vetëm për 80% , 80.7 për qind edhe për mua është një segment që duhet pak më seriozisht të shqyrtohet, dhe në qoftë se hymë më detajisht në raport po shihet edhe ku kanë ngecur këto shpenzime.

Unë nuk e marr parasysh Qeverinë, as Kuvendin, as Presidencën që kanë realizuar minimumin nga planifikimi, sepse këto janë të holla edhe të vogla, por shumë janë të rëndësishme për shpenzimet të cilat ministritë i kanë realizuar.

E keni këtu Ministrinë e Ambientit që vetëm ka realizuar 27%, i keni disa ministritë të cilat janë nën 50% si Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria për Kthim 59 për qind dhe ministria e Drejtësisë 44 për qind nuk mendoj të përmendi pse Ministria e Punës së Jashtme 28%, sepse është ... në formim. Ministria e Shëndetësisë pak më shumë 76 për qind po mendoj se kjo gjë për këtë Ministri duhet të analizohet. Pse i përmenda të gjitha ato? I përmenda se Qeveria duhet tash ta marrë veç e veç e ta analizojë ngecjen dhe pse? Përgjegjësi është në qoftë se nuk shfrytëzohen mjetet, nuk është shpenzim sikur në një kohë që e thamë, e kem pasur një ministër tha- kursej për pavarësinë. Ky kursim nuk është- tash e kem pavarësinë e duhet ta shfrytëzojmë në mënyrë racionale.

Arsyet mund të jenë mosrealizimi, planifikimi joreal i Ministrisë ose jo profesionalizmi. Mund të jenë edhe projektet e vonuara edhe pse në qoftë se është kjo arsye, edhe nën tre- menaxhimi i dobët i Ministrisë.

Unë mendoj se vlerësimet globale janë të mira edhe unë do të votojë për këtë raport, por nuk mund të pajtohem me aprovimin pa analizën më detaje. Pse? Ne sot kemi edhe një dokument për të cilin do të diskutojmë- Kornizat e shpenzimeve deri në vitin 2012 dhe aty janë propozuar shpenzimet në mënyrë të rritjes lineare, por në qoftë se këto ministri kanë ngelur edhe me realizimin e vitit të kaluar, atëherë kërkohet përgjigja pse?

Nën dy, kam vërejtur në raport, faturat e papaguara, janë dyfish më të mëdha se në vitin 2007, mund të ndodhë që është bartja për shkak të teknologjisë të punës, por diku me siguri edhe është puna e papërgjegjshme edhe mendoj se edhe këtu Qeveria ka nevojë ta shikojë dhe kur është buxheti i vogël, i varfër, kurse nevojat të mëdha, kërkohet racionalizimi i mjeteve në nivelin shumë më të lartë edhe mendoj se përgjegjësinë në këtë drejtim nuk e kemi ngritur në nivelin që duhet.

Edhe e fundit që unë mendoj se ka nevojë që të shikohet pak është punësimi. Numri i të punësuarve në institucionet buxhetore është aq sa ka qenë në vitin 2007, edhe shpesh këtu ministrat kanë ditur për të na shpjeguar që puna shkon mirë, në i mbajmë të gjithë njerëzit që janë aty edhe lëvdohen me numrin që nuk është zvogëluar se s'e kemi larguar askënd prej pune që ka pranuar ndoshta një parti para tyre, por unë mendoj se ka qenë në një kohë një vlerësim, nuk e di para një viti a dy i Fondit Monetar, pra është obligim zvogëlimi i numrit të punësuarve në administratë, nuk e shoh këtu në raport në këtë drejtim a është bërë diçka apo jo, por për një punë efikase duhet profesionalizëm dhe organizim më të mirë. Në këtë drejtim mendoj se Qeveria duhet bërë më shumë se çka ka bërë deri më tani. Unë nuk e kam vërejtur një lëvizje në këtë drejtim.

Prandaj, në tërësi thashë jam për këtë raport, por me një punë të Qeverisë edhe po shihet prezenca e Qeverisë këtu sa janë të interesuar, por vetëm për të na dërguar raportin, po çka themi ne për raportin, po e shoh interesimin nuk është. Për mua edhe kjo është papërgjegjësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Dokumenti për raportin e shpenzimeve është dokumenti më i rëndësishëm bashkë me Ligjin për buxhetin që shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend brenda një viti.

(Reagime nga salla)

E lus kryesuesin që të vë një rregull në sallë. Ok.

Për mua, me qenë se Qeveria e ka parë të arsyeshme të mos marrë pjesë sot në shqyrtim të këtij dokumenti është e arsyeshme, ne e shqyrtojmë i japim vërejtjet tona, ata e kanë formën qysh i marrin ato vërejtje dhe sigurisht do të reagojnë sipas nevojë.

KRYESUESI: Unë po ju sqaroj që kanë mbledhje me Komisionin Evropian komplet Kabineti qeveritar, kështu që zoti Shala është tërhequr nga mbledhja dhe do të shkojë për të referuar në orën 12,15. Kjo është arsyeja pse s'është Qeveria këtu.

HAKI SHATRI: Në rregull, nuk është faji ynë, zoti kryesues. Unë e pyes ministrin me qenë se po diskutojmë për raportin e buxhetit 2008- kur ka hyrë në fuqi buxheti i vitit 2008, buxheti fillestar dhe buxheti i rishikuar në gusht? Me qenë se sipas ligjit për financat publike dhe vetë ligji për buxhetin është dashur të publikohet në Gazetën Zyrtare dhe të fuqizohet 15 ditë pastaj, unë nuk kam parë në Gazetën Zyrtare të asnjë numri në vitin 2008 që është publikuar ky dokument. Mua më ka sjell problem, sepse numrat që ka afruar raporti nuk më janë barazuar me numrat që janë në buxhetin që e kemi miratuar në Kuvend. Konkretisht shifra 236 milionë për paga dhe mëditje është një shifër që ka qenë tjetër në buxhetin e rishikuar, kurse në raport thuhet se janë lejuar me buxhet 236 milionë, sido që të jetë, po vazhdoj më tutje.

Sa i përket të hyrave dhe shpenzimeve, përveç kësaj dileme rreth të ardhurave ndodhitë në të dy segmentet kanë ndodhur brenda buxhetit dhe në pajtim me buxhetin. Është jo pozitive për t'u përkrahur ajo që të hyrat në segmente të caktuara i kanë tejkaluar parashikimet e planit për 6% dhe ne për këtë u jemi mirënjohës shërbimeve përkatëse, administratës dhe Shërbimit Doganor.

Të gjitha shpenzimet nuk i kanë tejkaluar në asnjë vijë parashikimet e buxhetit dhe kjo është mirë. Mirëpo, brenda shpenzimeve aspekti kualitativ dhe procedurat ligjore të këtyre shpenzimeve janë çështje që meritojnë vëmendje. Për aq sa kam mund të nxjerr vlerësime nga raporti në pjesën e investimeve kapitale për mua ka të dhëna që janë shumë shqetësuese në krahasim me respektimin e Ligjit për financat publike dhe vetë Ligjin për buxhetin për vitin 2008.

Do të përpiqem t'i konkretizojë disa gjëra, më qenë se më humbi pak kohë në fillim derisa u orientuam në seancë.

Pra, dinamika dhe vëllimi i shpenzimeve buxhetore janë vetëm një aspekt, por analiza kualitative tregon që ka shumë probleme. Çka mund të nxirret nga raporti? Gjejmë se janë shpenzuar mjete buxhetore për projektet që nuk janë në buxhet në vitin 2008, pra në pjesën tabela nr. 4 që është pjesë përbërëse e Ligjit për buxhetin për vitin 2008, pra, komplet janë financuar projektet që nuk janë në buxhet. Kështu për shembull më saktësisht po them Ministria e Shërbimeve Publike e ka bërë një kontratë dhe e ka

financuar një projekt, ka alokuar mjete dhe ka shpenzuar në shumë prej 3 milionë e 400 mijë euro.

Ministria e Arsimit- tri projekte që nuk janë me buxhet, për të cilat ka alokuar 1 milion e 250 mijë euro.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, pesë projekte për të cilat ka alokuar 2 milionë e 195 mijë euro.

Ministria e Energjisë për dy projekte ka alokuar 100 mijë euro, gjithsej 11 projekte që nuk janë në buxhet në pjesën tabelare nr. 4 që, pra, janë jashtë buxhetit dhe shuma e tyre e alokuar arrin në 6 milionë 949 mijë 97 euro.

Tjetër, nga krahasimi i të dhënave në raport me tabelën numër 4 të buxhetit del se janë ridestinuuar ose janë rialokuar mjete jashtë rregullave buxhetore, pra, shuma mbi 40% për projektin konkret, po citoj: “Shuma mbi 40% që ndodh ka shkuar deri në rritje 600% të vlerës për projektin konkret në shumë organizata buxhetore”

Për shembull Ministria e Financave ka financuar dy projekte që ka shtuar vlerat mbi 40%, vlera e shtuar është 725 mijë euro.

Ministria e Postë- Telekomunikacionit për 12 projekte ka shtuar vlerën mbi 40%, pa kërkuar pëlqim nga Kuvendi, siç e parasheh procedura buxhetore. Vlera e shtuar është 4 milionë e 284 mijë e 240 euro.

Ministria e Shëndetësisë, dy projekte në shumë prej 149 milionë euro,

Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport, 4 projekte 636 mijë euro.

MASHT, 4 projekte vlera e shtuar 802 mijë euro.

Trupat Mbrojtëse e Kosovës, Zyra e koordinatorit, tri projekte vlera e shtuar 1 milion 142 mijë euro dhe SHPK, dy projekte, vlera e shtuar 700 mijë euro. Gjithsej vlerat e shtuara, pa procedura, 8 milionë e 439 mijë 330 euro.

Sipas ligjit të menaxhimit të financave dhe Ligjit për buxhetin 2008 rialokimi mbi 40% kërkon procedurë dhe ajo procedurë është që pasi të kalojë miratimi në Qeveri të ngritë, të merr pëlqimin edhe në Kuvend. Kjo siç e dini, të nderuar deputetë, nuk ka ndodhur.

Një rast tjetër është një pagesë dy herë që e përmendi edhe zoti Gjini në kuadër të Ministrisë së Arsimit, shpresoj që të jetë gabim në raport, përndryshe është një shkelje e rëndë dy herë të paguhet për të njëjtën gjë në shumën afër 200 mijë euro.

Një segment mjaft delikat te shpenzimet publike është edhe procedura e prokurimit, gjegjësisht respektimi i Ligjit për prokurimin publik. Është shumë indikative që organet e prokurimit të organizatave buxhetore kanë preferuar procedurën e çmimit të negociuar ndaj atij të ofertës së hapur, dhe e aplikojnë këtë procedurë edhe kur nuk parashihet me ligj.

Unë po e marrë vetëm një shembull, në tenderët që janë shpallur për shumat e mëdha mbi 3 milionë euro, po citoj:” tenderët shumat mbi 3 milionë euro në vitin 2008, nga 44 tenderë të publikuar, 15 prej tyre janë lidhur kontratat me procedurë, çmim i negociuar, nga të cilat vetëm në KEK 13. Shumat janë prej 3 deri në 15 milion euro”

Në Ministrinë e Postë- Telekomunikacionit më shumë preferohet kriteri çmimi më i favorshëm, kështu vetëm në periudhën 9- mujore nga 86 tenderë që janë shpallur

publikisht, 81 tenderë janë lidhur në bazë të kriterit të çmimit të favorshëm, që edhe këtu Ligji për prokurimin publik përcakton kushte se kur dhe si duhet të ndodhë.

Në 40 kontrata që janë lidhur nga kjo Ministri, ndryshimi mes çmimit minimal të ofertës valide dhe çmimit të kontratës së lidhur arrin në 4 milionë e 9821 euro ose 5% e vlerës së tërësishme të kontratave të lidhura në 9- muhorin e parë të vitit. Në qoftë se kjo ka vazhduar deri në fund të vitit kur janë lidhur kontrata në vlerë 171 milionë, atëherë del që ndryshimi mes çmimit më të ulët valid të ofertave dhe çmimit të kontratave arrin vlerën në diku 8 milionë e 500 mijë euro.

Kontrata për renovimin e "Rilindjes" është lidhur po ashtu me ofertuesin më të shtrenjtë edhe pse oferta- tenderi ka qenë në bazë të kriterit të çmimit të ofertave të lira të hapura, është lidhur me ofertuesin më të shtrenjtë

KRYESUESI: Ia vazhdojmë 2 minuta se ia kemi borxh.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kontrata për "Rilindjen" është lidhur me ofertuesin më të shtrenjtë 14 milionë e 600 mijë, kurse ofertuesi më i lirë ka qenë për 1 milion e 726 mijë euro, ka qenë po ashtu ofertë valide.

Përveç faktit që ky projekt nuk ka qenë në buxhet, ky projekt po citoj: "është refuzuar nga Kuvendi me vendim të veçantë që të mos hyjë në buxhet dhe të mos fillohet renovimi i tij". Pra, kjo është një shkelje e hapur e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Të nderuar deputetë,

Këto janë vetëm disa raste më të theksuara që kam mund t' i nxjerr nga vetë raporti, por me qenë se ne presin që Auditori Gjeneral të sjellë raportin e auditimit, mund të nxjerrim më vonë edhe vlerësimin e Auditorit Gjeneral. Për t' i parë këto shkelje dhe këto brenga që dalin nga vetë raporti, propozoj që Kuvendi të kërkojë një auditim special vetëm për linjën buxhetore, investimet kapitale dhe pastaj të marrim atë raport e të shohim për veprimet e mëtejshme nga ata që eventualisht mund t' i kenë përgjegjësi për këtë çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Për fjalë është paraqitur deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Raporti në fjalë është teknikisht i përgatitur mirë me të dhëna të detajuara, edhe të hyrat edhe të dalat në periudhën e cekur kanë shënuar rritje. Të hyrat totale për vitin 2008, krahasuar me vitin 2007 janë rritur për 14%, kurse krahasuar me planin për 6%.

Është pozitive se të gjitha të hyrat kanë shënuar rritje, ndërsa rritja më e madhe është tek të hyrat vetjake të komunave me 46.3%, sidomos është shënuar rritje në komunën e Prishtinës, në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe komuna e tjera. Por, të të hyrat e Administratës Tatimore është rritja më e vogël, vetëm 10%, në krahasim me vitin 2007 dhe dihet se këtu ka mundësi që të realizohet një rritje më e madhe e grumbullimit të hyrave me qëllim të zvogëlimit të evazionit fiskal.

Dihet që synimi i Qeverisë çdo herë duhet të jetë që të hyrat të rriten apo grumbullimi i të hyrave të rriten sa më shumë që është e mundur dhe ato të përdoren në mënyrë sa më racionale për të sjellë efikasitet më të madh. Andaj, nga raporti shihet se në vitin 2008, gjokat dhe tarifat kanë shënuar një rënie të dukshme, diku rreth 60%.

Të hyrat nga licencat po ashtu kanë shënuar një rënie të madhe, si edhe të hyrat nga qiraja për objektet publike dhe të hyrat nga renta.

Nëse i shikojmë shpenzimet, të dalat për vitin 2008, në krahasim me planifikimin, janë për 19.3% më të ulëta, ndërsa, krahasuar me vitin 2007 janë për 44% më të larta dhe kjo paraqet një hap pozitiv edhe pse ka hapësirë që këto të rriten edhe më shumë. Sidomos, kur krahasojmë vitin 2007 me vitin 2006, domethënë, kjo paraqet vërtet një hap pozitiv.

Shpenzimet kapitale u përmend edhe nga të tjerët janë realizuar 80% krahasuar me planifikimin, por kanë shënuar rritje për 124%, krahasuar me vitin 2007.

Edhe tek shpenzimet vërehet se ekziston mundësia e realizimit më të mirë të tyre. Nëse shikojmë shpenzimet e realizuara për investimet kapitale në bazë të organizatave buxhetore duhet cekur se disa prej tyre kanë realizim më të mirë. Konkretisht, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Transportit dhe e Postë-Telekomunikacionit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë. Po ashtu, duhet cekur se ka edhe organizata buxhetore ose konkretisht ministri të cilat kanë realizim shumë të dobët sa i përket shpenzimeve për investimet kapitale si p.sh. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete. Në këtë grup të organizatave buxhetore bën pjesë edhe vetë Kuvendi i Kosovës, që e ka shkallën më të ulët të realizimit të shpenzimeve për investime kapitale, që është vetëm 28%.

Po ashtu tek shpenzimet vërehet se ka rritje të madhe të shpenzimeve në emër të qirasë, përkundër faktit që është marrë vendimi nga ana e Qeverisë që organizatat buxhetore të vendosen në objektet e Qeverisë. Po ashtu, vërehet një rritje e madhe e shpenzimeve tek avanset të cilat kanë shënuar një shkallë të lartë të rritjes.

Andaj, nëse shikojmë të gjitha këto shpenzime, ekziston mundësia që realizimi i shpenzimeve, sidomos për shpenzimet kapitale të rritet, sepse nevojat janë të mëdha për investime dhe kur bëhen ndarjet buxhetore, të gjithë e dimë se organizatat buxhetore synojnë të përfitojnë sa më shumë mjete. Prandaj, ato mjete duhet t'i shfrytëzojnë, sepse mosshfrytëzimi i tyre do të thotë ndarje e mjeteve që u janë marrë qytetarëve dhe nuk janë futur në qarkullim. Kjo do të thotë është një dëm i dyfishët për qytetarët.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

Të nderuar dy ministra,

Të nderuar deputetë,

Ju kujtoj disa nga premtimet e Kryeministrit dhënë qytetarëve të Kosovës: “24 orë rrymë, paga të mëdha mësimdhënësve, vende të reja të punës, pensione të dinjitetshme, barëra më të lira se buka, farë e karburante falas për bujqit”.

Cilat nga këto premtime janë realizuar në vitin 2008? Asnjë. Çfarë kanë përfituar qytetarët e Kosovës vitin e kaluar nga shpenzimi i parave të tyre të menaxhuara nga Qeveria? Asgjë.

Raporti financiar i buxhetit, të cilin po e shqyrtojmë sot, është treguesi më i mirë i paaftësisë së Qeverisë për planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit për vitin 2008. Në të vërtetë, kjo Qeveri e ka keqmenaxhuar paratë publike, prandaj është Qeveri e dështuar dhe çudia më e madhe është se Qeveria dështimet i quan sukses.

Të nderuar deputetë,

Raporti është joadekuat, jotransparent, i mangët, pa detaje të nevojshme. Ftoj Qeverinë që ta argumentojë se me gjithë shpenzimet e buxhetit pse nuk po përmirësohet jeta në Kosovë? Pse mjekët, arsimtarët, shërbyesit civilë, policët kanë marrë paga të mjerueshme? Pse nuk ka zhvillim ekonomik, vende të lira të punës, zvogëlim të varfërisë, përmirësim të shëndetësisë?

Në këtë raport nuk janë paraqitur të gjitha detajet e shpenzimeve dhe qytetari i Kosovës ka të drejtë të dijë për secilin cent të tij si është shpenzuar. Disa shpenzime publike nuk janë të kontrolluara sa duhet dhe Qeveria nuk ka dhënë sqarimet e duhura. Prandaj, i drejtohem ministrit të Ekonomisë dhe Financave, që të japë sqarimet e duhura.

Së pari, vlera e mallrave dhe e shërbimeve të paguara në vitin 2008 është afër 140 milionë euro. Nga këto, mbi 109 milionë euro janë fusnota, si shërbimet kontraktuese në shumën prej mbi 19 milionë euro, shpenzimet e tjera mbi 44 milionë euro dhe për lëndë djegëse mbi 23 milionë euro, mirëmbajtja dhe riparimi afër 23 milionë euro. Pra, për mbi 70% të shpenzimeve nga kategoria - mallra dhe shërbime nuk kemi informata të hollësishme, gjë që rrit automatikisht dyshimin për keqpërdorim.

Në krahasim me vitin 2007, në vitin 2008 shpenzimet të kategorisë për mallra dhe shërbime janë rritur. Derisa në vitin 2007 janë shpenzuar 127 milionë euro, në vitin 2008 janë shpenzuar 139 milionë euro. Pra, 12 milionë euro më shumë se sa që i ka shpenzuar Qeveria e kaluar. Kaq për premtimet e kësaj Qeverie se do të ketë kursime.

Aq shumë propagandë ka bërë kjo Qeveri se nuk do të bëjë si Qeveria e kaluar, që nuk do të paguajë qira nëpër ndërtesa private, por të dhënat në raport flasin ndryshe. Derisa për qira Qeveria e kaluar ka shpenzuar 4 milionë e 654 mijë euro, kjo Qeveri ka shpenzuar 4 milionë e 881 mijë euro, pra 227 mijë euro më shumë se sa Qeveria e kaluar.

Së dyti, sa u përket granteve të përcaktuara të donatorëve, shuma totale e këtyre granteve, e tha edhe vetë ministri, është 12 milionë e 731 mijë euro, kurse interesi nga grantet 101.000 euro ose 07%.

Zoti ministër, na sqaroni se ku janë investuar këto dhe cilat janë politikat investive?

Së treti, shuma totale e të dalave nga grantet është afër 5 milionë euro, nga këto mbi 2 milionë euro janë avanse. Zoti ministër, kjo përbën 45% të shumës së përgjithshme të granteve. Na informoni ku është ky avans, për çka është dhënë, aq shumë paska para ky buxhet për t'i lënë në avans. Si e shpjegoni këtë?

Së katërti, nëse është siç shkruan në raport, se shuma e shpenzuar nga fondet e AKM-së, gjegjësisht AKP-së, është afërsisht 47 milionë euro, duke përfshirë pagesën e 20% të

punëtorëve, është e pakuptimtë atëherë pse pagesa e 20% është kaq e ngadalshme. Mungon edhe informata për kamatën.

Duam ta dimë saktësisht se ku është investuar ky fond dhe çfarë përfitimesh ka buxheti i Kosovës nga këto investime? Sa është kamata në to, sa fiton Banka Qendrore? Po ashtu, sa është kamata në mjetet e Fondit të AKM-së që kap shumën prej më shumë se 403 milionë euros? Kërkoj informatë të detajuara.

Së pesti, zoti ministër, meqenëse në raport është paraqitur shuma e llogarisë së mbajtur të e AKM-së, por jo edhe dividendat ose fitimi i PTK-së, na tregoni sa është dividendat e PTK-së?

Së gjashti, janë investuar 270 milionë në letra me vlerë. Ku i keni investuar, çfarë letra me vlerë janë këto? A janë ... të Thesarit, nëse janë ... të Thesarit, do të thotë se janë në qeveri të shteteve, në cilat shtete janë këto? Çfarë janë deklaratimet e juaja se mjetet e Trustit të Fondit të Privatizimit duhet të investohen në Kosovë, kurse vetë investoni jashtë? Në cilat politika investive jeni bazuar? A është paraparë ky investim me letra me vlerë në vitin 2008? Çfarë ka ngjarë se 149 milionë të buxhetit të investuara në Bankën Qendrore dhe 270 milionë euro të letrave me vlerë dhe 403 milionë euro të Fondit të AKM-së del se janë investuar jashtë vendit, diku 882 milionë euro? Sa mesazh i keq për investitorët. Nuk ka transparencë dhe me këtë po mbulohet keq menaxhimi i këtyre mjeteve të qytetarëve të Kosovës.

Qeverisë edhe një herë ia kujtoj se këto para nuk janë të tyre, por të taksapaguesve kosovarë, prandaj duhet të japin llogari të plotë për destinacionin e fondeve, shtesat dhe rreziqet që bartin. Shqetësimi i vetëm i kësaj Qeverie është t'i përmbushë qëllimet e veta dhe sipas raportit del se prioriteti i Qeverisë janë: tenderët për rrugë, tenderët për shkollat, tenderët për ndërmarrje.

Prandaj, zonja dhe zotërinj, shëndetësia ose vendet e lira të punës nuk janë prioritet për këtë Qeveri, por transporti. Pse? Sepse më lehtë dhe më shpejt vjen deri te realizimi i tenderit. Kështu, riparimi, do të thotë, mbulimi i gropave të rrugës Pejë-Prishtinë ka kushtuar 18 milionë euro. Rehabilitimi i rrugës regjionale Prishtinë-Kaçanik ka koston prej përafërsisht 11 milionë e gjysmë euro. Kërkoj që Qeveria sot të na informojë për punët kontraktuar për vitin 2008. Në raport është shkruar se buxheti është shfrytëzuar 100%, megjithatë kjo nuk është e dokumentuar.

I nderuari zoti kryesues, në vazhdim po fokusohem në Sektorin e shëndetësisë, jo vetëm që nuk janë rritur pagat e punëtorëve shëndetësorë, por as 44 eurot e premtuara nuk janë paguar. Është shokuese zgjidhja që iu ka bërë punëtorëve shëndetësorë për 44 eurot e premtuara.

Qeveria pati marrë vendim që diferencën ta paguajnë komunat. Me këtë vendim Kryeministri e ka shkelur ligjin, sepse pagat paguhen nga buxheti i Kosovës dhe komunat nuk i kanë pasur të planifikuara këto 44 euro.

Të nderuar deputetë,

Në fund, ju ftoj dhe fuqimisht e mbështes propozimin që dha deputeti Shatri dhe ju ftoj edhe juve që fuqimisht ta mbështetni, që të formohet auditimi ose të bëhet auditimi special i linjës buxhetore për investimet kapitale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Mendoj se kolegët para meje kanë kapur shumë aspekte të raportit financiar të Qeverisë për vitin 2008. Unë do të ndalem në disa segmente më konkrete të këtij raporti.

Në faqen 77, te avanset e paarsyetuara, bie në sy një numër i madh i avanseve të organizatave buxhetore që nuk i kanë arsyetuar avanset e tyre. Me këtë prinë Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, veçanërisht në mallra dhe shërbime, si dhe Ministria e Shëndetësisë, por një rast shumë eklatant, që nuk e di se si mund të arsyetohet, është përfshirë në raport dhe nuk ka asnjë lloj arsyetimi, Agjencioni Kosovar i Pronës ka 2 milionë e 205 mijë euro avanse të paarsyetuara për mallra dhe shërbime.

Nuk e di si mund të kalojnë të gjitha këto dhe të jenë në raport e të mos ketë asnjë lloj arsyetimi për këto avanse të paarsyetuara. Po ashtu, ka edhe avanse në Kuvend, pra sigurisht janë avanse individuale, janë 12 mijë euro që nuk janë kthyer. Janë marrë paratë për udhëtime zyrtare dhe nuk janë kthyer në buxhetin e Kosovës, mbahen nëpër xhepa dhe askush nuk mërzhitet për këtë çështje. Po ashtu, edhe Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka 13 mijë euro, pra shumica e ministrive kanë avanse të pakthyera dhe po më duket askush nuk merret me këto.

Një aspekt tjetër që na intereson shumë, e që është bërë shumë fjalë në vitin e kaluar, pra, Konferenca e Donatorëve është mbajtur me një publicitet shumë të madh, kanë qenë premtimet për 1 miliard e 200 mijë euro, kurse nga raporti që e dha ministri i Financave del se kemi pasur 12 milionë euro donacione, do të thotë, vetëm 1% e të gjitha donacioneve të premtuara dhe kjo do një analizë, a është pasojë e problemeve financiare që kanë vendet që kanë premtuar donacione, është pasojë e paaftësisë së Qeverisë që t'i thithë dhe t'i shfrytëzojë donacionet e premtuara. Pra, vetëm 1% prej gjithë atyre donacioneve, mendoj që nuk do asnjë koment.

Ne e dimë po ashtu që kanë qenë ndarë miliona e miliona euro për KEK-un dhe minierat. Tash mund të pyesim a shihet kund ndonjë efekt i gjithë këtyre milionëve të parave të qytetarëve të Kosovës? Vazhdimisht në KEK, ka avari, ka plasje të kazanëve, ka probleme të ndryshme dhe është qartë që atje është krijuar një metodë e përhershme e mënyrës së keqpërdorimit të mjeteve të buxhetit të Kosovës. Pra, kazanët e thellë të KEK-ut, minierat, thellësia e minierave të errëta atje, i përpijnë miliona e miliona pa asnjë efekt dhe askush nuk merret me këtë çështje që të hulumtohet pse nuk është asnjë efekt i këtyre milionëve.

Po ashtu ne e dimë që janë ndarë shumë para të buxhetit për arsim. Janë premtuar kabinete, modernizim i shkollave e tjera. Unë do t'i thosha ministrit të Arsimit meqë është këtu le të shkojë në shkollat e mesme të Ferizajt le ta shohë se në çfarë kushtesh mësojnë nxënësit e atyre shkollave. Mua mu ka rënë rasti të shkoj në Shkollën e Mesme Ekonomike dhe aty të shoh një katastrofë, të shoh banka të thyera, dritare të thyera, dyer të thyera, mure të gërvishura, dyshemeja krejt e shkatërruar. Mendoj që kur unë e kam kryer shkollën e mesme në vitin 1970, kushtet kanë qenë më të mira se tash në disa shkolla të mesme të Ferizajt, dhe çka është më e keqja, në drejtimin -Bankë dhe Financa, lënda kryesore mësohet me shënime, pra nuk ka tekst mësimor për lëndën kryesore të drejtimit -Bankë dhe Financa dhe tash ne mund ta shohim se sa larg është shkolla jonë larg shkollës moderne të pajisur me informatikë, me kabinete e tjera e tjera,

kur për lëndë kryesore nuk ka tekst mësimor dhe nxënësit shtyhen për ta zënë një karrige se nuk ka karrige të mjaftueshme për të gjithë nxënësit e klasave.

Pra, mendoj se të gjitha këto janë një formë e alarmit që ne ta shohim se vërtet kjo Qeveri ka pasur fat që të ketë shumë më tepër mjete të buxhetit, por shpenzimi i tyre nuk është me nikoqirllëk, nuk është duke u shpenzuar aty ku duhet dhe më shumë përdoren ndoshta për një lloj marketingu se sa për mirëqenien e vërtetë të qytetarëve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Kryeministri, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky debat ka koiciduar me mbledhjen e gjashtëmbëdhjetë plenare të mekanizmit përcjellës të stabilizim-asocimit, prandaj dua ta sqaroj fillimisht se e gjithë Kabineti qeveritar ka qenë në këtë takim, me përjashtim të ministritë të Ekonomisë dhe Financave, i cili gjithashtu duhet t'i drejtohet këtij mekanizmi, sepse është agjendë evropiane si dhe të kemi studimin e fizibilitetit dhe duhet t'i prezantojmë edhe të arriturat edhe sfidat edhe vizionin tonë për të ardhmen kur dihet se këtu është zoti Mirell sot në Prishtinë dhe gjithë mekanizmi ndërkombëtar. Prandaj, kjo ka qenë edhe arsyeja e mungesës së një pjese të Kabinetit qeveritar, por jam këtu së bashku me ministrin edhe me ministrat e tjerë, por besoj se edhe vetë prezenca ime si Kryeministër i Kosovës mjafton.

Unë do të isha ndalur në disa çështje, të cilat u ngritën dhe mund të flas edhe në emër të çdo ministri dhe çdo ministrie si Kryeministër i Kosovës edhe pse mungojnë ata për çështje të cilat i ngritën.

Dua të theksoj se ky vit e gjysmë apo këto dy vjet kanë qenë vitet historike të përparimit dhe zhvillimit në Kosovë, vite të suksesit të Kosovës, vite të zhvillimit ekonomik të vendit.

Vetëm nëse shikojmë të hyrat, fillimisht dua të theksoj se vetëm në Dogana janë mbledhur më shumë 13% se sa në vitin 2007, apo 4% mbi plan.

Të hyrat nga Administrata Tatimore kanë qenë 16% më shumë apo 9% mbi plan.

Të hyrat jo tatimore të nivelit qendror në krahasim me vitin 2007 kanë qenë 11% më shumë apo 29% mbi plan.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror, krahasuar me vitin 2007 me Qeverinë që e udhëheq unë, kanë qenë 13% më shumë, apo 13% gjithashtu mbi plan.

Të hyrat vetjake të komunave të komunave kanë qenë, krahasuar me vitin 2007, 46% më tepër apo 12% mbi plan.

Këtu mund ta keni edhe skemën, nëse kamera mund të ofrohet, okej, nëse jo, nëse s'e keni edhe ju secili para veti, mund ta merrni në çdo kohë. Ndërsa, realizimi i buxhetit, të nderuar ministra, te pagat, krahasuar me vitin 2007, kemi realizim të buxhetit 96%, e ritheksoj realizimi i buxhetit për pagat krahasuar me vitin 2007, viti 2008 ka qenë 96%.

Mallrat dhe shërbimet, krahasuar me vitin 2007, kanë qenë 83 për qind. Këtu kemi kursyer 28 milionë, krahasuar me vitin 2007 dhe është kursyer në telefon, në dreka dhe darka, në udhëtime dhe shpenzime të tjera.

Të shpenzimet komunale, realizimi i buxhetit ka qenë 86%

Të subvencionet dhe transferet, realizimi i buxhetit ka qenë 95%.

Shpenzimet kapitale, që u diskutua këtu shumë, kanë qenë 80% apo 124% më tepër se sa në vitin 2007. Në vitin 2007 kanë qenë 154 milionë, në vitin 2008, 347 milionë. Totali i realizimit të Buxhetit 87%. Këtu gjithashtu e keni skemën të cilën mund ta shihni secili nga ju dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe gjithë partnerët ndërkombëtarë.

Sa i përket qirasë, qiraja është zvogëluar për 70%. Kanë mbetur si ministri me qira: Ministria e Arsimit, që është objekti në përfundim e sipër dhe ju e dini si të gjithë dhe disa institucione brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe MEF-it. Shpenzimet janë rritur edhe me formimin e Ministrisë së Jashtme, Inteligjencës së Kosovës dhe të FSK-së.

Tash, të shpenzimet ku ishe këtu më herët, duhet ta kemi të qartë secili siç e dinë të gjithë qytetarët e Kosovës, besoj që e dini edhe ju, por duhet ta rritësh për hir të transparencës edhe më të madhe, kemi rritjen e pagave të arsimtarëve deri në 47%, për herë të parë pas luftës. Kemi ngritjen e pensioneve të kontribut dhënësive rreth 100% dhe kemi fillimin e pagesës së rritjes së të ardhurave dhe pagave për punëtorët e shëndetësisë. Këto janë zotime, janë përgjegjësi dhe këto janë realitete të cilat i prek çdo punëtor i shëndetësisë, punëtor i arsimit dhe pensionist kontribut dhënës.

Shkojmë te ministritë veç e veç. Krahasuar me vitin 2007, ta zëmë, Ministria e Shërbimeve Publike ka rreth 1.818% më tepër. Po, po. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, 144% më tepër, krahasuar me vitin 2007. Këto janë fakte, këto janë shifra, kjo është transparencë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, 172% më tepër. Të gjitha këto ju i keni në tavolinën tuaj.

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit 885% më tepër, deri sa në vitin 2007 kanë qenë si investime 12 milionë, në vitin 2008 kanë qenë 114 milionë. Tash dikush mund të pyes se pse, zoti Koci, unë ju dëgjova dhe Agim. Dikush mund të pyes se pse, a është mungesë e vizionit apo keq menaxhim apo tash është menaxhim i mirë, le të vlerësojnë vetë qytetarët, kur në çdo cep të territorit të Republikës së Kosovës po arrin asfalti, po arrin rruga, po arrin standardi përëndimor, ndërsa autostradat kanë filluar, ju e dini shumë mirë. Prishtinë, në drejtim të Ferizajt ka mbërritur gati në Aeroport. Ju lutem! Do të vazhdojë sivityet në drejtim të Pejës dhe ju e dini për rreth mbi 22 kilometra. Në drejtim të Ferizajt ka përfunduar një pjesë, është duke u përmbyllur dizajni se e kemi gjetur në zero projekt, është duke përmbyllur dizajni dhe do të vazhdojë menjëherë. Në drejtim të Mitrovicës ka filluar dhe tash do të vazhdojë përsëri drejt Vushtrrisë për Mitrovicë. Do të thotë janë projektet të cilat janë duke lëvizur, por unë respektoj procedurat, respektoj sundimin e ligjit dhe respektoj transparencën në këtë drejtim. Prandaj, para se gjithash dua t'ju informoj se Qeveria e Kosovës është e gatshme me

respektimin e procedurave të rregullta në periudhën e dytë të verës së këtij viti të fillojë me ndërtimin e autostradës Merdare- Vërmicë – Prizren, mjetet janë dhe të gjitha këto investime, të nderuar deputetë, nuk po ndodhin me mjete që pikin nga qielli, por me mjete të Kosovës, me mjete që kanë qenë po të njëjta edhe në vitin 2007, por nuk ka pasur investime. Prandaj, këto investime po ndodhin nga kursimet, nga qeverisja e mirë, nga sundimi i ligjit e para se gjithash nga lufta e pa kompromis ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe ndihem tepër krenar që bashkërisht me ju kemi arritur të jemi vendi i fundit në rajon për nivelin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Vazhdojmë! Te Ministria e Shëndetësisë - 142% kemi më tepër.

Te ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit - 329%.

Te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, deri sa në vitin 2007 kemi pasur 11 milionë, tash kemi 35 investime. Zoti Salihaj, unë ju ftoj kur ta vizitoj Ferizajn bashkërisht t'i shohim këto ndryshime që po ndodhin edhe në Ferizaj edhe në çdo fshat, edhe në shkolla, edhe në rrugë edhe në çdo investim. Pra janë këto investime të cilat kanë munguar në periudhat e mëhershme dhe para se gjithash po ju drejtohem si koleg, si deputet t'i gëzohemi këtyre ndryshimeve. Ju jeni nga aty, ju e dini opinionin e qytetarëve të Ferizajt, ju e dini për punën e mirë që është bërë, ju e dini sa shkolla të mesme janë duke u ndërtuar, sa shkolla fillore janë duke u ndërtuar, sa shkolla tjera janë u rinovuar dhe sa të tjera do të fillojnë sivjet.

(Ndërhyrje)

Shkollat janë për nxënësit kosovarë, nuk janë pa nevojë. Ata që mendojnë për të mos investuar në edukim, atëherë ta dini se nuk kanë vizion për të ardhmen. Investimi në edukim dhe në rritjen e pagave të arsimtarëve, edhe në zgjerimin e hapësirave të nxënësve edhe në fillimin e informatizimit të gjitha shkollave nuk do të ndalet. Ky është fillimi.

Vazhdojmë. Te Ministria e Planifikimit Hapësinor, kemi rreth 72%.

Te Ministria për Kthim e Komunitete - 96 %.

Tek administrata e qeverisjes lokale - 2.000%. Po, po! Qe ku i keni! Ju lutem.

Te Ministria e Ambientit - 819%, të nderuar deputetë!

Te Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, kemi për 2.000%. Ju lutem, të mësohemi me transparencë dhe të kuptojmë së prezantuari shifrat dhe faktet. Unë e kuptoj se dikush mund të jetë për kampanjë elektorale, herët është. Nuk vendos se nëse vendosin këto të dhëna mos u merakosni fort për rezultatin e zgjedhjeve.

(Duartrokitje)

Qytetarët vendosin. Do të vazhdojmë me projekte edhe këtë vit. Do të vazhdojmë edhe me përfundimin e projektit madhor të Kosovës së Re, do të vazhdojmë edhe me përfundimin e projektit të konsensionit në Aeroport, të gjitha këto janë në proces e sipër.

Gjithashtu, procesi i privatizimit të distribuimit të KEK-ut dhe ai i PTK-së do të përfundojë në këtë vit. Pra, e gjithë kjo mund të sjell në një konkludim se kjo periudhë, pra viti 2006, ka qenë viti i fillimit të zhvillimit ekonomik dhe viti që ka shënuar rritje të zhvillimit ekonomik rreth 6% në këtë vit të krizës së madhe dhe të rëndë ekonomike globale. Unë dua të jam shumë i sigurtë para qytetarëve dhe para juve. Nuk garantoj rritje të zhvillimit ekonomik edhe sivjet për 6%, sepse është krizë globale, por garantoj vazhdimin e trendit pozitiv. Unë nuk garantoj mrekulli, por ju siguroj se do ta bëjmë punën më të mirë të mundshme, një punë kjo e cila ka për t' u reflektuar në të mirën e çdo qytetari të Kosovës kudo që ai jeton. Ju faleminderit shumë, ne jemi këtu!

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kryeministër!

Për replikë është paraqitur deputeti Adem Salihaj.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti Kryeministër, më vjen mirë që mund të përgjigjem në disa çështje që i theksuat.

Unë jam përditë në Ferizaj, nuk ka nevojë të më thërrisni ju se unë jam përditë aty me ata njerëz dhe me atë popull, por e di gjendjen në Ferizaj më mirë se ju, por nuk prish punë edhe kur jeni, unë mund të vij aty dhe t'i shohim të gjitha përparimet.

Unë thashë, ejani sot shkojmë në Shkollën e Mesme Ekonomike në Ferizaj, nxënësit mësojnë në bodrum me karrige të thyera, me dyer të thyera, me mure të gërvishura, të përlyera e tjera, e tjera, lënda kryesore e drejtimit -Bankë dhe Financa mësohet me shënime dhe nxënësit shtyhen kush po e zë një karrige se nuk ka mjaft karrige.

E dyta, ju thatë që kemi rritje të shpenzimeve të inteligjencës. Cilës inteligjencë, zoti Kryeministër, kur vetëm një person e keni në inteligjencë. E keni një inteligjencë tjetër, ndoshta e financoni atë, aty nuk hyj, por që kjo inteligjenca që është publike dhe legale e ka vetëm një person, me sa dimë ne deri tash.

Ju lutem, kemi rritje, thatë deri 100% e më tepër. Është shumë e saktë, zoti Kryeministër. Kemi rritje, por i keni trashëguar 300 milionë që Qeveria e përparshme s'ka qenë e aftë t'i shpenzojë dhe ju keni pasur fat, natyrisht e keni shfrytëzuar edhe këtu s'mund ta kontestojmë këtë.

Rrugët, zoti Kryeministër, është e vërtetë që keni shtruar rrugë me ata 300 milionë që i keni trashëguar nga Qeveria e kaluar. Është shumë e saktë, ka qindra kilometra.

Zoti Kryeministër, ju ftoj unë publikisht të dalim bashkë dhe t'i shohim ato rrugë që i keni shtruar vitin e kaluar në çfarë gjendje katastrofale janë, të prishura plotësisht. Pas vetëm dy ose tre muajsh, rrugët janë prishur në tërësi.

Qe, unë sot ju ftoj, sot të dalim dhe t'i vizitojmë....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! E shpenzuat kohën. Tani kundër-replikë ka Kryeministri! Sqarim!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Është e vërtetë, s'ma ka përmendur emrin, por jo vetëm me ju zoti Adem, por me çdo deputet jam i gatshëm të bisedoj. Unë jam çdo ditë në terren, ju e dini zoti Adem, unë jam çdo ditë me qytetarët, jam çdo ditë edhe në fshatrat e Ferizajt aty ku mungon, por të ftoj të jesh bashkërisht, por dua të them, ju keni qenë zëvendëskryeministër, keni qenë edhe kryetar i Kuvendit Komunal të Ferizajt. Ato bodrume, nxënësit në bodrume i kemi gjetur, nuk i kam futur unë, të lutem. Dritaret e thyera i kam gjetur, s'i kam thyer unë, s'janë thyer në kohën time. Unë po i ndreq. Muret e përlyera unë i kam gjetur, unë po ndërtoj shkolla të reja. Pluhurin aty unë e kam gjetur. Nuk është i krijuar, unë po bëj hapësira gjelbërimi, ju jeni dëshmitar, keni pasur mundësi të vini në inaugurim, ta mbillni një fidan. Po, po!

(Ndërhyrje)

Sa për informatën tuaj dhe ju e dini, vetëm këtë vit do të fillojmë së ndërtuari, përpos të tjerave që janë duke ndërtuar në Ferizaj, edhe 4 shkolla të reja në qytetin e Ferizajt, prandaj zoti Salihaj, unë jam, ju e dini, unë jam çdo ditë në kontakt me anëtarët e Kosovës. Çdo deputet i opozitës, pozitës kushdo që të jetë, është i mirëpritur të vijë në inaugurimin e projekteve madhore që po ndodhin. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ethem Çeku.

ETHEM ÇEKU: I nderuari, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qeveritarë,

Unë personalisht, them, e ndiej veten shumë mirë kur shteti i Kosovës bën progres. Në qoftë se flasim në shifra të cilat po potencohen këtu dhe u potencuan do të them është bërë punë shumë e madhe. Në qoftë se e shohim kornizën e shpenzimeve, në qoftë se shohim dokumentet e tjera, shohim se sa i përket zhvillimit ekonomik kemi problem me konceptin që ka të bëjë me zhvillimin ekonomik.

Kryeministri i përmendi 6%. Në kornizë thuhet ai maksimumi i zhvillimit të progresit që mundet është në mes 3 dhe 4%. Foli për progresin që është bërë në sektorin e energjisë dhe ne e shohim se vetëm në vitin 2008 për blerjen e energjisë kemi shpenzuar mbi 51 milionë euro, po ashtu edhe më shumë. Në qoftë se flasim për progresin buxhetor, Kryeministër pak është bërë. Është bërë shumë pak, kemi një rritje 6% të hyrave të gjithëmbarshme. Në qoftë se ndalemi në krahasime konceptin krahasimor Qeveria e kaluar, Kryeministër, kemi pasur ngritje buxhetore, nuk kam dashur asnjëherë ta përmend diku mbi 100%. Kemi filluar me një buxhet 480 milionë, kemi përfunduar me një buxhet prej 900 e diçka milionë dhe në 3 vjetët e ardhshme parashihet që të kemi nga 900 e diçka milionë një buxhet në 1 miliardë e diçka milionë euro që po ashtu mendoj Kryeministër se duhet kabineti juaj t'ju ndihmon që të ndërron vizionin e shfrytëzimit të buxhetit. Ne mendojmë që këtu duhet të hapni dialogun e komunikimit. Është mirë që e ftuat një deputet që të jetë me ju në një zhvillim të tillë. Edhe neve po na fton, më në fund, si opozitë, tani e mirë. Po, ajo që për mua është esenciale dhe problemi më i madh janë shpenzimet kapitale, Kryeministër. Buxhetin e Kosovës jemi duke e shpenzuar tërësisht në një pjesë të investimeve kapitale ku ne mund të bëjmë investime të përbashkëta me partnerët publikë dhe privatë, që nënkupton që një pjesë e buxhetit që në vend që do të ishte e orientuar në këta sektorë, do të ishte e orientuar në arsim dhe në disa sektorë në shëndetësi, në ngritjen e pagave dhe në problemet e tjera sociale.

Prandaj, duhet të ndërroni vizionin. Unë së paku mendoj se duhet të ndërroni vizionin e shfrytëzimit të buxhetit sa i përket investimeve kapitale. Nuk mundemi me buxhetin e Kosovës të varfër me 900 e diçka milionë euro dhe me ato 65% të hyrave që krijohen nga Dogana. Unë nuk kërkoj nga ju, po mendoj se ministrat përkatës të dikastereve të caktuara është dashur t'ju sjellin informacione më të qarta, më të plota dhe politika më të qëndrueshme në aspektin e zhvillimit të Kosovës. Ne do t'ju mbështesim vazhdimisht kur është fjala për konceptin e zhvillimit të vendit, mirëpo këto politika të cilat tani janë duke u ndjekur në raport atë që e thatë më herët për Kosovën e Re që përgëzojmë për emrin që ia keni ndërruar, për konceptin e "Trepçës," për KEK-un, për autostradat dhe për projekte kapitale kryeministër mendoj që është koha e fundit për të ndërtuar shtet të fuqishëm, që ndërroni konceptin në shfrytëzimin e këtyre. Mendoj se gabimisht janë duke u orientuar, gabimisht janë duke u krijuar këto politika. Me këto politika vendi nuk ka për t' u zhvilluar, pavarësisht nga cila qeveri. Them ne i gëzohem të hyrave dhe ngritjeve buxhetore që i keni bërë, por ne nuk i gëzohem politikave që kanë të bëjë me shpenzime kapitale. Do ta keni mbështetjen kur është fjala për çështjen e shtetit. Sa i përket politikave, them gabim është, janë duke u orientuar dikasteret dhe njerëzit profesional të cilët mendoj se ju kanë varfëruar në rrethin e juaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka zoti Kryeministër, do të sqarojë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet,
Po, edhe unë si Kryeministër, kam të drejtë kur edhe ju keni të drejtë. Më duket...deputet Çeku...

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, Kryeministri dhe ministrat kanë të drejtë çdo herë, kur e kërkojnë fjalën për të sqaruar në seancë të Kuvendit. Është me Rregullore, lexojeni Rregullën 28 të Rregullores dhe s'keni nevojë për të reaguar.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: ...zoti deputet, Çeku, kolegë,
Ne mund të diskutojmë gjerë e gjatë për të gjitha çështjet. Unë i vlerësoj opinionet e çdo deputeti.

Nëse kthehemi prapa, e përmende periudhën e kaluar paksa, unë nuk dëshiroj të merrem tash me periudhën 2004-2007. Unë mendoj, vetë populli i Kosovës ka folur më 17 nëntor 2007, e ka vlerësuar punën tuaj dhe vizionin për të ardhmen.

Te sektori i energjetikës, ju e dini, ajo periudhë ka qenë 2004-2007, periudha e territ në energjetikë për Kosovën, por nuk janë shtruar as rrugë, nëse keni kursyer, po ju e dini, s'keni kursyer. As nuk janë shtruar rrugë, as nuk janë ndërtuar shkolla, as nuk janë ndërtuar kanalizime, as ujësjellës, as nuk është investuar në ambient, as nuk është investuar në edukim, është investuar shumë pak në sfera...

Unë këtë e vlerësoj, siç e kanë vlerësuar qytetarët në vitin 2007. Nuk dëshiroj tash... Në sektorin e energjetikës, vetëm për një vit është rritur prodhimi për 10%, ndërsa furnizimi për 35% me një menaxhment më të mirë, me një qeverisje më të mirë, e para se gjithash në parandalimin dhe luftimin e pa kompromis ndaj dukurive negative.

Unë këtu nuk akuzoj, prezantoj shifra dhe fakte. E di vullnetin tuaj tuajin personal për të ndryshuar, por tash ju më thatë ta ndryshoj vizionin, ky është vizioni im, pikërisht i dallojmë vizionet, ju jeni atje të ulur, unë jam ulur këtu, deputetë të mi dhe të koalicionit tim. Unë nuk do ta ndryshoj, do ta përforcoj. Ky është vullneti i qytetarëve të Kosovës,

është vizioni im dhe qytetarët e kanë vlerësuar vizionin, por dua të theksoj se nga ato kursime që qenkan bërë në atë periudhë, unë dua të theksoj se vetëm nga ju vini në Pejë vetëm për një vit të qeverisjes sime është investuar më tepër se 6 vitet e kaluara, 7 vitet e kaluara edhe në rrugë, edhe në shkollë, edhe në ambient, edhe në shëndetësi dhe në të gjithë sektorët tjerë. Madje, edhe tek autoritetet komunale është vlerësim edhe i vetë strukturave komunale, prandaj me këto investime nuk do të ndalemi. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, deputeti Çeku.

ETHEM ÇEKU: Nuk do ta quaj replikë, absolut unë e çmoj...

KRYESUESI: Nëse nuk është replikë, atëherë ta marrë fjalën...

ETHEM ÇEKU: Mirë, atëherë lëre replikë! Unë e çmoj atë që thashë edhe një herë, progresin që është bërë në ngritje buxhetore, një progres që ka kontinuitetin e vitit 2007, sepse qeveria ka trashëguar një buxhet dhe është shumë normale për investime. Nuk dua të hudhi as idenë e zgjedhjeve, ato janë çështje të cilat janë përcaktuar nga elektorati dhe do të përcaktohen prapë nga elektorati. Ajo që unë sot e hedh në diskutim dhe do ta hedhim prapë dhe e kemi hedhur vazhdimisht, Kryeministër, buxheti i Kosovës nuk mund t'i mbulojë nevojat për investime kapitale dhe duhet të ndërrojmë konceptin e shfrytëzimit të buxhetit të Kosovës me një lloj partneriteti publik dhe privat. Ju e shihni sa keni shpenzuar, sa po shpenzojmë, është buxhet i yni, nuk është buxhet pozitiv dhe opozitar në këtë rast, është buxhet i përbashkët dhe shihni cilat investime janë duke u bërë dhe a mund ato investime të zëvendësohen me investime të partneritetit publik dhe privat të cilat do të kishin ruajtur buxhetin e Kosovës nga këto shpenzime. Prandaj, kjo ishte jo që ju ta ndërroni vizionin, unë nuk ju ftoj që të vini, të ndërroni vizion, por të ndërroni konceptin e menaxhimit për investime kapitale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën prapë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Çeku, ju e dini, ne bisedojmë edhe në ambiente tjera dhe më relaksuese në kuptimin edhe kemi diskutuar edhe për "Kosovën e Re" dhe ju e dini vullnetin e Qeverisë së Kosovës për mbyllje të procesit sa më shpejt që është e mundur dhe ju jeni shumë i informuar, kështu që nuk dëshiroj ta ngarkoj këtë seancë me ato diskutime që po ndodhin dhe me vizionin që e ka Partia demokratike e Kosovës, natyrisht që ju e thatë, por para se gjithash shteti i Kosovës. Dua të theksoj vetëm diçka...

(ndërhyrje)

... Të lutem, të lutem! Po 2008, 2009 dhe kemi për të folur gjatë. Dua të theksoj, zoti Çeku, keni të drejtë kur e ngritët çështjen e partneritetit publiko-privat. Tash, ne e kemi po atë buxhet që ka qenë edhe më herët, por unë e vlerësoj dhe besoj edhe qytetarët e Kosovës, se ka një menaxhim më të mirë, më efektiv dhe më me dobi të qytetarëve. E fola më herët. Nëse ka zëra kritikë, për mua janë shumë të vlerësuar dhe ndihmues. Jo se ne nuk duam procesin e partneritetit publiko-privat, por ju e dini se s'ka pasur ligj dhe ligji ende nuk ka kaluar. Kështu është. Tash, unë nuk mund të pres mos të ndërtojmë rrugë, mos të ndërtojmë shkollë, se janë mjetet, prandaj ne kemi kursyer, në njërin anë, duke investuar në anën tjetër dhe duke mos ndodhur keqmenaxhim dhe keqpërdorim. Krejt këto investime janë, shumica prej kursimeve.

Sa i përket periudhave kohore, unë jam i gatshëm edhe me ju zoti Çeku, eja këtu, unë dal këtu, flasim për periudhën kohore cilën të duash, vetëm për periudhën 2008 kanë ndodhur investime edhe në qytetin tuaj në Pejë më tepër se 7 vitet e kaluara. Urdhëro, numëromi shkollat që janë ndërtuar nga viti 2004 – 2007 dhe unë t'i numëroj 2008 – 2009. Edhe rrugët, kilometrat 2004 – 2007 dhe unë ti numëroj 2008-2009. Edhe në investime, në të gjithë sektorët...

(Ndërhyrje)

.... Rruga për Rugovën po, pikërisht është shtruar nga Qeveria që udhëheq unë dhe nuk është shtruar nga Qeveria që është udhëhequr apo që kanë qenë përfaqësuesit e tjerë.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dua ta shfrytëzoj rastin në radhë të parë t'ju përgëzoj për arritjen e suksesit për anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në mekanizmat e ndryshme të Bankës Botërore që na hapin perspektiva të mëdha.

Tani jemi duke folur për Raportin e buxhetit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2008. Mendoj se vetëm po qe se do t'ia hedhim një shikim krahasimit të realizimeve që janë bërë flet mjaft dhe ky dallim është diku rreth 300 milionë euro realizimi më i madh për vitin 2008 se sa ka qenë në vitin 2007. Të njëjtat kushte kanë qenë, do të thotë ka qenë mekanizmi i Qeverisë, por kjo Qeveri ka dëshmuar se vërtet di të menaxhojë, se vërtet di të investojë. Edhe te shpenzimet, përkatësisht te shpenzimet kapitale kemi më tepër se dyfishim të këtyre investimeve nga i njëjti buxhet, nga të njëjtat mjete dhe ky është një fakt që duhet ta pranojmë, sepse po e shohin qytetarët e Kosovës. Ne duhet të jemi real dhe duhet të shohim se po ndryshon pamja e Kosovës, po ndryshon në kuptimin më pozitiv dhe thuaja se ka shënime të cilat i përmendi vetë zoti Kryeministër, të gjitha ministrive, por unë do të ndalem në dy aspekte. Një aspekt do ta marr se infrastruktura rrugore po e bën Kosovën me një pamje evropiane, po e bën me një pamje që vërtet çdo pjesë e Kosovës të ketë qasje në rrugët e asfaltuara dhe të mund të komunikojë. Ky është kushti i parë që të mund të lindin bizneset, që të mund të punësohen, që të mund të krijohen perspektiva. Unë po i përmend vetëm dy shembuj sa për të ilustruar dhe këtu duhet të përmend rrugën që ndërtohet për Greme, ku është një prej ngarkesave se popullata më e madhe në komunën e Ferizajt. Do të përmend po ashtu edhe rrugën tjetër në kuadër të komunës së Gjilanit, që lidh fshatin Gadish - Kishna Pole, që do ta lidhë me tërë pjesën e Kosovës dhe këto hapin mundësi të reja për biznes. Do të thotë, për vende të reja të punës, për zhvillim të ri. Ne jemi të gjithë dëshmitarë se me të njëjtat mjete grandet e Qeverisë për zhvillimin e komunave janë shumë herë më të mëdha. Unë jam qytetar i Ferizajt, jetoj në Ferizaj dhe e shoh se për një vit të qeverisjes me përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës ka ndryshuar pamja e qytetit të Ferizajt, ka marrë pamjen e një qyteti të mirëfilltë dhe ai është vetëm fillimi. Kështu është edhe në shumë komuna të tjera dhe ajo çka meriton lëvdatë kjo Qeveri e tashme, është se nuk ka diskriminuar komunat, pavarësisht se cila parti e ka udhëheqjen komunale, por ka investuar në proporcion sepse shihet se qëllimi është që të zhvillohet Kosova, të zhvillohen të gjitha qytetet dhe jo vetëm ato qytete ku e ka qeverisjen PDK-ja.

Do ta theksoja edhe me qenë se këtu u përfol, sado që të gjithë ne jemi dëshmitarë. Do të theksoj edhe çështjen e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë. Është e vërtetë se nëse i shohim në kuadër të shpenzimeve, përkatësisht investimeve kapitale, kemi një ndërrim të madh të gjendjes që nuk ka arritur të bëhet prej pas luftës deri në fund të vitit 2007. Vetëm në vitin 2008 janë ndërtuar shkolla të reja që nuk kemi mund as t'i imagjinojmë. Kjo flet për një menaxhim të mirë dhe të suksesshëm. Kjo pikërisht flet për krijimin e parakushteve që nxënësit tanë të kenë mundësi më të mira për t'u përgatitur të jetë mësimdhënia më në nivel dhe të ketë mundësi vërtet që kur të fillojmë në tërësi dhe të përfshijnë gjithë Kosovën reformat, ta kenë terrenin paraprak.

Pavarësisht përshtypjeve individuale, ne do të ishte mirë që të jemi real, t'i pranojmë sukseset dhe vetë fakti që kjo qeveri ka realizuar për diku 44% më shumë nga buxheti i vet se sa qeveria e mëparshme, tregon se kjo qeveri po menaxhon mirë, po qeverisë mirë dhe vërtet sukseset gjatë këtij viti në këto sfera do të vazhdojnë të kenë rritje. Unë dëshiroj që në disa sfera të tjera, sikurse të kishim pasur një buxhet më të madh, me siguri që do të kishte edhe shumë më tepër, por ky është buxheti ynë, jemi duke kaluar nëpër një fazë të krizës globale që dashje e pa dashje reflektohet tek ne, reflektohet po shohim edhe tek çështja e donatorëve të huaj dhe megjithatë në këtë gjendje të ketë një menaxhim të tillë, kjo qeveri meriton përkrahje, meriton lëvdata dhe do të ishte mirë që nga ky Kuvend t'i japim mbështetje të fuqishme, të japim mbështetje edhe morale për punët që i ka bërë mirë me qëllim që të vazhdojë kështu. Unë kam bindjen se me një vazhdim të një menaxhimi të kështillë, Kosova brenda këtij mandati të kësaj Qeverie do ta ndryshojë pamjen që kur të bëhen krahasimet të gjithë ne, edhe ata që sot i kundërshtojnë, do t'i pranojnë.

Në këtë Qeveri nuk ka pasur skandale të cilat kanë shënuar bllokime të rrugëve që kanë qenë arterie kryesore, nuk ka pasur skandale të tjera që e kanë ulur autoritetin e Kosovës, përkundrazi dhe të gjitha këto kanë një shënim, shënojnë një sukses. Dhe, aty ku ka ndonjë të metë, ne duhet ta mbështesim dhe duhet ta përkrahim që të ecën puna përpara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën deputeti, zoti Smaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,

Zotëri Kryeministër, ministra,

Deputetë të respektuar,

Ky dokument që na e kemi sot këtu në trajtim, është përgatitur ashtu si duhet, i ka të gjitha komponentet që vlen për ta miratuar, po natyrisht nga një analizim kritik mund të nxirren edhe disa konkluzione që do të ishte mirë për t'u rishikuar, për t'u korrigjuar, sepse asgjë nuk ka të përsosur, s'do të ketë, kemi dëshirë por është e pamundur. Disa thekse, që do të kisha pak dëshirë që të rishikoheshin dhe në proces e sipër të përmirësoheshin.

Transferet e larta, ka shumë, në disa segmente, bie fjala MASHT-i ka pothuaj se sa të hyrat. Këtu s'po komentoj, se mund të flitet shumë gjatë. Bie fjala, është premtuar që Universiteti duhet të pavarësohet financiarisht e tjera, e tjera. Nga raporti, nga të dhënat del se nuk është, madje është shumë i centralizuar dhe njësitë akademike nuk kanë kurrfarë autonomie që do të duhej të kishin.

Në dokument shkruhet rroga – paga, e në gjuhën shqipe rrogat dhe pagat janë të njëjta. E tash, ka diferenca diskutabile ndërmjet buxhetit fillestar dhe buxhetit përfundimtar 2007-2008, ka diferenca që mund të komentohen sa të duam dhe të shkruajmë bile mjaft gjerë kështu e tjera, e tjera. Bie fjala, konsideroj se shuma e gjobave do të duhej të ishte më e lartë se sa në vitin e kaluar, se nëse i marrim këto të dhënat nga gjyqësori, del se veprat dhe aktet penale janë në rritje, nuk janë në zbritje. Ne kemi dëshirë që të ishin jo në zbritje po të eliminoreshin. Prandaj, në atë kontekst edhe lartësia e gjobave do të duhej të ishte shumë më e lartë, shuma.

Banderollat, bie fjala, edhe aty shuma është dukshëm më e ulët se sa në vitin 2007-2008.

Grandet janë të ulëta, po mendoj, në krahasim me 2007. Interesat bankare, po asisoj janë shumë të ulëta në krahasim me 2007.

Shpenzimet tjera, kjo gjithë – kurrë nuk më ka pëlqyer, kjo shpenzimet tjera. Ne s'po na dhimben letrat me nga 100 faqe, po marrim materiale panevojshëm se do të kishim mund t'i marrim nga 7-8 faqe këto për deputetin-deputeten, a po jo, po cilat janë ato shpenzime tjera. Menjëherë hapet dilema, a thua çfarë janë dhe nuk është ajo terminologji as adekuate, as korrekte. Madje, këtu tash në këtë pozicion janë dukshëm shpenzimet të tjera, të quajtura të tjera, më të larta në vitin 2008 se në 2007.

Për mobile dhe për pajisje, ju lutem, nëse në vitin 2007 janë bërë 7.7 mijë a 7 milionë, në 2008 8.8 e tash po thua se kjo po i del disi sikur mos të kishte pas fare mobile, absolutisht, dhe sikundër abinicio të ishin pajis objektet tona zyrtare me këto. Po, atëherë, nëse e marrim atë shumë që është investuar një vit më parë, plus këto del se me të vërtetë në këtë pozicion është bërë një shpenzim i pamëshirshëm. Edhe në derivate, po asisoj. Edhe për qiratë, u fol për qiratë. E është e keqja më e madhe se ka shumë objekte që janë ndërtuar ilegalisht dhe tash, sa unë di, ndoshta bile kam dëshirë që të mos ishte ashtu çfarë unë di, se në objekte ilegale, ilegalisht informale të punuara ka dikastere tona, ministri apo departamente të caktuara.

E tash, për të qenë ironia e faktit, pagesat për familjet e viktimave në 2007 ishin 4 herë më të larta se sa në vitin 2008. Po ato familje janë, ato që ishin anë, bile-bile problemet e tyre, hallet e tyre rriten me vite. Kjo për mua është pikëpyetje. Pse ashtu?

Ka shumë mjete të alokuara në projekte jashtë buxhetore. Ju lutem, kjo është e palejueshme, a. Bile-bile, me shuma të larta. Ka raste kur bëhen pagesa, dy herë bëhen pagesa e shërbimeve, përkatësisht e investimeve. Konkretisht, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë. Qysh më lejohet, qysh lejon shoqëria politike kosovare moderne që të bëhen advain... parapagesa, edhe ato të mos arsyetohen. Po ajo është plaçkitje. Merr para buxheti, fut në xhepin e vet dhe nuk i kthen, nuk i arsyeton. Po, duhet çdo cent të arsyetohet, e nëse nuk arsyetohen, do të duhej të merreshin masa.

Më shqetëson shkalla tepër e ulët e donacioneve, e realizimit të ulët të donacioneve. Më pastaj, fatura të papaguara ka shumë. Prinë Zyra e Kryeministrit, MASHT-i dhe Ministria e Drejtësisë, sidomos. Do të duhej ky dokument të shpallej më parë në “Gazetën zyrtare”, se çdo qytetar i Kosovës i interesuar, qoftë edhe për një cent ku shkon.

Kam dëshirë ta shfrytëzoj këtë auditor, ta them këtë. Çdo sukses i Qeverisë është sukses i mirëpritur, tepër i mirëpritur për këdo qoftë, prandaj qortimet dhe vlerësimet kritike, zotëri Kryeministër, duhet të merren medoemos si qëllimmira, sepse në punën tonë të

përbashkët, apo jo, në këtë rast ju jeni ai që e prezantoni Qeverinë, po është fjala për ekzekutivin, do të thotë është e pamundur që të mos ketë lëshime dhe defekte, prandaj konsideroj se kontributi ynë do të ishte që të japim aq sa mund të japim në funksion të realizimit të buxhetit asisoj. Fundi i fundit, buxheti miratohet me ligj, është fjala për ligjin dhe do ta përfundoj. Konsideroj se Qeveria tani për tani, flasim për dokumentin e Qeverisë, do të duhej të ishte absolutisht energjike kundër shkeljes së Kushtetutës dhe të ligjit. Kudo qoftë, kur do qoftë të reagoje me të gjitha instrumentet, me të gjitha mekanizmat e kurrësi mos të konformojë me shkelësit e akteve juridike që na obligojnë të të gjithëve, shtetin dhe individin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi, Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI THAÇI: Unë thashë ka koinciduar takimi i mekanizmit përcjellës me këtë takim, prandaj pasi që unë kam përfunduar atje agjendën, kam ardhur këtu që të flas në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe kur flet Kryeministri, përmbledh punën e të gjitha ministrave.

Unë do të dëshiroja që të jenë në sallë edhe deputetët që ngritën çështje këtu, të cilat mendoj se e meritojnë përgjigjen e shifrave dhe të fakteve, edhe zoti Çeku, edhe zoti Kosumi, edhe zoti Shatri, edhe Selmanat.

Tash, unë dua të theksoj se vetëm në Pejë, në periudhën 2004-2007 ka filluar së ndërtuari një shkollë, s'ka përfunduar. Vetëm për një vit të Qeverisë që e udhëheq unë ka filluar ndërtimi në Raushiq, i shkollës, në Glllogjan të Pejës, Osdrim dhe Lutogllavë. Për sivjet edhe tri shkolla të tjera – e mesme në Pejë, Novosellë dhe Jabllanicë.

Për çdo sektor, të nderuar deputetë...

(Ndërhyrje)

... Të lutem! Për çdo sektor, të nderuar deputetë, jemi të gatshëm të përgjigjemi me shifra dhe fakte, qoftë për shkolla, qoftë për investime në edukim, qoftë në rrugë, qoftë në ambient, qoftë në të gjithë sektorët që ju mendeni se ia vlen për të diskutuar dhe këtu jam për të diskutuar dhe prezantuar shifra dhe fakte.

E përmendi dikush – po ndërtohen shkolla. Duhet të vazhdohet së ndërtuari me shkolla, por dua të theksoj se në periudhën 2004-2007 po ky buxhet ka qenë. Unë dua t'i përmend investimet të cilat po ndodhin në periudhën time. Le të krahasohen me më herët. Nuk dëshiroj të merrem... Por kisha pasur dëshirë që të jenë edhe ministrat, edhe deputetët që më herët kanë qenë atje ministra dhe që reflektoni në opinionet e tyre, të jenë edhe të ballafaqohen.

Unë dje kam qenë në Dardanë – Kamenicë. Dhe, për tri vite atje është investuar në rajonin e Anamoravës 1 milionë e 800... Po, po, për regjion. Ndërsa, për vetëm një vit të Qeverisë që udhëheq unë, janë investuar 5 milionë euro vetëm në Kamenicë – Dardanë. Krahasoni. Këto janë shifra, fakte. Merrni, krejt janë në letra. Krejt janë dokumente zyrtare. Krejt janë transparente. Për tri vite në një regjion - 1 milion e 800, periudha 2004-2007. Për një vit, investime vetëm në Dardanë - 5 milionë euro investime dhe këto janë investime për të mirën e qytetarëve të atij regjioni, për një vit. Do të vazhdojmë.

Për ndërtimin e shkollave dua t'ju theksoj, të nderuar deputetë, për periudhën e vitit të kaluar edhe për sivjet. Ka filluar së ndërtuari ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Godanc – Glllogovc, ndërtimi i shkollës fillore “Lazgush Poradeci” në Gllavicë – Shtimje. Vazhdimi i punimeve në shkollën e mesme në Novo-Bërdë. Ndërtimi i shkollës fillore në Lutogllavë, Pejë, Ndërtimi i shkollës fillore në Raushiq – Pejë. Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme “Iliria” në Mitrovicë, faza e dytë. Ndërtimi i shkollës në Prizren - Ortokoll. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Suharekë. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore Prizren, faza e dytë. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Tefik Çanga” në Nikadin – Ferizaj. Ndërtimi i shkollës fillore “Tefik Çanga” në Ferizaj, faza e parë... Pastaj, ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Zekiria Rexha” në Gjakovë. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Vushtrri. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Vushtrri – qytet – Akrashticë. Kamenicë, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen “Malësi” Kamenicë. Obiliq, ndërtimi i shkollës fillore Plemetin – Obiliq. Glllogovc, ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Bashkimi”. Klinë, ndërtimi i shkollës fillore Gjurgjovikë – Klinë, ndërtimi i objektit të shkollës së mesme në Junik, pra ndërtimi i shkollës së mesme në Junik. Istog, i nderuari zoti Shatri, ndërtimi i objektit shkollës fillore “Ismail Qemajli”- Saradran, Istog. Obiliq, ndërtimi i objektit të ri të shkollës fillore në Milloshevë. Vazhdojmë, Prizren, ndërtimi i shkollës së re në Prizren. Prishtinë, ndërtimi i shkollës së re në Prishtinë. Prishtinë, ndërtimi i shkollës së mesme Prishtinë, e përgjithshme. Gjilan, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në lagjen 8 – Gjilan. Gjilan, ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Agim Ramadani” Zhegër. Viti, ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Faik Konica” në Viti. Ndërtimi i objektit të shkollës së mesme në Glllogovc. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan. Kaçanik, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Begracë – Kaçanik. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore Gjyrakoc – Istog. Mitrovicë, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Shipol. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës filloren në fshatin Peran – Podujevë. Ndërtimi i shkollës fillore Shtime – Molopolc. Shtime, ndërtimi i objektit të shkollës fillore – Shtime. Gjakovë, ndërtimi i objektit të shkollës së mesme të muzikës “Prenk Jakova” në Gjakovë. Ferizaj, ndërtimi i shkollës fillore. Obiliq, ndërtimi i objektit të ri për shkollë fillore në Obiliq. Vazhdojmë, kërkuat shifra dhe fakte, këtu krejt janë shifra dhe fakte dhe objektet të cilat janë duke u ndërtuar.

Vazhdojmë, shkojmë përsëri në Pejë – shkojmë përsëri në Pejë, i nderuari Çeku. Renovimi i objektit të shkollës ekonomike në Pejë, ndërtimi i shkollës fillore në Glllogjan. Prishtinë, ndërtimi i shkollës fillore në Bardhosh. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës fillore në Letancë – Podujevë. Milloshevë, ndërtimi i shkollës së re në Malishevë.

Të nderuar, një pjesë e opozitës, ju kisha ftuar që të keni mirëkuptim, sepse vetë elektorati që ju ka votuar nga zonat dhe fshatrat e juaja do t'ju qortojë.

Ferizaj, ndërtimi i shkollës së edukatës fizike në shkollën fillore “Gjergj Sereqi” në Ferizaj dhe në këto shkolla kanë për të mësuar edhe fëmijët e juaj dhe të gjithë fëmijët e Kosovës. Viti, ndërtimi i shkollës fillore “Hasan Alija” në Remnik – Viti. Vazhdojmë me Mitrovicën, ndërtimi i objektit të shkollës “Aziz Sylejmani” në Lagjen “Kodra e Minatorëve”. Pejë, ndërtimi i objektit “Sami Frashri” në Orzin – Pejë, Pejë, përsëri. Prishtinë, ndërtimi i objektit nga Fakulteti i Edukimit. Prishtinë, ndërtimi i objektit të MASHT-it. Pejë, përsëri vazhdimi i punimeve në shkollën fillore “Dardania” në Pejë. Glllogovc, ndërtimi i objektit të shkollës fillore “Bajram Curri”. Suharekë, renovimi i shkollës fillore “11 Marsi” në Sopi, Suharekë, renovimi i shkollës fillore “Dëshmorët e Tivarit” në Peçan. Deçan, shkojmë, të nderuar Selmana, vazhdimi i punimit të shkollës

filllore në Strellc – Deçan. Podujevë, ndërtimi i shkollës filllore “ Azem Bejta” në Kërpime – Podujevë. Vahdojmë. Këto janë shifra dhe fakte – vazhdojmë. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Letancë – Podujevë. Gjakovë, ndërtimi i shkollës filllore “Zekirija Rexha” –Gjakovë. Istog, vazhdimi i punimeve “Martin Camaj”-Gjurakovc. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në fshatin Peran. Pejë, përsëri, ndërtimi i shkollës filllore Lutogllavë - Pejë.

Ferizaj, ndërtimi i objektit “Tefik Çanga” dhe ..., Ferizaj. Gjilan, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në lagjen 8 – Gjilan, Gjilan, përsëri, ndërtimi i objektit të shkollës filllore “Agim Ramadani “ Zhegër. Pejë, përsëri, ndërtimi i objektit të shkollës filllore “Sami Frashri” Orzin-Pejë. Skenderaj, ndërtimi i objektit të shkollës filllore “Azem Bejta” në Prekaz – Skenderaj. Pejë, ndërtimi i ndërtimi i objektit të shkollës filllore Raushiq – Pejë, Vushtrri, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Vushtrri. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore “Zahir Pajaziti” në Orllan. Obiliq, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Milloshevë. Gjakovë, vazhdojmë, Suharekë, Klinë, Ferizaj. Ndërsa, përsëri, përsëri vazhdojmë, se ka ende, shifra dhe fakte. Këto janë objekte që njerëzit i shohin. Skenderaj, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Turiqevc. Prizren, ndërtimi i objekteve të shkollës filllore për minoritetet në Brogazhdë. Podujevë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Bradash. Prishtinë, Gjakovë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Demjan, Gjakovë. Prishtinë, renovimi i Institutit Albanologjik. Prishtinë, konkurs projektimi për shkollën speciale Prishtinë.

Deçan, punimi i bustit në shkollën e mesme “Vëllezërit Frashri” – Deçan. Klinë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Klinë të Epërme. Suharekë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në Suharekë. Prishtinë, teknologji informative në arsimin parauniversitar. Suharekë, ndërtimi i ... në shkollën filllore në Javor, Suharekë. Prishtinë, ndërtimi i shkollës së mesme të muzikës “Prenk Jakova” – Prishtinë. Prishtinë, ndërtimi i objektit të shkollës filllore në lagjen “Kalabria 2” në Prishtinë, faza e dytë, e të tjera e të tjera, ndërsa për çështje dhe më praktike mundet edhe ministri. Nëse doni për t'i numëruar edhe projektet e rrugëve edhe të gjitha projektet tjera, të nderuar deputetë, derisa ju të jeni të gatshëm, unë jam këtu dhe do të jem në shërbim të qytetarëve. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kryeministër! Fjalën e ka deputetja Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Duke mos dashur të ndalem në lëshimet teknike të këtij raporti apo te struktura e raportit, do të fokusohem në disa gjetje konkrete, zoti Kryeministër, që burojnë nga ky raport dhe për të cilat besoj se ia vlen të debatohet në këtë Parlament. Vërejtjet e mia janë: në anën e të hyrave tatimore, vihet sërish re një rritje e rolit të doganave në mbushjen e buxhetit të shtetit. Në fakt, rritja e të hyrave nga doganat, në krahasim me vitin 2007, është më e lartë se sa rritja respektive për tatimet e grumbulluara nga Administrata Tatimore dhe ato 13,7% kundrejt 10%. Kjo bie ndesh me synimet afatgjata të deklaruara, sipas të cilave duhet të fuqizohet roli i Administratës Tatimore.

Ky sistem tatimor që mbështetet kryesisht në dogana, nuk është i qëndrueshëm dhe në fakt është karakteristikë e vendeve të varfra me sistem rudimentar tatimor. Nga tabelat e prezantuara po ashtu vërehet ende roli simbolik i tatimit në të ardhurat personale, i cili gjeneron më pak se 5% të hyrave buxhetore.

Nën dy, zoti Kryeministër, ne të gjithë juve ju dëgjuam, ju tash nuk keni aspak, injoroni kur dikush flet. Zoti ministër, unë ju kisha lutur, ne ju dëgjuam juve pesë gjashtë herë, në qoftë se mundeni, se unë me të vërtetë po dua disa përgjigje në këto pikat që unë do t'i lexoj.

Qeveria jonë ka proklamuar uljen e tatimeve për bizneset duke filluar që nga viti 2009. Mirëpo, kjo ulje nuk ka përfshirë edhe kompanitë e sigurimeve për të cilat ende vazhdon të aplikohet norma prej 7%, mbi vlerën bruto të polisave të sigurimit. Këtyre kompanive u duhet një normë fitimi prej 70% nëse duam që norma efektive e tatimit të jetë 10%, siç është rasti me korporatat tjera. Duke qenë se sigurimet janë mall me rëndësi, mendoj se Qeveria duhet t'i motivojë qytetarët të blejnë më shumë sigurime, por kjo nuk arrihet me norma aq të larta të tatimit, të cilat pastaj detyrojnë kompanitë t'i rrisin çmimet e polisave të sigurimit.

Po ashtu, në tabelat e prezantuara vërehet se depozitat e kompanive që organizojnë lojëra të fatit janë vetëm 2.1 milionë euro, mbase do të ishte mirë të prezantohet më shumë informatë rreth kësaj shifre. Mendoj se kjo shumë do të duhej të ishte më e lartë, do të duhet ta kemi një sqarim për këtë, zoti Kryeministër.

Në anën e shpenzimeve publike, vërehet një rritje e ndjeshme e subvencioneve. Në fakt, pjesa më e madhe e kësaj rritjeje shkon në favor të subvencioneve për ndërmarrjet publike e në dëm të rrjetit për mbrojtje sociale. E keni në faqen 25. Kështu shpenzimet për pensionet invalide, ndihmat sociale dhe për familjet e viktimave të luftës, kanë përjetuar turrje gjatë vitit 2008. Një vend që ka mbi 40% të popullatës në nivelin e varfërisë, nuk bën politikë të përgjegjshme se ulë edhe më tej nën nivel shpenzimet për këto kategori të pambrojtura të shoqërisë.

Ajo që po ashtu vërehet nga ky raport, është anashkalimi i mëtejshëm i një sektori vital të shoqërisë, gjegjësisht atij të shëndetësisë. Qeveria jonë ende shpenzon më pak se 8% të buxhetit të saj për shëndetësi, shumë kjo shumë e vogël në krahasim me vendet tjera. Jo vetëm që nuk janë rritur pagat të cilat janë premtuar, por as edhe 44 euro nuk kanë marrë punëtorët shëndetësorë. Kjo e bën që puna në sektorin shëndetësor të jetë..., punëtorët shëndetësorë vazhdimisht të kërcënojnë me greva, që duhet të jetë brengë e kësaj Qeverie.

Nëse shikohet mënyra e përdorimit të mjeteve pashpenzuara buxhetore, shihet se pjesa absolute e këtyre mjeteve mrizon në konton e Qeverisë pranë Bankës Qendrore. Një vend i varfër si Kosova, me nxjerrje të vazhdueshme të keshit nga ekonomia, siç është rasti me të hyrat nga privatizimi, Trusti i Pensioneve apo edhe me fitimet e PTK-së, nuk mund t'ia lejojë vetës luksin e ngrirjes së shumave kaq të mëdha financiare. Kjo, për mendimin tim është edhe menaxhim i dobët i politikave monetare. Me sa di unë, edhe vendet e avancuara ekonomikisht i mbajnë mjetet buxhetore shtetërore nëpër banka komerciale dhe i bartin ato në konton e bankës qendrore vetëm kur duhet të bëjnë pagesë. Qeveria jonë vazhdimisht është deklaruar për domosdoshmërinë e uljes së normave të interesit në ekonomi, por në të njëjtën kohë stimulon rritjen e këtyre normave, duke nxjerrë keshin nga sistemi financiar. Për një politikë të tillë, nuk ka asnjë argument të shëndosh ekonomik e as politik. Si mund të shkojmë ne dhe t'u themi investitorëve potencial se Kosova është vend i sigurt për investime, kur vetë Qeveria e konsideron sistemin financiar si jo të denjë për plasimin e parave të saja.

Në këtë raport financiar për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës për vitin 2008 ofrohet një listë e gjatë e rrugëve dhe e shkollave, që i dëgjuam zoti Kryeministër nga ju. Kjo doemos është mirë për ekonominë e vendit, por besoj se Qeveria duhet të ketë të qartë se termi qeveri dhe qeverisje me vendin përfshinë shumë më tepër se shkolla dhe rrugë. Qeveria nënkupton edhe shtetin social, nënkupton edhe stabilitetin edhe mbrojtje të të drejtave të pronësisë, mbrojtje dhe avancim të ekonomisë së lirë, krijim dhe implementim të politikave të suksesshme për zvogëlim të papunësisë në vend, përpjekje për përmirësimin e balancës sonë tregtare, liri biznesi, mbrojtje nga monopolet e shumë e shumë tjera.

Qeveria nënkupton edhe përkujdesje për të pastrehët, andaj është i pakuptimtë mosrealizimi i projekteve investive për qendrat sociale në disa komuna të vendit. Qeveria nënkupton edhe siguri të një ambienti të durueshëm për jetë për qytetarët e vendit, andaj është i pakuptueshëm nën shpenzimi aq i madh i Ministrisë së Ambientit. Kjo Ministri ka arritur të shpenzojë vetëm 27% nga investimet në infrastrukturë dhe janë joserioze. Nëse në afat të gjatë nuk parashihihen edhe financimet e mjaftueshme për mirëmbajtjen e aseteve të ndërtuara, në të kundërtën kjo infrastrukturë e re rrezikon të amortizohet shumë shpejt.

Përkundër përmirësimeve të dukshme në shkallën e realizimit të shpenzimeve kapitale nga një sërë agjencionesh shpenzuese, megjithatë në disa sosh vërehet një dështim total. Kjo vlen edhe për agjencione shpenzuese me rëndësi, si Ministria e Drejtësisë, ajo e Ambientit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, por edhe komunat ekonomikisht me rëndësi të vendit, si Prishtina dhe Peja.

Në rastet e caktuara, norma e realizimit të shpenzimeve kapitale është shqetësuese apo më pak se 25%.

Të nderuar deputetë,

As institucioni ynë nuk është i kursyer nga kjo mangësi. E kemi pak sa të vështirë të adresojmë kritika për nënshpenzime të mjeteve të alokuara për agjencionet e tjera shpenzuese, kur edhe vetë Kuvendi nuk ka shpenzuar as 30% të mjeteve të dedikuara për investime. Nga tabela për përdorimin e mjeteve nga kontingjenti i PSSP-së, vërehet një fokusim i plotë në zyrat e komuniteteve, pa dashur që në këtë vend të nënvlerësoj rëndësinë e këtyre zyrave, mendoj se PSSP-ja është dashur të tregohet më neutrale dhe të mbështesë edhe projekte apo raste urgjente, nga të cilat do të përfitonte edhe komuniteti shumicë i vendit.

Krejt në fund, një vërejtje e rastit, e nuk janë pak në këtë raport. Nga tabela e shpenzimeve të parapara për agjencionet ndryshme shpenzuese, vërehet se në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë kanë qenë të alokuara hiq më pak se 50.000 euro për blerjen e një veture. Pa dashur t'i minimizoj nevojat e kësaj Ministrie, mendoj se gjatë planifikimit të shpenzimeve të tilla nuk duhet ta harrojmë se jemi vendi me buxhetin më të varfër në Evropë si dhe vendi me sistemin social më rudimentar. Mendoj se dalim joserioz edhe karshi bashkësisë ndërkombëtare, nëse zyrtarët e një vendi si Kosova enden me veturat më luksoze të rajonit.

Në rastin që e potencova, duhet të theksoj se vetura rezulton jo e blerë, por ajo që më brengos është vetë fakti i planifikimit të blerjes së një veture të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Lulzim Zeneli!

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zoti Kryeministër,

Patëm rastin t'i dëgjojmë jo vetëm anën opozitare deri tash, por edhe anën, siç e quajti Kryeministri, fakte dhe argumente, që në fakt si deputet i Kuvendit të Kosovës, do ta kishim privilegjin që këto fakte dhe argumente që u paraqitën këtu, t'i kemi edhe ne, sidomos kur kemi të bëjmë me shifra aq shumë të ekzagjeruara, megalomane, që ne nuk i kemi në materialin tonë. Nëse thuhet se sot gjendja e arsimit në Republikën e Kosovës, ka përmirësim të dukshëm të pagave dhe kjo pagë është rritur për 47%, atëherë e dinë vetë arsimtarët. Shkojmë tutje. Unë ju dëgjova, dëgjoni tash. Dilni ju dhe argumentoni të kundërtën. Okej.

Nëse thuhet se kjo Ministri ka ndërtuar politika të mirëfillta qeverisëse dhe politikat të mirëfillta qeverisëse sot nënkupton shumë më shumë se të ndërtohet një rrugë dhe një shkollë. Çka do të thotë kjo? Do të thotë kjo se qeverisja e mirë dhe politikat zhvillimore të një qeverisjeje, të një Qeverie të pavarur, të shtetit të pavarur sot llogariten me krijimin e ambientit investiv, me sundim të ligjit, me investime direkte dhe këtu Qeveria e Kosovës do të duhej të na thoshte. Motoja e kësaj Qeverie në fillim ka qenë: qeverisje efikase, transparente, e mirë, anashkalimi apo në një mënyrë ta largojmë luksin qeveritar, ta largojmë keqpërdorimin e parasë publike, mirëpo ajo çka ne sot i kemi dhe unë do të thirrrem në disa argumente konkrete, tregojnë të kundërtën. Mungesa e vizionit dhe e politikës qeveritare, dhe në këtë rast, pa keqkuptime, në Zyrën e Kryeministrit është vërejtur në investime për kapitale për promovimin e investimeve, ku kanë qenë të dedikuara afër 3 milionë euro, dhe janë investuar 0%, janë realizuar 0%. Çka do të thotë kjo? Kjo do të thotë mungesë e vizionit për të tërhequr investitorë të jashtëm. Sot lufta e gjithë qeverive në rajon fokusohet në drejtim të krijimit të ambientit investues dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, ky koncept tek Qeveria aktuale nuk ekziston.

Ne jemi orientuar diku tjetër. Ky buxhet i Republikës së Kosovës, sado që është buxhet i vogël, i madh, është dedikuar buxhet shpenzues, nuk ka buxhet regjenerues të krijimit të të hyrave të reja ku do të krijonte edhe mundësi të reja për zhvillim ekonomik dhe uljen e papunësisë. Kjo tek ne nuk ndodhë, prandaj edhe mund të flasim sot më ndryshe.

Krahasimet që bëhen në këtë Kuvend me vitin 2007 dhe 2006, profesionalisht dikush mund t'i quan të nivelit të duhur, politikisht të papërgjegjshme për Kuvendin e Kosovës dhe qytetarët e Kosovës. Pse e them kështu? Qeveria duhet t'i bëjë krahasimet me premtimet që i ka dhënë dhe realizimet që kanë ndodhur në fund të vitit 2008. Nëse flasim kësaj, atëherë ne po iu ikim premtimeve që i kemi dhënë në fillim dhe sot po flasim për diçka tjetër. Atëherë, shtrohet pyetja, ajo gjithë kjo periudhë ku kemi proklamuar vizion qeverisë, ku kemi proklamuar ambient investues, ku qëndron sot? Kryeministri tha -mos u brengosni për zgjedhje. Kjo është një porosi jo e mirë për arsye se paraprakisht po dihet rezultati. Prandaj, unë kujtoj se në qoftë se dihet kesi soji, atëherë ne nuk kemi pse të hyjmë në zgjedhje.

Nëse kalojmë në mallra dhe shërbime, thanë parafolësit që është imixhi më i dobët i kësaj Qeverie kur është proklamua se do ta zvogëlojë luksin qeveritarë të qeverive më të hershme dhe në anën tjetër kemi rritje të shpenzimeve, është një parametër jo i mirë dhe unë kujtoj që në këtë plan Qeveria e Kosovës nuk duhet as të përmend asnjë element për arsye se gjithë indikatorët tregojnë të kundërtën. Ajo çka ne do të duhej sot ta demonstrojmë se kjo qeverisje e Kosovës sa ka vizion por nikoqirllëk të mirë, kjo nuk

ekziston. Nuk po flasim për cilësi, ajo nuk ekziston në asnjë sektorë për arsye se cilësia në Kosovë sot nuk zë vend, nocioni cilësi dhe ne jemi lëshuar në investime sasiore dhe këtu kemi të bëjmë me diçka që do të na përcillet vazhdimisht edhe në vitin e ardhshëm edhe në vitin 2011 e me radhë.

Ajo norma e realizimit të investimeve të zotuar, që kanë qenë në këtë plan, është shqetësuese, dikush e përmendi nga parafolësit. Norma e realizimit të tri ministrive që janë aq të domosdoshme sot dhe nevojat për to dhe qytetarët e Kosovës kanë pritur që të jenë më të mëdha këto investime dhe kjo normë e realizimit, e marrim shembull Ministrinë e Mjedisit, është zënë vend këtu për Ministrinë e Mjedisit, unë nuk di në cilin projekt konkret mund të thirret Ministria e Mjedisit pse do të duhej të ekzistonte ajo.

Unë vetëm kisha dashur që sot të realizohet mbledhja e qeseve me bërlllok, që prej datës 5 qershor qëndrojnë rrugëve të Prishtinës, rrugëve të Kosovës. Prandaj, Ministria e Mjedisit nuk është kompetencë e Ministrisë së Mjedisit dhe ne do ta pastrojmë, kjo është kompetencë e organizatave publike komunale që merren me pastrimin e rrugëve dhe të mjedisit. Ministria e Mjedisit nuk ka ndërtuar vizion as kualitet, por nuk ka ndërtuar asnjë projekt serioz që mund të lavdërohem si Kuvend i Kosovës, sot mjedisi është standard.

Shkojmë, Ministria e Drejtësisë, 44% e ka realizuar normën e investimeve kapitale, është imazh i keq. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nën 50%, 49%, prandaj janë indikatorë që nuk lënë vend për vetë lëvdatë. Prandaj, kjo duhet të merret shumë më seriozisht.

Pagat bruto jashtë orarit, kjo do të duhej të sqarohej, 8 milion e 800 mijë, do të thotë ne nuk kemi argumente shtesë pse do të duhej të qëndronte më shumë ose më pak. Ajo çka mund të thuhet, se akuzat të cilat janë drejtuar më herët për mos punë dhe qeverisje jo të mirë, jo transparente, mund të qëndrojnë. Mirëpo, sot kjo qeverisje nuk e ka dëshmuar se dallon prej kontinuitetit të qeverisjes së mëhershme. Ajo çka ka tregua, kjo qeverisje nuk ka vizion për të krijuar një ambient investues, për të rritur nivelin e zhvillimit qoftë ekonomik dhe qoftë të rrisë mirëqenien sociale në vend. Prandaj, do të ishin argumente dhe indikatorë të rëndësishëm që duhet ta ndërgjegjësoni edhe Kuvendin e Kosovës, por edhe të gjitha institucionet dhe Qeverinë, për Qeverinë s'po më flasim shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju e dini se janë prezantuar rreth 1700 projekte për vitin 2008. Tani më pas atij takimi që ka qenë e domosdoshme, sepse është me interes për vendin, kur kanë koïnciduar këto dy takime, ky debat në Parlament dhe ai takim i mekanizmit përcjellës, Kabineti po thuhet se është komplet këtu, po tash jam edhe më i..., natyrisht shumë më i fuqishëm, dhe ndihem tepër mirë me gjithë këta kolegë, zëvendëskryeministrat, ministra që punoj me ta dhe është një ekip i suksesit. Por, para së gjithash, me informacionet shtesë.

Ne do të jemi këtu deri sa ju të shtërnin edhe fjalinë e fundit të debatit, jo vetëm për ju, por para së gjithash edhe për transparencën në raport me qytetarët e Kosovës.

Vitin e kaluar janë prezantuar dhe kanë filluar së realizuari 1700 projekte, i lexova shkollat në ndërtim. E përmendi dikush, nuk janë shpenzua 3 milion të Zyrës së

Kryeministrit, është e vërtetë, i kemi kursye po me ato kursime po ndërtohet ndonjë shkollë, ndonjë çerdhe, ndonjë kanalizim, ndonjë rrugë, janë kursye drekat, darkat, derivatet, telefonatat, e ku ta di unë, do shpenzime të panevojshme. I lexova shkollat që janë ndërtuar dhe do të ndërtohen, tash më lejoni t'i lexoj rrugët.

Ndërtimi i rrugëve të reja, zoti Maloku, ndërtimi i rrugës Kërpimëh – Kaçinoll, ndërtimi i rrugës Skenderaj – Vushtrri, kilometrat të gjitha i keni, nëse dëshironi, mund edhe t'ua lexojmë, por besoj se ministri i Transporti do të më plotësojë në vazhdim. Vazhdojmë me ndërtimin e rrugës Skenderaj – Vushtrri, sanimi i dëmtimit në rrugën M9 Pejë – Kuqishtë, rikonstruimi i rrugës Zajçevc – Tugjec, zoti Kosumi, rehabilitimi i rrugës M9/1 Dovc – Gjakovë, rikonstruimi i rrugës së Dushkajës, pjesa e dytë, ndërtimi i rrugës Gjytet – Mramor, ndërtimi i rrugës tranzitore në Shtime, ndërtimi i rrugës Nerodime – Jezerc, nëse doni të bëni krahasime me përjashtim të deputetëve të LDD-së që nuk kanë qenë as në Parlament disa prej tyre, as në Qeveri, ju të LDD-së dhe AAK-së keni qenë në Qeveri, kështu që nëse doni të bëni krahasime, mundeni. Asfaltimi i rrugës në Klinë të Epërme, i rrugës R121 Qeskonë - Nepole, ndërtimi i rrugës Polac – Prekaz, ndërtimi i rrugës Hasan Prishtina – Obiliq, ndërtimi i rrugës Nikovc – Murë, ndërtimi i rrugës Drenas – Obiliq, ndërtimi i rrugës Dheu i Kuq – Gllaboqicë – Hajkobillë, ndërtimi i rrugës Lipë – Boletin - Zhazhë, ndërtimi i rrugës Komoran – Caralevë, faza e katërt, dhe ekzaminimet kontrolluese të cilat janë bërë.

Vazhdojmë me projektet e bartura nga viti 2007, të papërfunduara. Rikonstruimi i rrugës Hajkobillë – Zajqevc, ... i rrugës së Dushkajës, ndërtimi i rrugës Prizren – kufi me Maqedoninë, ndërtimi i rrugës Pantinë – Frashër, ndërtimi i rrugës Komoran – Caralevë.

Rehabilitimi i rrugëve. Rehabilitimi i rrugës M2 Prishtinë – Kaçanik, faza e parë, rehabilitimi i rrugës M2 Prishtinë - Kaçanik, pjesa Çagllavicë – QMI, rehabilitimi i rrugës M2 Prishtinë – Kaçanik, pjesa e Çagllavicës, zgjerimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë, segmenti Prishtinë – Sllatinë, zgjerimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë, segmenti Prishtinë – Sllatinë, zgjerimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë, segmenti Prishtinë – Sllatinë, Gjylnaze edhe për fshatin tuaj ka këtu. Ndërtimi i urave në rrugën M9 Prishtinë – Pejë.

Vazhdojmë me rehabilitimin e rrugëve. Ndërtimi i urave në rrugën M9 Prishtinë – Pejë, ndërtimi i urave në rrugën M9 Prishtinë – Pejë, ndërtimi i urave në rrugën M9 Prishtinë – Pejë, zgjerimi i rrugës M2 Mitrovicë – Prishtinë, segmenti Prishtinë – Shkabaj, zgjerimi i rrugës M2 Mitrovicë – Prishtinë, segmenti Prishtinë – Shkabaj, rehabilitimi i rrugës Prishtinë – Motivodë, rehabilitimi i rrugës Prishtinë – Gjilan, asfaltimi i rrugës Magurë – Shalë – Kleqkë, asfaltimi i rrugës Drajkovc – Firajë – Brod, asfaltimi i rrugës Tërpez – Kleqkë, rehabilitimi i rrugës R121 Raushiq – Zajm, segmenti Raushiq – Nepole, ndërtimi i rrugës Orllan – Malishevë, rehabilitimi i rrugës R111 Xërxë – Kramovik, faza e dytë.

Vazhdojmë: Rikonstruimi i rrugës Bellobrd – Bresan, rehabilitimi i rrugës Piranë – Mamush, zgjerimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë, segmenti Prishtinë – Fushë Kosovë, zgjerimi i rrugës M9 Prishtinë – Pejë, segmenti Prishtinë – Fushë Kosovë, rehabilitimi i rrugës Suharekë – Rahovec, rehabilitimi i rrugës Prishtinë – Kaçanik, rehabilitimi i rrugës Xërxë – Kramovikë, rehabilitimi i rrugës Restolicë – Brod – Dragash.

Hartimi i projekteve. Hartimi i projektit zbatues për autostradën R6, hartimi i projektit zbatues për udhëkryqin në dalje të Prishtinës, hartimi i projektit zbatues për zgjerimin M9 segmenti Prishtinë – Orllat, hartimi i projektit zbatues për zgjerimin M2 segmenti Prishtinë – Shkabaj.

Vazhdojmë. Hartimi i projektit zbatues për rrugën Dragkovc – Brod - Firajë, hartimi i projekteve për trotuare, hartimi i projekteve për nënkalime.

Mirëmbajtja dhe ndërtimi i urave. Sanimi i urës në rrugën M25, sanimi i urës në rrugën M25/2, sanimi i urës në rrugën M25, sanimi i urës në rrugën R122, sanimi i urës në rrugën M9 ndërtimi i urave, ndërtimi rrethrotullimit, sanimi i urës në rrugën R106, ndërtimi i urës në Banjë të Malishevës, ndërtimi i urës në qytetin e Vushtrrisë, ndërtimi i urës në Korishë, ndërtimi i urës në fshatin Bradosh të Podujevës.

Vazhdojmë me bashkëfinancimet. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Adem Jashari”, ndërtimi i rrugës Dragobil – Shkozë dhe asfaltimi i rrugës Begaj – Gajrak. Ndërtimi i rrugës në fshatin Drenovc, nga shkolla deri te ura, asfaltimi i rrugës lokale Banjë – Senik, ndërtimi i asfaltimit të rrugës K... – Runikë, ndërtimi i rrugës Rezallë e Re – Tushin, asfaltimi i rrugës së Kapresit, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Buçe dhe Plavë, asfaltimi i rrugës Dragash – Radesh, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Drenas – Obri, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Shtuticë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Stankovc, ndërtimi i trotuarit në Polluzhë, ndërtimi i rrugëve në lagjet Isufaj, Berishaj, Rexhaj, ndërtimi i trotuarit te shkolla të mesme të Ebushatit, asfaltimi i rrugës Stanovc i Epërm, asfaltimi i rrugës në fshatin Stanovc i Ultë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Muqivërc – Dajkoc – Qukoroc- Kolloqec, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Karaqevë e Poshtme – Muhoc, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Viti – Beguncë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Pozharan – Tërpezë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hoqë e qytetit Jeshkovë.

Vazhdojmë: ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Poslicë – Bilushë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Caparc, Prizren, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Zhur, asfaltimi i rrugës Poslishtë – Hoqë e qytetit Jeshkovë, asfaltimi i rrugëve në lagjen “Dardani 1 dhe 2”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Sadedin Hajda”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës për Celinë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Rahovec – Zatriq, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Krushë e Madhe, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Ali Kelmendi” ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Përçin – Vllarevë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Pogragjë – Cërnice, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Shtaricë – Siqevë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Volljakë – Dush, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Sfërkë, krejt janë në komunën e Klinës.

Ndërtimi i projektit për ndërtimin dhe asfaltimin në fshatin Dollub – Puls, asfaltimi i rrugës Dollub – Puls, faza e dytë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Jashanicë – Jellovc, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Qabiq, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Shtime – Zborc, tani, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Shtime – Zborc, faza e dytë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Babë – Doganaj, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Duraj – Gabricë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Dushkajë – Stagovë – lagjja Dashi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Ilaz Kodra” shkolla fillore “Shipol”, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Bajpa – Sami Gashi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës ... Fushë Ibër, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Gushac – Dinas – Vinarc i Epërm, faza e parë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Këçiq i Madh, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Shupkovc – Kqiç i Vogël, rikonstruimi i rrugës në fshatin Braboniq, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Vinarc i Poshtëm – Vinarc i Epërm, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Suhodoll – Kroi i Vitakut, asfaltimi i rrugës Suhodoll – Vidimiriq, dhe dua të theksoj se vetëm në Veri të Mitrovicës janë investuar 6 milion euro për një vit në rrugë, kanalizime, asfaltim dhe nevoja tjera për qytetarët atje dhe ndërtim i shtëpive, e shkollave dhe çerdheve.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hani i Elezit - Krivenik, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hani i Elzeit – Seqishtë, ndërtimi i urave Blinicë – Pogragjë – Livoq i Ulët, lagjja Cërniku, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Ponesh – Zhegovc, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në Lagjen Dardania – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Hysen Tërpeza – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Pasjak – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Kodra e Dëshmorëve – Gjilan, këto të përfunduara.

Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Malishevë – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Fadil Jakupi – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Capar – Bukovik – Gjilan, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Qarkovë – Livoq i Epërm – Gjilan, asfaltimi i rrugës “Mustafë Koka”, Gjilan, asfaltimi i rrugës në fshatin Zhegër, në Bresalc dhe në Vërbicë të Kmetovcit – Gjilan, ndërtimi i rrugës “Dardania 2” rruga pesë, rruga “Naser Azemi”, rruga te Tregu – Gjilan, asfaltimi i rrugës Cërnice – Gumnishtë – Gjilan, asfaltimi i rrugës Malësia lagjja e Banjës te Posta “Zija Shemsu”, Gjilan, asfaltimi i rrugës te Muhaxherët, të Livoqit dhe “Ibrahim Temo” – Gjilan, asfaltimi i rrugës Llashticë – Ladovë – Gjilan, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Përlepnice – Velekincë – Kodra e Dëshmorëve – Gjilan, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Uglarë dhe Pogragjë – Gjilan.

Vazhdojmë me Pejën. Asfaltimi i rrugës Krushec – Broliq, faza e parë, Pejë, asfaltimi i rrugës Krushvc – Broliq, faza e dytë, Pejë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Zahaq – Svërk e Thatë – Pejë, asfaltimi i rrugës Novoselë – Lipë – Pejë, asfaltimi i rrugës Dubovë – Novosellë, faza e dytë, Pejë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Branoc – Buçan – Llugagji – Kusuriq – Pejë, asfaltimi i rrugës Ergjon Balaj, brigada 135 -Pejë, asfaltimi i rrugës në fshatin Ozrim – Pejë, rehabilitimi i rrugës në Svrkë të Thatë – Pejë.

Vazhdojmë, Fushë Kosovë. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Halilaq, Suharekë, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Studençan – Dobërdolan, ndërtimi i rrugës Grejkoc – Sallagrazhde – Suharekë, ndërtimi i rrugës në fshatin Llapashticë e Poshtme deri te xhamia, Podujevë, asfaltimi i rrugës Bellopojë - Dyz – Podujevë, ndërtimi i rrugës në fshatin Pakashticë – Podujevë, ndërtimi i rrugës Sveçel – Batllavë – Dumosh – Podujevë, ndërtimi i rrugës Dumnicë – Llaushë – Podujevë, ndërtimi i rrugës në fshatin Sekiraq – Podujevë.

Vazhdojmë me Deçan. Asfaltimi i rrugës Polana – Pobërgj – Deçan, asfaltimi i rrugës Izniq – Ratishtë – Deçan, asfaltimi i rrugës Izniq – Ratishë, asfaltimi i rrugës Izniq – Ratishë, faza e dytë, Deçan.

Shkojmë në Ferizaj. Rikonstruimi i rrugëve të qytetit të Ferizajit “Loto 1” Ferizaj, rikonstruimi i rrugëve në qytetin e Ferizajit “Loto 2”, Ferizaj.

Shkojmë në Lipjan. Asfaltimi i rrugës në lagjen Aliu, Gadime e Ulët, asfaltimi i rrugës Lipjan – Kraishtë – Lipjan, asfaltimi i rrugës në fshatin Gllavicë – Lipjan, asfaltimi i rrugës në fshatin Bregu i Zi – Varigovc – Lipjan, asfaltimi i rrugës Poturovc – Dubrajë e Madhe – Lipjan, asfaltimi i rrugës Janjevë – Teqe – Lipjan.

Po shkojmë në Istog. Asfaltimi i rrugës Lubovë – Prigodë – Lubozhdë – Istog, ndërtimi i rrugës Rakosh – Uçë – Zhakovë, ndërtimi i rrugës Shlivovë – Viti e Marecit – Prishtinë, asfaltimi i rrugëve lokale në Novogrdë “Loto 1” – Novobërdë, asfaltimi i rrugëve lokale në Novobërdë – Novobërdë.

Projektet e bartura nga viti 2007: Malishevë. Asfaltimi i rrugës Banjë – Kërvasari, asfaltimi i rrugës Topanicë – Dumoroc – Kamenicë, asfaltimi i rrugëve – Magurë – Lipjan, asfaltimi i rrugës Lipjan – Konjuh – Lipjan, asfaltimi i rrugës Muzhevinë – Llukovc – Dobrushë – Istog, ndërtimi i rrugës Shushicë – Janjevë – Prishtinë, asfaltimi i rrugës Gjonaj – Mazrek – Prizren, asfaltimi i rrugës Hoqe e qytetit – Oslishtë – Prizren, asfaltimi i rrugës lokale në Graboc të Epërm – Obiliq, asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Përlepnicë.

Këto janë shifra dhe fakte të cilat flasin vetë, të cilat janë duke u zhvilluar, duke u punuar, disa të përfunduara e disa të tjera do të përfundojnë. Për çdo Ministri jam i gatshëm që për çdo projekt të prezantoj, po të shoh Gjylnazen që dëshiron të replikojë, por nëpër këto rrugë për çdo ditë edhe ti shkel.

Nëse dëshironi kilometra, është edhe zoti Limaj këtu, edhe unë jam këtu edhe për projekte të tjera.

KRYESUESI SABRI HAMITI: Faleminderit! Gjylnaze Sylja, replikë.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryesues!

E para, faleminderit për poezinë e mjerueshme, e dyta, nuk kemi ardhur këtu të dëgjojmë ku i keni çuar paratë, po qysh i keni shpenzuar paratë. E treta, Kryeministër, tregom ti veç dy çështje, pse keni paguar 15 euro një abetare dhe ku i ke çuar 270 milionë të letrave me vlerë? Po ta lexoj: Shënim 22.1 Letrat me vlerë për Qeverinë: Gjatë vitit 2008 është investuar në blerjen e letrave me vlerë, në tabelën në vijim, 270 milionë euro. Tregona këtë, jeta reale është shumë më e keqe seç e ke prezantua ti.

KRYESUESI: Kryeministri, përgjigje.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Nëse e vlerëson mjerim, poezi të mjerimit ndërtimin e rrugëve të reja, nxjerrjen e Kosovës nga balta, nëse e vlerëson poezi të mjerimit ndërtimin e shkollave të reja, nëse e vlerëson mjerim informatizimin e shkollave, nëse e vlerëson mjerim rritjen e pagave të arsimtarëve, nëse e vlerëson mjerim fillimin e ndërtimeve të autostradave në Kosovë, atëherë nuk e di çka është për ty e mirë në këtë vend, a e mira në këtë vend është për ty vetëm kur ti je në pushtet dhe nuk punon dhe e mbanë Kosovën peng pa vizion apo këto projekte që nuk janë të miat, këto janë duke u realizuar në terren, në fshatin tuaj, në qytetin tuaj, kudo që sillesh në Kosovë.

Dhe, tjetra, te abetaret. Është e vërtetë, kemi filluar për herë të parë që gjithë fëmijëve nga klasa e parë deri në klasën e pestë t'u jepen librat gratis dhe dallimi sivjet qëndron diku tjetër. Sivjet do të vazhdojmë nga klasa e parë deri në të nëntën, ndoshta edhe ky mjerim për ty, po ky është vizioni im.

(Reagim nga salla)

Shpenzimet e mia janë projektet e mia dhe puna që po bëhet anekënd Kosovës, nëse dëshiron tash me kilometra apo me fakte tjera, urdhëro edhe i krahasojmë të gjitha, po, po. Urdhëroni, secili. Deputetët e AKR-së nuk kanë qenë as në Kuvend e as në Qeveri, po ju që keni qenë në Qeveri, urdhëroni secili nga ju për çdo ministri, për çdo projekt, për çdo iniciativë, për çdo shpenzim, le të dilni, krahasoni edhe me çdo deputetë të krahasohen të arriturat, të hyrat, shpenzimet, investimet, në çdo qytet, në çdo fshat.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Faleminderit, zoti Kryeministër, na ke dhanë disa informata edhe më shumë se që kemi menduar, në fakt, kam menduar.

Të nderuar të pranishëm, unë mendova tjetër send të flas, po disi Kryeministri më sfidoi dhe pak më shumë do të merrem me atë që u deklarua këtu. Duke u nisur nga sukseset e Qeverisë, po shoh këtu se krahasimet, edhe ashtu siç tha Kryeministri, të hyrat janë 13% më mirë se sa më 2007, nëse doni i cek edhe shifrat, por pas sqarimit të bollshëm të Kryeministrit, po ju kursej. Kemi përmirësime për 10% në të hyrat në dogana, në administratën tatimore, po ashtu, në komuna kemi ndryshim pak më të madh 46%, 12.3% e tjera, e tjera. Por, nëse e krahasojmë vitin 2007 dhe vitin 2006, do të thotë se aty ka pasur përqindje të rritjes së efikasitetit më të madh, flas për krahasimin 2007 - 2006. Çka tregon kjo? Kjo tregon se administrata shtetërore është përmirësuar, është ajo e ashtuquajtura “kurba e eksperiencës”, që do me thënë, sa më gjatë ta bësh një punë, e bën më mirë, “Learnign Curve”. apo japonezët i thonë “Kaizan”, do me thanë, sa më gjatë e bën një punë, e përsos dhe e bën nesër edhe më mirë, edhe më mirë. Duke pasur parasysh edhe atë “punën e mirë që e ka bërë UNMIK-u prej të 99-tës me work shope”, unë po them në thonjëza, se ju të gjithë keni pranuar se ka bërë punë të mirë UNMIK-u për këto 9 vite. Me gjithë ato miliarda, gjithë ata njerëz të mençur që janë ardhur këtu të na ushtrojnë neve, të na mësojnë se si punohet. Do me thënë, edhe është e natyrshme që të jetë efikasiteti i administratës shtetërore. Por, ajo që nuk po më përputhet me këtë filozofi, është rritja e pagave. Në vitin 2008 krahasuar me 2007 kemi 10%, dhe nëse shkojmë te faqja e fundit, do të shohim se të gjitha institucionet apo ministritë ekzistuese, s’po flas për ato që janë krijuar tash rishtazi dhe sigurisht është dashur të marrin të punësuar më shumë, por ato të krijuarat gjithkund kemi rritje të punëtorëve. Do me thënë Kryeministria, po flas me shifrat aktuale, është më së shumti, kështu, kampione në realitet është Ministria e Bujqësisë, po tani vjen Kryeministria, por me gjithë atë po them, çdo ministri ka rritje të punëtorëve, përpos Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, siç po shihet rritja nuk është aq e madhe.

Çka tregon kjo? Nëse e marrim tash teknikisht e analizojmë efikasitetin e shtetit, do me thënë atë fjalën që partia kryesore në pushtet në koalicion na ka lodhur deri tash me suksese, me efikasitet, do me thënë me atë se sa mirë i ka përdorur resurset njerëzore, krahasuar me mundësitë financiare, do të shohim se ka përkeqësim, do me thanë, me punëtorët, me kapitalin njerëzor të cilin e ka sot, krahasuar me të hyrat del se raporti është 27% sivjet, vjet ka qenë 25%, do me thënë 2% më e suksesshme ka qenë Qeveria. Zoti Kryeministër, më falni, shifrat e juaja jam kah..., veç i kam zbërthyer, teknikisht i kam zbërthyer, kështu ne na tregojnë. Jo, bre burrë, që po i këqyri, i hymë i llogarisim, po të juaja o burrë janë. Sa kemi dogana, sa kemi buxhet, dhe sa ke punëtorë. Më falë, atëherë, se ti si historian i di më mirë se unë që po i ditkam, për këto jam shkolluar. Sidoqoftë, ta kryej, shifrat e juaja. Jo, jo s’kam, jo zoti Kryeministër, unë bash kurrfarë, kurrfarë vullneti politik nuk kam, sinqerisht. Do të kthehem, veç më lejo ta përfundoj, do të kthehem, unë dëgjova dhe po vazhdojmë.

Të vazhdojë, ani de, më vonë, veç unë e kam kohën tash, sidoqoftë po vazhdoj. Ajo që është inkurajuese, është se Ministria e Transportit është me të vërtetë shumë më e suksesshme se ajo e kaluara, është e vërtetë ajo që Ministria e Arsimit ka ndërtuar shkollat shumë të nevojshme dhe ato janë fakte që mendoj që nuk bën t’i anashkalojmë apo t’i kundërshtojmë, se janë fakte. Dhe, për çudi, përsëri po e citoj Kryeministrin, na tha se në Zhegër i kanë bërë dy shkolla, se dy herë dy shkolla aty dhe është për t’i

uruar. Nuk e di, e di që Zhegra është katund i vogël për dy shkolla të reja të ndërtohen, por po ju uroj.

Tjetër, çka desha të them, është edhe një gjë që më interesoi, zoti Kryeministër, askund nuk po mund ta marrim këtë informatë, të paktën unë. Ju thatë 1700 projekte, do me thënë është punuar gjithkund edhe është punuar, i përmende edhe projektet. Mua po më intereson se OSHP-ja ka pas sjellë këtu një farë raporti, unë s'kam marrë vesh kurrigjë hiq, OSHP-ja për qytetarin është Organi Shqyrtues i Prokurimit, a ka pasur ankesa aty në procedurat e tenderit, a janë shkelur procedurat e tenderit? Nga fakti po e bëj këtë pyetje, se gjithmonë duke pas parasysh përkushtimet e kësaj qeverie për transparencë, për zero tolerancë kundër korrupsionit. Unë i kam dëgjuar disa, por po i marr kështu si më të popullarizuarat që kanë qenë, si është rasti i 3.5 milionëshit, që ishte ai farë tenderi i diskutueshëm i PTK-së që iu dha për marketing Top-Chanelit e Dardafonit, e tjera, e tjera, tash edhe mos të hi në secilën, por nuk kemi zyrtarisht shpjegime se ku është dyshuar se janë shkelur procedurat e tenderit. Po them, se nëse nuk ka pasur shkelje të procedurave të tenderit, unë me të vërtetë për këtë punë shumë të madhe ju përgëzoj, dy herë më shumë se sa që u fol këtu.

Tashti, ajo që do t'i krahasoj edhe këto shpenzimet, zoti Kryeministër, janë konkrete, gjithmonë po flas dhe po i përdori shifrat e juaja. Këtu shkruhet mallra dhe shërbime dhe po iu fute dhe i krahasove, sheh se nuk janë rrjedhojë e logjikës krahasuar me premtimet që janë dhënë. Shikoni, ai grupi i famshëm negociator, që ishte ai grupi i turistëve në vitin 2007, pati harxhuar me shpenzime të udhëtimit 4 milionë e 124.000 euro. Më falni, 4.417 milionë euro dhe, siç e dimë, dilnin atje në Austri, më shumë rrinin se në Kosovë. Por, kjo qeveri unë nuk di ku është duke udhëtuar, shumë pak i paska ulë shpenzimet krahasuar me atë ekipin e famshëm të Lutës, që vinte na kallëzonte 8 me 2 e 8 me zero. Uljet në shpenzime të udhëtimit i keni 6.6%. Po them, nuk po shoh aq shumë që po udhëtoni, po s'po di kah po shkojnë këto, të paktën kamerat s'po na japin.

Pastaj, keni premtuar se do t'i ulni makinat. Këtu për investime në makina, lëndë djegëse, kemi rritje të shpenzimeve, keni blerë diku 1 milion e sa ishte – 800.000 euro më shumë makina sivjet, s'di për kë, kështu po shkruan – shpenzimet në makinat.

Pastaj, ishin këto shpenzimet tjera. Kategoria e shpenzimeve tjera që ka një rritje enorme, keni qitur gjithçka këtu, domethënë... Jo, këto janë karburantet, më falni. Tash do të shkojmë te këto shpenzimet tjera, që ishin të pakuptueshme, aty kishin qitur dreka, darka, municion, armë, domethënë është përzier aq keq puna e shpenzimeve të tjera, që nuk mund t'i dallos se ku janë shpenzuar ato shpenzimet, rritjet enorme me shpenzime tjera. Domethënë, janë furnizime me ushqim dhe pije, furnizim për zyra, pastaj akomodim, furnizim pastrimi, furnizim me municion, me armë zjarri e tjera e tjera. Këto kategori janë diametralisht të kundërta dhe është dashur të na i ndani për t'i kuptuar më mirë.

U prekën disa herë, këtu puna e investimeve në letra me vlerë, s'po dua t'ju maltretoj edhe më shumë, me të vërtetë këtu s'ka kurrfarë informate. Mbase janë nisur nga perceptimi se janë këto gjëra ...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Një sqarim shtesë e ka Kryeministri dhe pastaj pauzë deri në ora 15:00.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet,
Vlerësimet tuaja janë në bazë të performancës politike dhe vullnetit të interpretimit të juaj si deputet, por jo interpretim profesional, sepse shifrat dhe faktet tjera flasin krejt ndryshe.

Projektet janë projekte dhe janë vizion imi politik. Po të dëgjojmë ndoshta ndonjë diskutim të veçuar, ne nuk do të fillojmë të ndërtojmë as shkolla, as rrugë, as kanalizime, as ujësjellës, as nuk duhet ndërtuar shtretërit e lumenjve, as nuk duhet investuar në ambient, duhet të vazhdojmë që të jemi vendi më i ndotur në botë apo në Evropë, duhet të vazhdojmë që të mos punojmë për komunitetin e biznesit, mos të thellojmë partneritetin me ta.

Unë dua të potencoj se, e përmendët edhe te ulja e taksave, përmendi dikush tjetër edhe çështje tjera. Ulja e taksave ka ndodhur 50%. Të lutem! Po të informoj, që të mos e keqinterpretosh. Ulja e taksave ka ndodhur 50%, taksa mbi profitin nga 20 është ulur në 10. Taksa në të hyra individuale nga 20 në 10, nga 10 në 8 dhe nga 5 në 4.

Ka ndodhur lirimi nga TVSH i librave, i shërbimeve mjekësore. Dua të theksoj edhe tjetrën se gjitha këto investime, të lutem, të gjitha këto investime kanë ndodhur si rezultat i qeverisjes demokratike, i qeverisjes së mirë, efikase, dinamike por, para se gjithash, i sundimit të ligjit.

Unë nuk dua të flas me paragjykime apo me ndonjë perceptcion. Ju folët për Ekipin e Unitetit. Ministri Shatri ka qenë dhe e di shumë mirë punën e Ekipit të Unitetit, ka qenë ministër i ekonomisë dhe financave. Dua të potencoj dhe e di gjithë procesin, kështu që nuk duhet kontestuar ajo punë që është bërë, ka qenë puna e statusit politik dhe askush, të gjithë kanë qenë të përgjegjshëm në atë drejtim. Por, dua të potencoj, të nderuar deputetë, të gjithëve. Tash ndihem tepër mirë që punoj me gjithë këta njerëz, ministre e ministra dhe ndihem tepër mirë që ky debat i kontribuon zhvillimit të demokracisë.

Shpesh po flitet që Qeveria kontrollo Parlamentin. E, ngadalë, ngadalë!

(Reagime)

Demokracia, të lutem! Ndal! Demokracia ka rregulla. Ai që e ka shumicën dhe shumicën e ka koalicioni PDK – LDK – minoritarët serbë – minoritarët joserbë, shumica e përkrah Qeverinë, e mbështet Qeverinë, i jep ide, i jep vullnet, e kritiko kur është e arsyeshme, e mirëpresim dhe këtë shumicë unë nuk e kam përcaktuar, e ka përcaktuar populli i Kosovës, secilit ia ka dhënë vendin e vet.

(Ndërhyrje)

Sa iu përket gjërave që mund të fliten, i nderuari deputet që e përmende, edhe të tjerët. E përmenda, sundimi i ligjit ka qenë jetik për suksesin tonë, sundimi i ligjit ka qenë jetik për të pasur ne sot agjendën e qartë evropiane, sundimi i ligjit ka qenë jetik për t'u anëtarësuar Kosova në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe së shpejti në IBRD, sundimi i ligjit dhe sukcesi ynë në Kosovë ka qenë jetik për njohjen nga 60 shtete të botes, sundimi i ligjit ka qenë jetik për të gjitha këto projekte, sundimi i ligjit ka qenë jetik që Kosova sot të jetë vendi i fundit në rajon për korrupsion dhe krim të organizuar dhe e para në ranglistën e luftimit të dukurive negative. Ju lutem, mos flisni me perceptcion, por ma

tregoni vetëm një rast, një shembull të involvimit të një zyrtari në korrupsion dhe krim të organizuar.

(Reagime)

Ju lutem! Ju lutem! Ne do të vazhdojmë të jemi të pakompromis me moton tonë - zero tolerancë korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ne e dimë se kemi bërë punë të mbara, por edhe e dimë se duhet të bëjmë edhe më shumë sepse mundësitë janë, vullneti është dhe ka projekte, ka buxhet. Të njëjtin buxhet e keni pasur, por ne do të kursejmë dhe do të investojmë në projekte për të mirën e qytetarëve. Kemi bërë aq sa kemi bërë, nuk mburremi, por do të vazhdojmë të bëjmë punë edhe më të mira. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Në orën 15:00 vazhdon seanca.

Vazhdimi i seancës në orën 15:00

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Të nderuar deputetë, për debat kemi numër të mjaftueshëm dhe debatin e pasditës po e hapim me deputetin Mark Krasniqi.

MARK KRASNIQI: Faleminderit, Kryetar! Përsëritës të gjithë deputetët prezentë që janë, ministrin...,

Këtu dëgjuam sot kritika dhe lavdërime. Gjithmonë kur është puna për t'i marrë të hollat, paratë, aty ka probleme. Secili ka më tepër nevojë, por më tepër apetit, edhe pa nevojë, kështu që është gjë normale që kemi bë pak zhurmë, por shpresoj se do të merremi vesh më në fund.

Ne dëgjuam këtu se janë bë disa, jo disa po shumë suksese në ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e shkollave, të spitaleve e nejtë më, kjo ana materiale e nevojshme për popullsinë. Mirëpo, është puna se ne nuk mund të lavdërohemi shumë për sukseset tona, pa marrë parasysh kush është në Qeveri, deri sa e kemi strukturën e popullsisë sociale në këtë gjendje në të cilën është. Rreth 50% e popullsisë është pa punë, rreth 13% e popullsisë është në varfërinë e skajshme, pensionistët i kanë pensionet e tyre dy lekë, dy euro në ditë, kurse mjeku i kualifikuar, i specializuar i ka vetëm 8 euro në ditë. Populli, njeriu skamnor para se gjithash këqyret çka ka në sofër e jo çka ka në rrugë. Një proverb kroat thotë: “Dashuria kalon nëpër zorrë, nëpër stomak”. Kur je i uritur, nuk të bie ndërmend për shumë gjëra tjera, po vetëm për bukë. Këtu është problemi i menaxhimit të brendshëm të këtij buxheti të varfër të Kosovës. Ky është aq i varfër, sa që them se komuna më e vogël në Gjermani mund ta ketë një buxhet më të madh se e kemi ne. Por, ne nuk jemi fajtorë dhe nuk kemi çka bëjmë. Me këtë që e kemi, me këtë duhet të kënaqemi dhe të këqyrim qysh ta shfrytëzojmë më mirë.

Këtu desha ta përmendi një punë, një problem prioritar, më duket mua, me rëndësi shumë të madhe për Kosovën, madje edhe për rajonin. Është çështja e autostradës Durrës-Prishtinë. Kjo autostradë, të them drejt këtu, në Shqipëri është sabotuar nga opozita parlamentare shqiptare, sepse kanë kërkuar rruga të shkojë jo për Prishtinë, po për Athinë. Për fat të mirë, kjo tendencë e tyre mbeti vetëm si e tillë, ëndërr e keqe.

Rruga Durrës – Prishtinë iu afrua kufirit të Kosovës. Ne nuk e kemi bërë asnjë hap në këtë rrugë. Vjet, siç e kemi marrë këtu raportin, në buxhetin e vjetit ka qenë përcaktuar,

kanë qenë ndarë 50 milionë për këtë rrugë. Ndërkohë, iu ka ra ndër mend, Qeverisë ose s'di kujt, që ato para mund t'i çojmë të ndërtojmë rrugë e rrugica, nëpër katunde, nëpër komuna, sepse ajo është më e leverdishme, sidomos për ditën e votimit. Më duket se edhe për këto tri vjet të ardhshme buxhetore deri më 2012, nuk është paraparë asnjë hap për ndërtimin e kësaj rruge. Janë paraparë të hollat vetëm për shpronësim. Shpronësimi është tjetër gjë, krejt tjetër gjë. Kur të fillojë rruga, dihet se si fillon dhe shtëpia fillon prej të themeleve. Prandaj, po them se këtu duhet çelur sytë dhe të mos na qesin edhe ne në pozita që nuk e meritojmë dhe që nuk e dëshirojmë, që në Shqipëri të na thonë – jo, edhe ju jeni krah i kësaj intence të brendshme atje. Nejse, është punë për ta, atje nuk përzihemi, po ne t'i këqyrim punët tona dhe kjo rrugë duhet të jetë problemi prioritar, prioritar duhet të jetë se kjo rrugë është me interes ekonomik për Kosovën dhe për rajonin, është me interes kulturor, është me interes para se gjithash kombëtar, sepse më në fund edhe pengesat natyrore që na kanë ndarë ne, edhe ato u zhdukën, u shpua tuneli 5-6 kilometra i gjatë në Kalimash. Prandaj, propozoj që në buxhet ta keni parasysh dhe mos ta lëni këtë kur ta falë zoti motin më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca. Jo, jo, të thërres unë kur ta kesh rendin. Ta di emrin. Ibrahim Makolli e ka fjalën. Jo, jo, ju lutem Gani, fjala është e Ibrahim Makollit. Ulu në vend, pas Ibrahim Makollit prapë e merr, por jo tash.

IBRAHIM MAKOLLI: Zoti, Kryetar i Parlamentit!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar ministra,

Kjo pjesa e pasdites, si duket, është më pak interesante për Kabinetin qeveritar, edhe pse i kishim këtu më herët. Seriozisht bënë mirë që na e lexuan raportin dy-tri herë radhazi, sepse disa prej nesh, për shkak të këtyre shkronjave, kishim problem t'i kuptojmë detajisht.

Do të përqendrohem në dy çështje të këtij raporti. Thuhet një fjalë te ne që nuk është nganjëherë vështirë të krijosh, por është vështirë të dish t'i harxhosh ato mjete dhe këtu, si duket, ka pasur vështirësi të harxhohen këto mjete të cilat i ka pasur buxheti i Kosovës. U tha, po ashtu, se ka pasur rritje të të hyrave, duke harruar se këto të hyra, nëse janë rritur, janë të hyra të cilat i kanë krijuar qytetarët e Kosovës dhe jo zyrtarët e Qeverisë, sikur po pretendohet të paraqiten.

Investimet kapitale, do të përqendrohem te investimet kapitale. Unë jam në gjendje të dëgjoj edhe pjesë të pozitës, të cilët përpiqen të na zhvendosin vëmendjen, por jo, s'keni për të arritur, kështu që s'është problem, vazhdojeni si e keni filluar tash e shumë kohë me këtë popull, nuk është problem.

Investimet kapitale, do të përqendrohem, sepse investimet kapitale kanë për qëllim ngritjen e kualitetit të jetës për një popull, për një vend dhe në bazë të kësaj që ne e shohim, nuk ka diçka të tillë edhe pse të gjithë ne, besoj, edhe pozita edhe opozita dhe të gjithë qytetarët e një vendi iu gëzohen përparimeve dhe ne nuk mund të themi se nuk ka pasur përparime, absolutisht nuk mund të thuhet që s'ka pasur përparime, por shtrohet pyetja a kanë qenë në nivel dhe sa kanë kontribuar që të rritet, të ngrihet mirëqenia qytetare.

Nga ky raport që e kemi parë, po i bie që kryesisht janë shpenzuar 100% mjetet aty ku ka pasur mallra dhe shërbime, vetura dhe po më vjen keq ta them, shumë keq po më vjen ta

them para qytetarëve, por Kosova është i vetmi vend në institucionet e të cilave gjejmë kanape, askund tjetër në botë nuk ka dhe te ne buxheti është shpenzuar për të blerë shtretër për zyre.

Po e përmendi edhe një detal, ju lutem! Ju lutem, sepse duhet për të qenë shumë... seriozisht ju kam zili nganjëherë. E shoh një çantë, shikojeni, ju lutem, merreni me mend, një çantë thotë 160 euro, një çantë e lap-topit. Pash zotin, a më kallëzon dikush çfarë çante është kjo Armani, Boss, 160 euro një çantë e lap-topit. Aman, 160 euro!

Po shkoj më tutje. Kolegë po shkoj më tutje, do të shkoj më tutje, te disa resorë të cilët janë shumë të rëndësishëm për zhvillimin e jetës në këtë vend dhe shiheni: Ministria e Financave – investime kapitale -34%, të tjerat i ka gati 100% të shpenzuara. Ministria e Shërbimeve -84%, Ministria e Tregtisë, Industrisë -71%, e të gjithë ne e dimë se çfarë e kemi gjendjen. Për investime kapitale po flas. Ministria e Shëndetësisë -76% dhe unë jam shumë i bindur që po të kishte edhe 3 herë shumë të tillë, Ministria edhe po ta shpenzonte, nuk do të mund t'i realizonte kërkesat dhe interesat për investime kapitale në këtë vend. Më tutje, Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit -82% investime kapitale. Ne të gjithë e dimë si është gjendja në kulturë, në rini dhe në sport. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale -49%, merreni me mend. 27% Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. E dini që para disa ditësh një statistikë e thotë që ndotja e ambientit në Prishtinë është 18 herë më e madhe se sa e lejueshmja. Nuk ka pasur vend që të veprohet në këtë drejtim? 28% Ministria tjetër, 44% Ministria e Drejtësisë. Të gjithë ne e dimë në çfarë gjendje është drejtësia në këtë vend.

Po kthehem pak te shpenzimet e komunave dhe do t'i përqendrohem vetëm në komunën e Prishtinës. U tha këtu, ndërtimi i shkollave, sepse nganjëherë po i ngatërrojmë edhe rrugët edhe shkollat. Rrugët te na dhe shkollat i kanë nga 3-4 emra. Qe disa vjet ka filluar ndërtimi i shkollës Xhevdet Doda, investimin e kemi zero. Dhe, nxënësit vazhdojnë nga 3-4 ndërrime, sepse nuk kanë ku mësojnë.

Ndërtimi i objektit të komunës, pjesa e mbetur, zero. Edhe unë po lexoj sikur që tjerët kanë lexuar.

Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen Vreshtat, zero, as që ka filluar, sepse duhet të pritet fushata zgjedhore për të pre shirita dhe për t'u shty zyrtarët se cili po e pret shiritin më mirë.

Pajisje radio-laboratorike internistike, zero investimet.

Shkolla fillore “Xhemajl Mustafa”, salla – ndërtimi i sallës, zero.

Ndërtimi i sallës së kulturës fizike “Faik Konica”, zero.

Rregullimi i kanalizimit në Hajvali, është zero, as që ka filluar. E dini se çfarë gjendje është në atë fshat për shkak të mosveprimit të institucioneve.

Kalabri, infrastruktura zero, as që është filluar dhe unë do t'i lutja ata që flasin për investime dhe për ndryshim të kualitetit të jetës së qytetarit që ta vizitojnë atë lagje, që të shkojnë edhe në atë lagje nganjëherë dhe të shohin se cila është gjendja.

S'po dua t'u marr ndoshta më tepër qytetarëve kohë për t'i lexua këto, por po ju lus, kolegë, unë e thashë në fillim që ato të cilat kanë ndodhur dhe cilat janë kryer, absolutisht nuk jemi ata që i mohojmë të arriturat, por këto të arritura nuk janë kështu siç janë paraparë me buxhet. Dikush nuk ka ditur dhe s'po di t'i shpenzojë si duhet mjetet ose investon aty ku... Zoti Kryetar, po ju kërkoj si Kryetar i Kuvendit, ose të ketë disiplinë në këtë Kuvend dhe të na lejohet të flasim, ose ne nuk e ndiejmë nevojën që të flasim, sepse ne i kemi dëgjuar të tjerët dhe do të donim që të na dëgjojnë edhe ne. Atëherë, zoti Kryetar, unë në shenjë të proteste për këtë gjendje në Kuvend, unë nuk do ta vazhdoj më tutje. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka Gani Koci, le të përgatitet Vezira Emrush.

GANI KOCI: Bëni zhurmë sa të doni, unë jam para mikrofonit këtu. Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë do të përpiqem ta parafrazoj Jezu Krishtin kur thotë, duke e gozhduar, - i fal, se nuk po dinë çka janë kah bëjnë!

Unë po kërkoj nga qytetarët e Kosovës që vërtet ta falin opozitën se s'po di çka është kah bën. Vërtet, kur dëgjon, kur dëgjon diskutimet këtu, mund të jesh përkrahës i disa diskutimeve dhe mund të jesh kundërshtar i diskutimeve tjera. Unë po habitem, jo nga ata që janë ndoshta për herë të parë dhe ndoshta për herë të parë shqyrtojnë një raport financiar, por po habitem nga ata që kanë nga dy ose tri mandate në këtë Kuvend dhe, për shembull, ka shumë këtu që nuk janë në gjendje, që miku im Bajram Kosumi, atje që s'ka folur hala, që nuk po dinë se ne jemi kah shqyrtojmë Raportin financiar për vitin 2008 dhe nuk jemi duke shqyrtuar strategji të zhvillimit ekonomik të Kosovës. Na ka mbetur përgjysmë diskutimi për Kornizën afatmesme të shpenzimeve, që shumë diskutime tuaja do t'i shkonin për shtati pikërisht asaj pike dhe jo pikës që ne po e diskutojmë.

Kur flasim për shpenzime buxhetore, ne kemi do masa, do përmasa që mund t'i përdorim dhe të bëjmë krahasime dhe të vijmë te një përfundim se cila është ecuria financiare në këtë vit ose në atë vit.

Ne këtu nuk po flasim për sukseset ose për performancën menaxheriale të Qeverisë. Po flasim për shpenzimet buxhetore dhe kur flasim për shpenzimet buxhetore, duhet pasur parasysh këto elemente:

Nën një, cilat kanë qenë projeksionet financiare dhe buxhetore të kësaj qeverie, që i kemi miratuar me ligj, këtu ne si deputetë, dhe sa është shkalla e realizimit të atyre projekteve. Nëse dimë t'i lexojmë mirë raportet, të gjitha të dhënat dhe të gjitha shënimet i gjejmë këtu. Në këto letra gjejmë edhe sukseset, natyrisht gjejmë edhe mossuksese në segmente të caktuara. Në qoftë se kjo qeveri ka projektuar se do të ketë kaq të hyra dhe ato të hyra janë realizuar mbi planin edhe me vetëm 0.01%, kjo është një performancë e mirë sepse ka tejkaluar planin. Dhe, ato që i tha ministri, nëse kemi mund t'i mbajmë mend, nëse s'kemi mundur, i kemi përpara, edhe në të hyrat nga të gjitha linjat e të hyrave ka një performancë pozitive dhe ka një rezultat shumë pozitiv. Shumë pozitiv kur them, për mua është nga 1 deri 46% që kemi të të hyrat vetanake të pushtetit lokal.

Në anën tjetër, kur flasim për shpenzimet, ne kemi në total një realizim të këtij buxheti diku 83 ose 84% dhe ne nëse duam të flasim, të themi pse nuk është shpenzuar edhe ai 12 ose edhe ai 16 ose ai 18%, ku janë pengesat, cilat janë pengesat dhe të kërkojmë

përgjegjësi pse nuk ka shkuar 100%. Nuk jemi, siç e tha dikush përpara këtu, në kohën e Enver Hoxhës, shpenzimet 120%, të hyrat 140%. Këto i kemi shifra këtu. Prandaj, të ndalemi dhe të flasim. Ndalemi të flasim për realizimet. Ka krahasime që janë, ka shumë krahasime, krahasimet bëhen me vlerë, vlerë monetare, bëhen me numra, kaq shkolla, kaq spitale, kaq rrugë dhe bëhen me metra, bëhen me metër katror, si njësi matëse, e tjera, e tjera, në gjatësi e pastaj ka idenë ky Dritoni më mirë, këto njësitë matëse ndërkombëtare që përdoren dhe krahasime kur të bëjmë me vlera monetare, të shkojmë me vlerën monetare, kur shkojmë me metra, krahasimet t'i bëjmë me metra dhe mos t'i ngatërrojmë metrin me metër katror e kilometrin atje me kilogram, se nuk shkojnë këto. Këtu kemi pasur ngatërime të tilla dhe vazhdon akoma të kemi ngatërime të tilla.

Unë dua t'ju përmend se u tha shumë të shpenzimet, të kursimet që i ka bërë Qeveria. Unë dua të them që i kam do shënime, që besoj i keni edhe ju, ose do të duhej t'i kishit dhe do të duhej t'i kishit që shpenzimet e kësaj qeverie, kursimet e kësaj qeverie për periudhën 1 janar 2008 – 31 dhjetor 2009 për nivelin qendror, 2008 thashë, janë kështu, sipas kësaj renditjeje. Për dreka dhe darka zyrtare, po thotë një lloj reprezentacioni, ka minus 21% në krahasim me Qeverinë e zotit Shatri atje, kur ka qenë si ministër i financave. Në furnizimin me ushqim, ke minus 2%, do të thotë për mua është pozitive kjo, këtu është kursimi. Në shpenzimet në karburante, edhe pse ju e dini, edhe pse ju e dini se karburanti matet edhe me para, matet edhe me litër dhe po të shndërrohet në litër kursimi na del shumë i madh, sepse vlera, çmimi ka qenë shumë i madh në periudhën e caktuar. Po edhe pse ka qenë një çmim i madh, kursimet janë minus 6, do të thotë 6% më pak kanë harxhuar, niveli qendror i Qeverisë dhe për mua këto janë sukseset me të cilat duhet... Urdhëro! Më e lirë! Unë e di për 2008, kur kemi filluar ka qenë shumë i shtrenjtë, por nuk po lexojmë ne sot as raport të sodit, as... e kemi të tremujorëshit tash 2009, po e kemi 2008. Na po flasim për 2008. E kemi të shpenzimet për udhëtime, minus 25% në krahasim me qeverinë e kaluar. Për mua është kjo performancë. E kemi minus 32% shpenzime të telefonit. Dikush thotë ka zbritur impulsi atje, çmimi i impulsit. Kjo është e vërtetë, por megjithatë është minus 32% dhe këto janë, këto për mua janë suksese, janë rezultate.

Në anën tjetër, nëse duam të shtrojmë ku janë ato të metat e Qeverisë, u përmend këtu nga shumë diskutues. Po e marrë veç linjën - shpenzimet kapitale. Kemi disa agjencione buxhetore që shpenzimet në këtë sferë, në këtë linjë i kanë nën 50% dhe këtu do të duhej kërkuar jo përgjegjësi nga Kryeministri, por një shtrëngim të veprimit të Kryeministrit dhe të kryeministri t'i hetojë se në cilët sektorë, pse ka ndodhur ky shpenzim nën nivelin e asaj, sepse kemi pasur shumë raste këtu, kemi dëgjuar edhe diskutime edhe nëpër gazeta se i kanë ndarë ministri i këtij ose ministri i atij, i kësaj partie politike ose e asaj partie politike.

Për mua është ministër i Qeverisë dhe duhet të kërkohet llogari pse nuk ka bërë 84% ose 71%. Në anën tjetër, kur po kemi të projeksionet buxhetore, atëherë pikërisht nga këto ministri kërkohet buxhet më i madh dhe gjithmonë pengesat për realizim të nevojave, thuhet nga buxheti, në mungesë të buxhetit. E kemi Këshillin Gjyqësor, në këtë rast, se ka diku sipas asaj, ka vetëm 23% të realizuara investimet kapitale. Duhet kërkuar llogarinë në këtë çështje. E kemi Departamentin e Drejtësisë 32%. Mua si kryetar i Komisionit për Buxhet m'i nxjerrin veshtë dhe sytë se po thonë- kemi pak buxhet. Këtë pak buxhet, me sa marr vesh unë, të gjithë e kanë zakonisht e mendojnë atë linjën e pagave dhe të mëditje, këto tjerat nuk i shikojnë, prandaj duhet të shikohen këto të tjerat.

Pastaj, e kemi Ministrinë e Mbrojtjes, që është themeluar shumë vonë, e dini ka pas kërkuar një buxhet prej diku 700 mijë euro dhe ka realizuar vetëm 40%, që do të duhej të shkohet pse është 40% të shpenzimet kapitale, gjithnjë të shpenzimet kapitale.

Pastaj, Ministria e Drejtësisë, po ashtu ka nën 50%, ka 44% dhe në këtë drejtim sugjeroj që, vërtet, Kryeministri i Republikës së Kosovës, përkundër faktit se në total ka në shpenzimet buxhetore në realizimin e planifikimit, ka një performancë shumë pozitive dhe shkon mbi 80%. Në këtë drejtim duhet të marrë masa që në këta sektorë, në këto dikastere qeveritare, po them, të përmirësojë kapacitetet menaxhuese të tyre, në mënyrë që në fund të arrihet performanca edhe e këtyre dikastereve në 80, 90 dhe 100%. Prandaj, ju lutem, t'i shikojmë shifrat, të flasim me shifra, të flasim...

KRYETARI: Ju faleminderit, Gani Koci! Krahasimet kur i bën... Gani! Me ty po flas, krahasimet kur i bën me sistemin e kaluar, bëni me sistemin e Titos, jo të Enver Hoxhës.

(Qeshje, duartrokitje)

Kësaj salle i shkon më mirë ashtu. Replikë, Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, Kryetar!

Ju faleminderit, ministër Koci që më përmende,

Me të vërtetë unë po besoj dhe po i shikoj shifrat, por më ka hyrë dyshimi që deputetët e opozitës nuk e kanë të njëjtin raport sikurse të pozitës. Janë dy raporte. Për shembull, faqe 7, unë po lexoj numra, faqe 7 shkruan: “të hyrat totale për vitin 2007 janë 1 miliardë e 170 milionë. Të hyrat totale për vitin 2008 janë 1 miliardë e 33 milionë”, janë 100 milionë më pak. Këto janë shifrat në faqen 7, shikoni, ministër Koci, shikoje dhe me të vërtetë, shikoni, unë po ju besoj, Gani, edhe juve, edhe Kryeministrit po ju besoj, por populli nuk besoj që po ju beson.

KRYETARI: Këto shifrat po më duket i ke ngatërruar. Urdhëro, Vezira Emrush e ka fjalën!

VEZIRA EMRUŠ: Hvala, ljepa na datu reč!

Ja samo izašla ovde pred vama, kolege poslanici, da bi se bolje videli i čuli.

Pozdravljam Predsedništvo,

Danas imamo na redu razmatranje Izveštaja, finansijskog izveštaja Konsolidovanog budžeta Kosova. U ovom izveštaju znamo da je po obavezi, na ime Zakona 03L/93, i današnji izveštaj ja sam pažljivo razmatrala. Bilo je mnogo diskutantata i smatrala sam da nešto moramo da kažemo pametno, što ne smatram da je svako od kolega dao svoj doprinos.

Prvo, moramo da znamo da govorimo, da kažem ekonomskim ili knjigovodstvenim jezikom, kada radimo neku oblast, da znamo terminologiju te oblasti. Nismo stručnjaci za sve terminologije, ali da se potrudimo, da pročitamo, da analiziramo, da udjemo u izveštaju i da budemo malo uspešniji i radniji.

Mi iz izveštaja svi vidimo, ja ću da budem mnogo kratka, da ne bi ponavljala ponovo iste stvari, vidimo da je ukupan prihod bio 862. miliona, da je ukupan rashod 1 milijardu i 90 miliona, što znači da je, to moramo danas da kažemo, da je Vlada Kosova poslovala sa deficitom, ne sa suficitom. Imala je suficit prenesenih 211. miliona iz 2007. godine. Molim za pažnju! 211 miliona, što znači kad bi od 228. miliona deficita

oduzeli ovih 211 miliona koje je prenela iz 2007.godine, ponovo ima deficit ili da kažemo nije pokrila troškove u iznosu od 17 miliona, što znači da je više potrošila, nego zaradila, nego što je prihode imala. To su pravi pokazatelji, čitajte ove podatke koje sam vam dala. Znači, smanjenje je u procentima 1,56 a ne povećanje.

Moramo da znamo šta je pasiva i aktiva bilanca. Aktiva bilansa su sredstva u opticaju, monetarna sredstva, a pasiva su fondovi. Kada odemo kod fondova, vidimo da imamo 879 miliona u fondovima. Šta to znači? Imamo fond KPA, to je Poverilačke agencije Kosova od prodata preduzeća, imamo fond vredonosnih papira Vlade od 266 miliona, imamo novac u govovini od 6 miliona i to je ukupno 879 miliona. Od toga, u izveštaju se kaže na strani, na početku da Centralna banka ima 203 miliona, a kada je izveštaj poverilačkog fonda, ustvari KPA, fonda Agencije za privatizaciju, tamo se kaže da imamo fond od 403 miliona i da je u svojstvu Centralne banke, to je stranica, ja ću malo da vam oduzimam vremena, to je strana Centralna banka, vidite sredstva fonda KPA, kaže: „Na ime Agencije, Centralna banka Kosova ima 403 miliona, 313, a ustvari ona u glavnom generalnom izveštaju, na početku kaže da poseduje 203 miliona, što je jaka disproportcija, što možemo da pitamo gde je ostalih 200 miliona, gde se nalazi, gde je oročeno, u kom fondu, u kojoj državi. Evo, to su prava pitanja koja mi danas treba ovde da postavimo i da budemo mnogo ozbiljni.

Ja ću posebno da se ostvrem na ukupan prihod, kako je formiran. Na ukupan prihod najviše je donelo Carina, i to 70%, 20% doneto je od PDV, ili od poreza i doprinosa, 5% su donele opštine, 43 miliona i 3% ostalo. Znači, kada ne bi bilo, mi i dalje samo uvozimo. 002% je stavka našeg izvoza u ovom bilancu. Evo, to treba da nas zabrine. To su elementi koji pokazuju da sve kupujemo, a nemamo ništa, ne proizvodimo i ništa ne prodajemo.

Od ovoga, ja bih se sada najviše ostvrnula na kapitalne investicije, na kapitalnu stavku investicija, gde je investirano od kosovskog budžeta. Lepo piše, ako saberemo stranicu 41 do 49 ovog izeztaja, videćemo kapitalne investicije da su 480 miliona, saberite sve stavke po ministarstvima i po opštinama, tamo gde piše kapitalne investicije, dobićete ovu cifru, što znači da je 55% od budžeta Kosova ulagano za kapitalne investicije, a kada se planira dobar budžet, 30% je maksimum za kapitalne invsticije, 30% što znači šta smo mi radili, mi smo pola i više budžeta trošili na kapitalne investicije. Mi nismo protiv kapitalnih ivesticija, ali ako se okrenemo na stavku plate, plate i penzije, tamo gde kažemo da je bilo povećanje plata i penzija, iz izveštaja, to što brojke kažu, brojke kažu da je 228 miliona isplaćeno na ime plata, 134 miliona penzija, što ukupno iznosi 362 miliona obe stavke. Ove stavke sa 33.21%, utiču u ukupnom kosovskom budžetu. Pa znate da je u regiji 54% prag, prag za plate i penzzije. Mi smo ispod svakog praga, ispod svakog standarda koji građani imaju u regiji. Ne kažem Nemačkoj, ne kažem u Engleskoj, ali u regiji, tamo gde smo bili, tamo od dakle smo se odvojili. Molim vas!

Bruto lični dohodak je samo 1140 euro, što znači 95 eura mesečno, ili 3,15, 3 erura 15 centi imamo dnevno na raspolaganje po glavi stanovnika. Ovo treba mnogo da nas brine.

Isto je to i sa penzijama. Fond za penzije je malo izdvajanje. Kda idemo po ministarstvima, tamo gde ima razvoja, gde treba da potenciramo poljoprivredu, razvoj, ruralne oblasti, minimum izdvajanja, nema budžet precizne podatke, nema tačne podatke, nema ljudski resurs, nema tamo gde su plate i dnevnice da izdvojimo, koliko su po ministarstvima, koliko po agencijama, koliko po preduzećima, kakva je struktura

plata. Nema, to moramo da kažemo ovde svi da apelujemo na Vladu, sledeći izveštaj da bude bolji.

Jedno me čudi. Komsija za budžet i finansije da nije vratila ovaj izveštaj. Trebala je da vrati i da dopune ovaj izveštaj. Zašto kažem ovo? Zato što jednostavno nama je danas premijer poručio ovako, kaže: „Vlada kontroliše parlament, ja se slažem, ali i premijer posebno mora da se složi sa nama poslanicima. Ja kažem ovako, da dobar parlament kontroliše Vladu. A mi smo ljudi dobar parlament, mi smo počeli da radimo, mi radimo intenzivno, da li je to opozicija, poizicija, koalicija mi moramo da radimo. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Urdhëro, ministër, e ke fjalën! Fehmi Mujota e ka fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Ju faleminderit, i nderuari Kryetar,

Të nderuar deputetë,

Unë dua ta falënderoj deputetin Gani Koci që në detaje ka analizuar të gjitha shpenzimet e ministrive, mbi të gjitha ka dhënë një vërejtje në adresë të Ministrisë së Forcës së Sigurisë, që është e qëndrueshme në raport me numrat që janë prezantuar, por para së gjithash, para publikut dhe para juve dua ta sqaroj një çështje.

Ministria e Forcës së Sigurisë është ministria më e re që është themeluar në Qeverinë e Kosovës. Ky Kuvend për Ministrinë e Forcës së Sigurisë ka aprovuar buxhetin diku në muajin shtator dhe ka qenë një kohë e shkurtër për realizim. Faktori i dytë, që është edhe më i rëndësishëm, është ai se në momentin e fundit, kur ne kemi pasur një tender të hapur për investimet publike për blerjen e veturave, që e falënderoj Kuvendin, kanë paraparë diku 280 mijë euro. Ne nuk kemi pasur nevojë t'i blejmë këto vetura, meqë kemi pasur një projekt tjetër që ishte realizuar shumë më herët në Zyrën e koordinatorit, jemi pajisur me ato vetura që kemi pasur nevojë dhe unë mbaj përgjegjësinë që e kam stopuar këtë tender dhe nuk kemi blerë veturat që nuk kemi pasur nevojë për momentin, prandaj kanë ngelur një sasi e mjeteve në buxhetin e Kosovës, që mund të destinohet diku tjetër. Por, kjo nuk do të thotë që Ministria e Forcës së Sigurisë në një të ardhme mund të ketë nevoja shumë më të mëdha dhe në situata të caktuara do të mund të kërkoj buxhete shtesë, që besoj se Kuvendi do të ketë sigurisht miratimin dhe aprovimin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër!

Fjalën, sipas radhës, e ka deputeti Xhevdet Neziraj, le të përgatitet Synavere Rysa.

XHEVDET NEZIRAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuari Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Ne sot jemi duke e shqyrtuar një raport të shpenzimeve dhe të hyrave gjatë vitit 2008 dhe unë do të isha ndalur në tri çështje. Nuk do të ndalem shumë në shifra, se më parë Bajram Kosumi e tha një gjë, që edhe unë po dyshoj, se mos disa kanë ndonjë raport tjetër, ndërsa unë e kam tjetër.

Dikush më parë doli dhe tha se shpenzimet e përfaqësimit ose të reprezentacionit janë më të vogla. Unë po e shoh që janë më të larta në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007. Gjithashtu, edhe disa shpenzime tjera.

Nuk do të ndalem në këto shpenzime, se u cekën shumë dhe u përdorën dhe bëri mirë që ministri i Ekonomisë dhe i Financave erdhi këtu, koleg i nderuar edhe i profesionit, do të bisedoj me te kështu. Nuk di, po kuptoj se të hyrat kanë qenë më të mëdha se sa në vitin 2007 dhe ato janë bërë të hyra nga tatimet direkte, do të thotë, se mbledhen direkt në kufi dhe që ndoshta është e metë e ekonomisë në përgjithësi të Kosovës që pas luftës. Do të ishte dashur dhe do të kishte qenë mirë sikur këto të hyra, arritje të kishim në mbledhjen e tatimeve nga Administrata Qendrore Tatimore, por për këtë edhe ka përparme. Por, unë do të ndalem edhe në diçka tjetër, sepse më parë e thashë se ju këtu nuk ishit, shpenzimet e reprezentacionit në vitin 2008 janë më të mëdha se në vitin 2007.

Gjithashtu, shpenzimet për qira janë më të mëdha në vitin 2008, se sa në vitin 2007. Këtë duhet ta themi dhe ta pranojmë ashtu siç po i pranojmë edhe të hyrat. Gjithashtu, askush nuk është duke e mohuar se s'ka punuar kjo qeveri, se nuk ka pasur ndërtime të shkollave, që nuk ka pasur ndërtime të rrugëve.

Unë do të kisha lutur zoti Adem Grabovci, se jam afër me te në Pejë, dhe të vjen se pas 55 vjetëve që jetoj në Pejë, jam pa asfalt dhe nëse i ka shtruar 600 kilometra, le ta shtrojë edhe një kilometër, do të thotë ka edhe shumë rrugë, ka edhe shumë punë, ka edhe shumë çka të bëhet.

Unë do të ndalem, që thashë edhe më parë, në këto drejtime. Një, do me thënë se kemi mungesë të kapaciteteve absorbuese të agjencioneve të shpenzimeve. Pse e them këtë? Në të gjitha agjencionet që harxhojnë buxhetin e Kosovës, zoti ministër, dua të them se ka mungesë të kuadrit dhe të njerëzve profesionistë, që dinë të menaxhojnë buxhetin në afate të caktuara. Këtë e them me fakte. Fakt ky është se kur nisem nga një parim, që gjysmëvjetori i parë është shumë më real se gjysmëvjetori i dytë, edhe në ekonomi gjysmëvjetori i parë, 6 mujori është shumë më real se ai i fundit sa i përket shpenzimeve dhe në 6 mujorin e parë ne kemi pasur ministri që kanë realizuar vetëm 20% të buxhetit. Ky duhet të jetë një alarm dhe me sinjeralitetin më të mirë po ta them që ministrinë duhet të kenë kapacitetet që të menaxhojnë në afate të caktuara buxhetin dhe për këtë nuk kemi.

Unë, dua ta marrë edhe një shembull, se një prej ministrive më të suksesshme, sikurse është Ministria e Arsimit, bie fjala në gjashtëmujorin e parë ka realizuar buxhetin vetëm 20%. Është ndërtuar shkolla në Dardani, është shumë e vërtetë, një shkollë e mirë, mirëpo dy tri javë ajo shkollë nuk ka pasur mjete si shkolë ose diçka tjetër dhe ky është një problem, që të gjithë ministrat duhet të këqyrin në kabinetin e tyre dhe të kenë njerëz që dinë të menaxhojnë buxhetin në bazë të afateve të caktuara.

Një problem tjetër që kisha për ta cekur, janë edhe barrierat në procedurën e prokurimit. Me të vërtetë, nëse Ligji i prokurimit është, edhe më herët e kam thënë, edhe atëherë në Qeverinë e kaluar kam thënë se Ligji i prokurimit duhet të ndërrohet. Atëherë kemi pasur një kritikë nga njerëzit e opozitës, që tani janë pozitë, pse të ndërrohet Ligji i prokurimit, ndërsa tani kërkojnë Ligjin e prokurimit. Me të vërtetë, Ligji i prokurimit është ai i cili shumë ministrive dhe shumë agjencioneve shpenzues ua lidh duart. Prandaj, për atë edhe Komisioni Evropian ka dhënë një vërejtje që duhet të hartohet Ligji i ri i prokurimit që do të tregohet shumë më i suksesshëm në praktikë. Mirëpo, me këtë ligj që kemi punuar deri më tani, kemi pasur disa shkelje, atë që e përmendi zoti Shatri, ku nga 148 kontrata, 15 kontrata janë të negociuara dhe gjithashtu te kontratat mbi 3 milionëshe,

44 kontrata janë jo në bazë të Ligjit të prokurimit dhe të menaxhimit publik të financave. Edhe këtë duhet të shqyrtojmë.

Një tjetër që do ta kisha biseduar, është edhe menaxhimi nëpër ministri. Unë nuk do të ndalem shumë, po do të ndalem në projektet e ministrisë së famshme, të Ministrisë për Komunitete e cila me të vërtetë nuk është kah di të kthjellët dhe dua t'i them me argumente këtu, ashtu mi ka pru Qeveria dhe unë pajtohem me zotin Stojanoviq që tha, duhet të rritet buxheti për komunitete, por ai buxhet në atë Ministri për Komunitete duhet të ndahet në mënyrë të barabartë për të gjitha komunitetet.

Unë do t'i marrë shembull vetëm disa projekte. Për shembull, projekti i ujësjellësit në komunën e Istogut, Zallzë, Dobrushë, mandej Staradorancë, Zabllaq, Zallq, janë projekte që unë mora informacione, se e kam përfaqësuesin e partisë time në Kuvendin Komunal të Istogut, dhe ende nuk kanë filluar, ndërsa këtu figuron si projekte që janë realizuar në vitin 2008. Është edhe një diçka tjetër që në Ministrinë për Komunitete kryesisht janë harxhuar mjetet në dy komunitete, është investua në komunitetin etnikisht shqiptar, sikur që është Strellci dhe, këtu është zoti Zemaj i Strellcit, i kam pas dajë para 20 vjetëve, po aty s'janë, veç një shtëpi ka qenë. Dhe, tani është investuar në Strellc, komuna e Deçanit dhe te komuniteti Serb, ku është etnikisht i pastër. Ku janë komunitetet tjera. Do të kisha lutur, edhe Zyra e Kryeministrit, përveç që e ka në Kabinetin e tij do zyrtarë që ia kanë pru të UNMIK-ut, ia kanë lënë aty, s'di çka të bëjë me ta, me ata dy persona, dhe ka pasur edhe 1 milion euro për buxhet për komunitete. Komuniteti egjiptas këto nuk po i sheh, them nuk është duke i prekur me dorë. Dhe, shtrohet pyetja që me plotë të drejtë zonja doktoreshë Morina tha, zyrat e komuniteteve kanë mjete të shumta edhe unë po them, tash po nënshkruhem që më mirë mos të shkojnë në Zyrë të komuniteteve, se nuk janë duke i shfrytëzua si duhet, po le të shkojnë në Ministri të Shëndetësisë, ku me të vërtetë do të kenë qasje të gjithë qytetarët e Kosovës, por edhe komunitetet.

Unë nuk do të ndalem më shumë, mirëpo edhe një herë lus ministrin e Ekonomisë dhe Financave, tani jemi dhe duhet të përgatitemi për hartimin e buxhetit të ri për vitin 2010 dhe qysh tash le të bisedojë nëpër agjencionet shpenzuese se, mjerisht, nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për menaxhim të buxhetit, ashtu siç parashihet në baza ekonomike. Për ta caktuar këtë edhe një herë, unë e di në Komisionin e Buxhetit një ose dy ditë para se të miratohet buxheti, shumë ministra kanë ardhur në Komisionin për Ekonomi dhe Buxhet dhe kanë kërkuar ndoshta edhe ndërrimin e kufijve buxhetorë, sepse nuk kanë ditur fort mirë edhe sa i kanë buxhetet, për arsye se ndoshta kanë qenë shumë të gëzuar se po e miratojnë një buxhet në Republikën e Kosovës, mirëpo nuk i kanë ditur mirë shifrat. Besoj që tash do të jenë më të përgatitur dhe do të menaxhojnë edhe më mirë buxhetin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë këtu në diskutimin tim nuk kam mbrojtur Qeverinë, se Qeveria mbrohet me vetë punën dhe sukseset e veta të cilat edhe sot i patë këtu. Unë do të mbrojë fjalën time që e kam thënë këtu para pak çastesh, kur kam folur për kursimet në shpenzimet e kësaj Qeverie nga ajo që ka proklamuar në fillim të mandatit të saj, vërtet është kështu siç e them unë dhe jo siç e thotë Xhevdeti atje. Në krahasim me vitin 2007 është 18 milionë e 440 mijë. Në vitin 2008 është 18 milionë e 165 mijë, do të thotë edhe si e tillë është më e vogël se në vitin 2007, por kur i shtohen kësaj ose i hiqen 2 milionë e 233 mijë, që kanë ... nga viti 2007 dhe janë paguar në vitin 2008, atëherë Qeveria ka pasur vetëm 15

milione e 922 mijë euro shpenzime, që do të thotë janë minus 14% kursime në këto kategori që i përmenda më herët. Prandaj, ju lutem, në totalin e këtyre të shohim sa ka pasur obligime nga viti 2007, por edhe si të tilla performanca e Qeverisë del shumë pozitive, zoti Xhevdet.

KRYETARI: Faleminderit! replikë Xhevdet Neziri e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRI: Jo, faleminderit! unë veç do të them që në faqen 23 shkruan që shpenzimet e përfaqësimit kanë qenë 1 milion e 663 mijë në vitin 2008, ndërsa në vitin 2007 kanë qenë 1 milion 500 e diçka, mua po më del ma pak, ndoshta nuk di se në cilin raport është kah këqytet.

KRYETARI: Aq ju kanë ngatërruar shifrat. Adem Grabovci, replikë.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë vetëm desha të informoj zotin deputet, se Qeveria vetëm në komunën e Pejës gjatë këtij viti ka investuar mbi 8 milionë euro vetëm në infrastrukturën rrugore. Ndërsa sa i përket kërkesës së Xhevdetit, më tepër i takon Kuvendit Komunal të Pejës, ne i respektojmë prioritetet që i përcaktojnë kuvendet komunale, gjegjësisht kryetarët e komunave dhe drejtoritë përkatëse që i sjellin tek ne, ndërsa ne nuk kemi të drejtë që të implikohemi drejtpërsëdrejti.

Për komunën e Pejës, për informim të Xhevdetit dhe të gjithë të tjerëve, se këtu u ngrit disa herë çështja e investimeve në regjionin e Dukagjinit, që kalon vetëm nga Ministria e Transportit mbi 20 milionë euro, prandaj është një regjion i privilegjuar nga Qeveria aktuale. Vetëm në komunën e Pejës, për dijeni, po ashtu janë të realizuara diku mbi 11 apo 12 projekte të mëdha dhe të vogla, që për komunën e Pejës do të thotë shumë. Kjo komunë, jo për një vit, një vit më parë, në vitin 2007 nëse bën krahasimin, investimet nga Qeveria e nivelit qendror, nga Ministria e Transportit ka qenë 300 mijë euro, ndërsa nga Qeveria aktuale për një vit kanë qenë 8 milionë, jo për një mandat, por as për 10 vite, edhe për ma shumë vite, komuna e Pejës nuk ka parë investime më të mëdha se sa ka bërë kjo Qeveri për atë komunë dhe për regjionin e Dukagjinit në tërësi.

Dua të shtoj edhe diçka këtu. Qeveria e Kosovës mendoj se ka arritur dy gjëra, që janë, për mendimin tim, shumë të rëndësishme për të gjithë qytetarët e vendit. Së pari, ka krijuar besimin tek qytetarët...

KRYETARI: Faleminderit!

Replikat nuk i kam shpikur unë, do të thotë, dihet. Jo, unë isha duke kërkuar, po ju po flisni shumë. Ndoshta është mirë t'i shkurtojmë diskutimet në 5 minuta dhe pastaj mendoj se është koha t'i kufizojmë në 5 minuta. A jeni dakord? Atëherë, do të thotë diskutimet janë 5 minuta. Ju faleminderit! Regjia, ta keni parasysh, 5 minuta diskutimet.

Fjala është për deputeten Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë mendoj ndoshta edhe kur ta zvogëloni minutazhin në 2 minuta, do të ishte edhe në rregull, sepse qasja sot qysh ka qenë ndaj këtij raporti pikërisht nga pozita dhe nga qeveria, ka qenë shumë e papranueshme për ne si kuvendarë, por mbi të gjitha për qytetarin e Kosovës. Nuk e di a ka mund ta bëjë një dallim qytetari a është në fushatën elektorale të ndonjë partie politike apo po debatohet për Raportin vjetor të Qeverisë për vitin 2008, se si janë krijuar të hyrat e këtij shteti për vitin 2008 dhe si janë shpenzuar ato.

Prandaj, duke u munduar për t'i minimizuar gjërat që vërtet kanë ndodhur, ato që vërtet kanë qenë ndoshta të pakëndshme, por kanë ndodhur megjithatë, duke rritur në vlerën më të madhe ato të arriturat që i quajti Kryeministri, vërtet kjo ka qenë ndoshta një diçka që shumë me rezervë e kanë marrë qytetarët e Kosovës.

Sido që të jetë, unë do të vazhdoj, nuk do të vazhdoj më tepër me replika sepse e di se, dashur e pa dashur, Kryeministri një praktikë të mirë e instaloi që mbas çdo diskutimi të deputetëve të bënte replikë, kështu replikë ndoshta vend e pa vend, por megjithatë unë do ta ftoj, le të replikojë edhe mbas diskutimit tim, por unë megjithatë do të kthehem shkurtimisht te raporti, sepse edhe koha u kufizua.

Fillimisht, këtij raporti i mungon pjesa hyrëse apo përmbledhja ekzekutive, duke pasur parasysh se këtu kemi të bëjmë me një material mjaft voluminoz dhe me raportet tabelare, kjo do t'i ndihmonte shumë deputetët të cilët vinë nga sfera të ndryshme. Sido që të jetë, raportet tabelare janë mjaft mirë të detajizuara dhe të paraqitura.

Por, çka në fakt mund të gjejmë në këtë material. Si qeveria i ka shpenzuar mjetet dhe si i ka grumbulluar mjetet për vitin 2008.

Mendoj se për vitin 2008 Qeveria ka menaxhuar jo mirë buxhetin të cilin e ka pasur në dispozicion. Edhe më tutje suficiti sikur është krijuar një barrierë dhe patjetër duhet të jetë suficit nga Qeveria e Kosovës. Kësaj radhe raportohet diku 135 milionë euro në suficit, por megjithatë dyshohet se është edhe më i lartë. Po, duke i mbledhur edhe ato nga vitet e mëparshme, është diku 500 milionë euro.

Vërtet, pyes Kryeministrin, a ka qenë në rregull që të mbetet kjo shumë 135 mijë euro në suficit në këtë gjendje kur Kosova po ballafaqohet me varfërinë ekstreme. Për vitin 2008 të paktën raporti i UNDP-së tregon se kjo varfëri është rritur në 17%, ndërsa varfëria në përgjithësi në Kosovë ka kaluar në 47% dhe a ka qenë në rregull që këto mjete të mbeten të bllokuara dhe të pa shpenzuara nga ana e Qeverisë dhe sa kjo ka qenë parimore?

Ajo që është më shqetësuese, është mbetja e suficitit në kategorinë -Paga dhe shërbime ku në fakt këtu kategoria e pagave është një kategori fikse, ku në mënyrë shumë strikte mund të definohet dhe është dashur të jetë një kategori që jo 94, 92 ose 90% e shpenzuar, por është dashur të jetë 100% e shpenzuar. Megjithatë, këtu është raportuar se diku janë 9 milionë mbetje nga kategoria e pagave, ndërsa në anën tjetër kemi pasur tronditje edhe kemi pasur pakënaqësi nga ana e punëtorëve të shëndetësisë, kemi pasur probleme me arsimtarët, si s'ka mundur Qeveris që këto mjete të paktën në formë të ndihmave apo në forma të ndryshme t'i lansojë dhe brenda viti të jenë në qarkullim, por t'i mbaj të bllokuara.

Unë do të ndalem në tri pozicione të rëndësishme që vërtet e bëjnë buxhetin e çdo institucioni, por edhe buxhetin e shtetit.

Është pozicioni mallra dhe shërbime. Dhe, vërtet, Qeveria dhe pozita krenohet se si vërtet në vitin 2008 ka arritur që ta zvogëlojë këtë pozicion me shifra mjaft marramendëse, që për mua janë shumë pak bindëse. Po ju them, të nderuar, si keni menduar që pozicioni -Mallra dhe shërbime, që kemi të bëjmë kryesisht me blerjen e veturave, kemi të bëjmë me blerje të kompjuterëve, ai pozicion është, këto gjëra janë kryer në vitet e mëparshme 2007, 2006, mirëpo këtu mendoj se Qeveria ka dështuar në planifikim dhe është planifikuar nga vitet e mëparshme, ndoshta edhe është rritur, aty ku

është dashur të zvogëlohen pozicionet janë rritur, pasqyrat e këtij buxheti janë rritur, ndërsa aty ku është dashur të zvogëlohet, është shkuar një politikë e mençur, por megjithatë jo e mirë, kjo ka shkuar ndoshta në dëm të qytetari.

Investimet kapitale. U fol mjaft dhe vërtet është një pozicion që duhet ta përkrahin të gjithë. Mirëpo, si janë menaxhuar mjetet në këtë formë, vetëm projekti i rrugëve e dimë si një diçka që mund ta shohim të gjithë, edhe qytetarët e Kosovës, është kualiteti i rrugëve. Duke pasur parasysh një kualitet dhe cilësi kaq të ulët të rrugëve të ndërtuara në Kosovë që brenda 2 – 3 muajve janë shkatërruar, atëherë

KRYETARI: Faleminderit! 5 minuta ju e dini që është...

Një sqarim deputete, të drejtën për të folur Kryeministri sa herë që e kërkon fjalën, e jep Rregullorja e Punës së Kuvendit, por edhe praktika parlamentare është e tillë. Prandaj, mendoj që kjo është kështu. Mirë, edhe një minutë deputetes Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë shkurtimisht në fund, me qenë se e kam kohën shumë të shkurtër. Unë shpresoj që ky raport të paktën të qitet në votim, sepse e kemi pasur dje rastin, kur Raporti për Autoritetin Rregullativ që është pjesë e këtij buxheti, nuk është miratuar dhe aty në bazë të asaj praktike të instaluar dje dhe në bazë të atij debati është kuptuar që vërtet lë dyshime për korrupsion. Unë këtë hipotezë e ngre nga argumentet e bazuara.

Një, vjen një raport dhe debatohet në Kuvend, mirëpo nuk miratohet, në fakt nga kjo Qeveri që vërtet para dy viteve kanë qenë në opozitë, është bërë një zhurmë kaq e madhe dhe në momentin kur vjen për të pasur mundësi për t'u marrë me rastin, e heshtin, kaq në heshtje kalon Raporti i Autoritetit Rregullativ këtu e lënë mundësi dhe nga ky rast po edhe nga raste të tjera që vërtet të dyshohet. Unë i përkrah deputetët e mëparshëm që të kemi auditim dhe të kërkojmë auditimin e financave të Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, e keni keqpërdorur pak kohën, po një çështje dua të them. Ne miratojmë edhe Rregulloren, dje i lexova rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, dhe Rekomandimi nga Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka qenë për të votuar rekomandimet. Unë ua kam lexuar edhe raportin, edhe rekomandimet. Prandaj, mos ta përsërisim atë që nuk duhet ta përsërisim.

Nuk ka replikë me mua. Fjalën e ka kërkuar deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet Shkumbim Demaliaj.

MYZEJENE SELMANI: faleminderit, zoti kryetar për fjalën!

Përshëndetje për Kryeministrin, se sot më duket shumë ka qenë i zënë gjatë shqyrtimit të raportit gjatë gjithë kohës, edhe për gjithë ministrat që janë prezentë këtu, për deputetë.

Sa i përket raportit financiar buxhetor 1 deri më 31 dhjetor, nëse e marrim për ta analizuar në mënyrën sa më të sinqertë edhe sa më të mirë edhe prej rishqyrtimit të buxhetit 2008, gjashtëmujorin e parë, atëherë mund të shohim sa i përket shfrytëzimit të buxhetit 2008 edhe më herët jemi prononcuar që sidomos tremujorëshi i fundit i shpenzimeve të buxhetit të Kosovës ka qenë në mënyrë jo të rregullt pa një strategji të mirëfilltë. Kur kësaj i shtojmë se deri më 30 tetor bëhen shpenzimet vetëm 30%, si është e mundur që çdo vit fiskal për dy muajt e fundit shpenzimet arrijnë 80% apo 70%, mandej realizohen të gjitha investimet. Të kisha lutur, kur të përfundoj, mandej secili ka të drejtë të diskutojë. Të arrihen të gjitha shpenzimet në shifrën më të madhe, do të thotë

bëhen investime kapitale, gjë që të lë për të dyshuar shumë. Shumë projekte paguhen akoma pa përfunduar, nuk ka respekt ndaj procedurave gjatë shpenzimeve të buxhetit, me të drejtë lindin dyshimet se a shpenzohet paraja publike apo taksat e qytetarëve të Kosovës në mënyrën më të mirë të menaxhimit. Kur marrim rritjen e disa pagave të sektorëve të ndryshëm, bëhet zvogëlimi i projekteve kapitale që është në kundërshtim me ligjin. Mbetet që të vlerësojnë qytetarët e Kosovës sa shpenzohet mirë dhe si menaxhohet mirë me buxhetin dhe me taksat e tyre në këtë Qeveri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

Ne përsëri munguam në një pjesë të debatit për shkak të mbledhjes që kishte mekanizmi përcjellës. Por, dua të kyçem në bisedë, ju vetë keni kërkuar, të nderuar deputetë, debat sa i përket Raportit vjetor të shpenzimeve dhe ne ju kemi bashkangjitur këtij debati për t'i kontribuar sqarimit edhe në Kuvend, por edhe në raport të rritjes së transparencës me qytetarë.

Fillimisht, pa dashur të polemizoj, por të sqaroj. Për disa çështje që u ngritën këtu merret nga zoti Makolli, zoti Makolli duhet dhe e di se ky në Kuvend, ky nuk është Kuvendi Komunal i Prishtinës, por është Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe disa çështje mund të drejtohen dhe adresohen në Prishtinë.

U ngrit çështja e disa ujësjellësve në Istog. Unë dua të potencoj se projekte të cilat janë në proces do të përfundojnë të gjitha, kisha ftuar t'i vizitosh. Në anën tjetër një ... keq për qytetin e Klinës, që kemi ndarë mjete prej 2.5 milion euro deri 3 për të sjellë ujësjellësin për të gjithë qytetarët e komunës në Klinë, por ai projekt është ndërprerë përkohësisht për shkak të disa pengesave krejt të panevojshme, mund të them, e që dua të besoj se do të tejkalohen, ka qenë një projekt i iniciuar dhe me herët në mënyrë që të mos ketë pengesa të sjelljes së ujit përmes kanalizimeve nga komuna e Istogut, por nga bjeshkët e Istogut.

I nderuari Kryetar,

Unë nuk dëshiroj ta keqpërdor mikrofonin, por ta respektoj Rregulloren, të drejtën time të fjalës.

Të nderuar deputetë,

Përveç performancës së mirë në ekzekutimin e shpenzimeve kapitale nga ministrat, ministritë, edhe komunat kanë pasur përmirësime signifikante si në komunat në vijim në realizimin e investimeve kapitale: Gllogovci ka pasur 13% më tepër, Fushë Kosova 86%, Lipjan 124%, Obiliq 130%, Podujevë 13%, Prishtinë 63%, Shtime 52%, Dragash 64%, Prizren 16%, Rahovec 46%, Suharekë 51%. Vazhdojmë, Deçan 53%, Gjakovë 96%, Istog 54%, Klinë 67%, Junik 21%, Pejë 185%, Mitrovicë 91%, Skenderaj 79%, Vushtrri 139%, Gjilan 64%, Kamenicë 141%, Ferizaj 19%.

Edhe sa u përket disa zhvillimeve tjera, që u potencuan këtu, edhe sa i përket sektorit të energjetikës, pikërisht prej parametrave diskutues që dolën edhe këtu, faturimi ka shënuar rritje 25%, inkasimi 18.26% rritje. Humbjet janë zvogëluar nga 47 në 41, pra mbi 5%. Trendi i mirë do të vazhdojë, do të vazhdojmë me investime se ndërlidhen të gjitha edhe këto me procesin dhe temën të cilën jemi duke diskutuar. Në projektin e Zhurit, i cili do të përmbyllet sivjet e që do të ketë një investim mbi 300 milionë euro me rreth 300 megavat kapacitet, me mundësi të reja për punësimin e njerëzve dhe ... të energjetikës.

Gjithashtu, sivjet do të vazhdojmë me koncesionin e 16 hidrocentraleve të vogla me një kapacitet deri në 60 dhe 70 megavat. Investimet në kostransmision do të vazhdohet si në Pejë 3, Ferizaj 3. gjithashtu janë bërë investime dhe do të bëhen edhe në KEK, në minierën e Sitnicës, Sibovcit si dhe në ekskavatorë. Pra, dua të ripotencoj, prodhimi për energjinë elektrike është rritur 10%, furnizimi 35% dhe me siguri ju keni harruar kur është ndalur rryma dhe do të ketë edhe më tepër.

E përmendi zoti Çeku më herët PPP procesin. Po sot, në pauzë të këtij debati, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për vazhdimin e procesit të koncesionit të aeroportit dhe dua të prezantoj vetëm disa shifra dhe fakte edhe të mira që do t'i ketë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe shteti ynë nga kalkulimet e benifitit ekonomik dhe opsionet investuese dhe të operimit, projeksionet e rrjedhjes së parasë për Qeverinë për 20 vitet e ardhshme. Status koha, trafiku i ulët, tani është 128 milionë, trafiku mesatar 212 dhe trafiku i lartë 290. Kontrata menaxhuese -157 milionë, zoti Kosumi, 269 milion trafiku mesatar, 356 milionë trafiku i lartë. Procesi dizajno, ndërto financo, opero dhe transfero pas 20 vitesh do të jetë: trafiku i ulët -170 milionë, trafiku mesatar -313 milionë dhe trafiku i lartë -403 milionë. Pra, dallimi do të jetë nga 290 në 403 milionë.

Mund të vazhdojmë edhe në sektorët e tjerë në të cilët dëshironi t'ju informojmë, krahasuar edhe në bujqësi.

Rritja krahasuar me vitin 2007 ka qenë 44%, ndërsa për vitin 2009 përsëri planifikohet rritje edhe për 40%. Rikonfirmoj edhe një herë, ne do të vazhdojmë me investime, investime të cilat janë të prekshme, janë në të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës. Ne e kemi bërë këtë që po shihet dhe që e shihni të gjithë ju. Do të vazhdojmë edhe me punë tjera, e kemi bërë sepse kemi pasur mundësi që këto potenciale t'i shfrytëzojmë me qeverisjen më të mirë të mundshme, por e di se mund të bëjmë më tepër dhe pres nga gjithë ekipi im të vazhdojë me punë të mira dhe të bëjë punë edhe më të mira.

KRYETARI: Faleminderit!

Për replikë, Bajram Kosumi, pastaj Ibrahim Makolli.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, Kryetar!

Me të vërtetë, Kryeministër, unë kisha pak vështirësi t'i kuptoj shifrat çka i ke folur sot gjatë tërë ditës, e tash e kuptova thelbin. Ju po flisni për shifrat mbas 20 vjetëve, e kuptova.

KRYETARI: Faleminderit!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti ish-Kryeministër, Kosumi.

Unë po flas për vendimin e Qeverisë që e kemi marrë sot dhe përfitimi i Kosovës do të jetë në shifrën me dallim prej 290 milionë, në raport me 403 milionë që planifikohen.

KRYETARI: Faleminderit!

Zoti Kosumi, Parlamenti nuk është i obligueshëm t'i ngrisë kapacitetet financiare, të njohurive financiare. Fjalën e ka deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti Kryeministër, unë po flas përkitazi me këtë material që shkruan në informatë për shqyrtimin e Raportit financiar të buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2008, që nënkupton gjithë buxhetin e shtetit dhe jo vetëm buxhetin e

ministrive. Dhe, po flas, nëse problemi është diku, atëherë problemi është te dikasteret që e kanë përgatitur këtë material, sepse brenda tij kemi edhe shpenzimet për komunat dhe, natyrisht, në mbështetje të kësaj, unë kam përmendur vetëm një pjesë të atyre që kanë ndodhur në një komunë, në të cilën unë jetoj dhe e njoh se çka është veprua dhe kam folur, po ashtu, në bazë të këtyre përqindjeve dhe të këtyre shifrave që janë afruar brenda këtij raporti. Konsideroj që buxheti i dedikohet gjithë shtetit, pavarësisht a është në nivel të ministrive ose në nivel të tjera dhe po flasim për këtë. Ju kisha lutur, nëse tjera herë do të duhej, atëherë të ndahet buxheti në nivel qendror dhe flasim për nivelin qendrorë, por unë kam folur për komplet buxhetin e shtetit që e përfshin edhe një komunë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kërkuar, ministri Hoxhaj.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuari, zoti Kryetar!

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Desha ta tërheq një paralele mes debatit që zhvillohet në këtë sallë dhe mes punës konkrete. Ne e patëm një konferencë, e cila vazhdon edhe më tutje, të stabilizim-asocimit dhe unë isha duke raportuar aty për përpjekjen tonë, si ministri, për integrimin e komunitetit ashkali në institucionet arsimore, të komunitetit romë dhe të komunitetit egjiptian dhe kur vi në sallë, e dëgjoj deputetin që flet në emër të ashkalive, thotë e keni ndërtuar shkollën në Pejë, por s'i keni sjellë shkumësat, duke mos e pasur idenë e qartë se shkumësat i siguron drejtori i shkollës, jo ministri i Arsimit, mirëpo kjo tregon se sa të shkëputur ne jemi prej realitetit dhe se sa larg jemi prej shoqërisë dhe sa me lehtësi flasim nganjëherë në emër edhe të një komuniteti, i cili komunitet definitivisht e ka gjendjen shumë të vështirë edhe sa i përket arsimit dhe nuk dinë t'i dallojnë se ku t'i shtrojnë kërkesat.

Po filloj me abetaren. Ka 2 – 3 deputetë sot që e kanë përmendur abetaren edhe pse asnjëri prej tyre nuk e ka përmendur një fakt që nga vitit 2002, kur është miratuar Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm, qeveritë do të duhej t'i siguronin tekstet falas dhe asnjëherë nuk e kanë bërë, dhe nëse ne i kemi siguruar tekstet falas për 320 mijë nxënës, tash debatohet çmimi a kushton abetarja 15 euro a jo. Reagimi im i parë edhe si njeri në politikë, edhe si akademik është që dikush, nuk di sikur ka blerë libra për herë të fundit, pra s'e di edhe çmimin e librave, se mjerisht librat janë në Kosovë goxha të shtrenjta, prandaj edhe ne kemi iniciuar lirimin e librit prej TVSH-së, kjo qeverie ka liruar librin prej TVSH-së, se është shumë i shtrenjtë.

Përveç kësaj, tek abetarja dua t'ju informoj që nxënësit në Kosovë kanë mësuar pothuaj se 20 vet me një abetare dhe kjo abetare të cilën ne e kemi siguruar, është një pako, i ka 5 libra. Kam vendosur t'i sjell, ka 5 libra, plus ka materiale tjera, ka një paraabetare, që mendoj që edhe njerëzit që janë në politikë duhet ta dinë a janë abetare, a janë paraabetare. Ka abetaren dhe ka pastaj fletore pune për nxënës, që punohen në shtëpi, që punohen në shkollë. Kuptohet që ka edhe mjete tjera konkretizuese, të cilat sigurisht ju kam sjellë të gjithëve, kështu që më lejoni t'ju bëjë me dije që, nëse dikush është në pozitë, po ka problem edhe me vlerat e abetares, nuk di se me çfarë niveli të opozitës vërtetë jemi duke biseduar.

Më lejoni ta ngriti çështjen e dytë. U përmend disa herë këtu që nuk janë rritur pagat e arsimtarëve, nuk di se kur i keni takuar për herë të fundit arsimtarët dhe më lejoni t'ju

them se ajo se çfarë tha Kryeministri, nuk është vetëm deri aty 47%, por 35% është mesatarja e ngritjes së pagave. Unë nuk do të flas për vlerën e ngritjes së pagës, se e dinë arsimtarët, por më lejoni t'ua shpjegoj konceptin. Jemi vendi i parë në rajon, i cili ka iniciuar licencimin e arsimtarëve që bazohet në dy kritere, në kriterin e parë të zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Ata arsimtarë të cilët profesionalisht nuk janë përgatitur, Qeveria do t'i financojë që të kthehen në Universitet, të marrin kurse tjera shtesë vetëm e vetëm që fëmijët e Kosovës ta kenë vërtet një mësim cilësor. Së dyti, jemi të interesuar që ta vlerësojmë performancën e tyre dhe unë kam marrë për obligim, jo vetëm që t'i mbështesë, që t'i mbështesë arsimtarët dhe ta bëjë arsimtarin krenar me profesionin e tij, po t'i ftoj edhe maturantët më të mirë që ta zgjedhin profesionin e mësuesit. E dini pse? Se arsimtari është shtylla e një sistemi arsimor në arsimin parauniversitar dhe ne do të bëjmë përpjekje maksimale që arsimtarin ta shndërrojmë në forcën më motorike që ka Kosova.

Tek hapësirat shkollore, dua t'ua përmendi një fakt se do të thotë e interpretoni në forma të ndryshe, po ndërtohen shkollat. E dini që në Shtime vitin e kaluar...

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni edhe 2 minuta!

...360 nxënës s'e kanë ndjekur shkollën se nuk ka pasur hapësirë dhe deri më tash këta janë paraqitur si të braktisur, këta e kanë braktisur shkollën se nuk ka pasur hapësirë për ta ndjekur shkollën. Prandaj, jo që do të ndërtojmë shkolla të reja, por në vitin 2010 edhe ju që keni fëmijë, shkolla e mesme do të shndërrohet në shkollë obligative se do të jetë perspektiva më e mirë që do t'ju ofrohet të rinjve.

Më lejoni vetëm t'ju them një fjalë të fundit. Përpjekja jonë si Qeveri do të jetë që për katër vite, shkollat fillore, shkollat e mesme dhe arsimit i lartë ka për të qenë me përmbajtje ndryshe, ka për të qenë në formë ndryshe dhe ka për të pasur mision tjetër, duke përfshirë edhe mundësinë që orarin e gjatë të kohës së komunizmit, që nxënësit i kanë tre muaj në këtë vend, e kur e kryejnë klasën e tretë, harrojnë se çka kanë mësuar në klasën e tretë dhe fillojnë të katërtën, edhe ai orar do të ndryshohet. Prandaj, ne mund të jemi këtu në pozita të ndryshme, por nuk ma merr mendja që në këtë vend mund të ketë opozitë të mirë, nëse dikush është kundër abetares dhe kundër arsimit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën...

(Reagim nga salla)

... nuk ta ka përmendur emrin. Replikë një minutë, Ardian Gjini. Mirë, 2 minuta.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Dy minuta është replika. Ne nuk jemi kundër abetares edhe ishim pajtuar shumë sikur ministri të kishte ardhur sot këtu, me gjithë respektin që e kam, të na thotë, e kemi hapur tenderin për abetare, janë paraqitur këto kompani edhe e kemi përzgjedhur këtë kompani për shkak se e ka pasur çmimin më të ulët. Kjo kishte për të qenë përgjigje e saktë e ministrit për pyetjen që e kam bërë unë. Pse kushton abetarja 15 euro? Kjo është pyetja. Unë nuk kam thënë se nuk duhet blerë abetare falas, askush nuk ka thënë. Abetarja falas është në rregull, por abetarja me fletore pune që kushtojnë ka 5 centë, se na kemi fëmijë në shkollë, kemi fëmijë në klasë të parë, e me mjete të konkretizimit kineze të 5 centëve,

të të kushtojë 15 euro, ministër, tregona qysh, unë vetëm po pyes, qysh ka kushtuar 15 euro, qysh është hapur tenderi.

Çështja e pagave. Pas luftës mësuesit kanë filluar me 130 euro edhe kanë mbërri në 40 euro më pak se sa që jua keni rritur ju dhe njëqind herë keni thënë këtu: për herë të parë pas luftës janë rritur pagat. Kallëzoni bile të drejtën, se janë 30 mijë mësues që e dinë që nuk është e vërtetë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, replikë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari akademik Mark Krasniqi, e ngriti sot çështjen e Kalimashit. Ju e dini, atje po ndërtohet një rrugë e një standardi prej më të lartit evropian apo mund të them edhe përfundimor. Edhe atje po thonë, mos e ndërto rrugën. Pse po investoni. Edhe ne këtu japim librat gratis, thoni pse, thoni pse po ndërtoni shkolla, pse po ndërtoni rrugë, pse kanalizime, pse ujësjellës. Nuk është fer kjo. Ne do të vazhdojmë me projektet tona. Ky është vizioni ynë, është projekti ynë, ky është plani ynë, ky është programi ynë.

Sa i përket edukimit, askush më mirë se zoti Gjini nuk e njeh përkushtimin tim për edukim. Ju e dini, zoti Gjini, keni qenë paksa keni ardhur pak vonë në Prishtinë, sa kam investuar unë për të shkuar një këshilltar i zotit Bajram Rexhepi, si kryeministër, pastaj për ta dërguar në edukim jashtë, një vit, një kurs. Por, kam përshtypjen se të nevojitet edhe një kurs i ri. Prandaj, shikoni gjërat më seriozisht, më mirë, më urtë, më gjakftohtë, më me relaks. Kjo është politikë, ndryshon, është demokraci. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro Ardian, veç shkurt!

ARDIAN GJINI: Kjo praktikë për të mos u përgjigjur kurrë në pyetje, saktë në pyetjen që bëhet, është duke u përsëritur që një vit e gjysmë. Sikur të kisha pritur unë të më ndihmojë dikush të shkollohem, kush e di ku kisha mbetur. Jam shkolluar vet dhe i kam borxh Mbretërisë së Bashkuar që ma ka paguar shkollimin, askush tjetër hiq.

Një çështje tjetër që duhet potencuar, prapë po e them, unë nuk po di kush e ka hapur tenderin, a Kryeministri a ministri i Arsimit, por ju pyes, qysh ka kushtuar 15 euro një abetare? Është krejt çështje e thjeshtë për t'u përgjigjur, e të mos më përmendet shkollimi mua, tregoni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Ministër, shkurt atëherë.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Unë, personalisht, nëse doni ta dini, edhe vendet tjera kanë edhe mënyra qysh bëjnë betim para deputetëve, mund ta qes dorën kudo. Unë personalisht sot e kam marrë çmimin se sa ka kushtuar abetarja. A e dini pse? Se nuk jam një ministër që interesohet për çmime në ministri. Jo, jo saktësisht zoti Gjini, kjo dallon kultura politike e juaja me kulturën politike timen. Çfarë unë mund të them, është kjo që ne e kemi pasur një abetare, e cila abetare për 20 vite ka qenë në përdorim. Kjo është abetare e re, me autor të ri, me përmbajtje të re, me mjete vizuale të reja. Kaq ka kushtuar çmimi, nëse dikujt i duket i tepërt, unë mund ta bëj edhe një njoftim të dytë. Ne e kemi ndërmend në Republikën e Kosovës, se tekstet shkollore janë shumë të dobëta, të gjithë e dinë që janë shumë të dobëta, t'i marrim tekstet e t'i përkthejmë nga vendet tjera, të cilat po ashtu mund të kushtojnë shtrenjtë, po mes një nxënësi i cili e ka një

burim të dijës, një tekst, dhe mes një çmimi, i cili këtu në Kuvend nga fryma e opozitës vendoset si formë e debatit, nuk ka merr mendja që është prioritet i dikujt.

Prandaj, ne do të vazhdojmë të investojmë në fushën e arsimit dhe t'i sigurojmë tekstet më të mira që ekzistojnë dhe do të bëjmë përpjekje që sivjet nga klasa e parë deri në klasën e 9-të, t'i sigurojmë falas, të cilat do të jenë dobi të krejt nxënësve të Kosovës, sigurisht edhe në dobi të fëmijëve tuaj që i keni në shkollë.

KRYETARI: Për replikë, Kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Për sqarim. Këtu edhe qëndron dallimi. Nëse ka ekzistuar në të kaluarën interesimi i ministrit për tenderë, në këtë Qeveri nuk ekziston, se duhet bërë dallimin, duhet bërë dallimin e përgjegjësisë politike dhe procedurën e sundimit të ligjit. Prandaj, praktikat e praktikuara, i nderuari Gjini, nuk përkojnë që të praktikuara më herët nuk përkojnë me realitetin dhe qeverisjen aktuale. Prandaj, ndajeni sundimin e ligjit, respektimin e procedurave nga politika.

KRYETARI: Ju faleminderit! Shkumbin, më vjen keq, vazhdoje diskutimin.

SKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

Me gjithë praktikat e këqija që po praktikohen në Kuvend, çka do të thotë ne nuk jemi kah flasim më për pikën e rendit të ditës, por i kemi personalizuar çështjet. Gjithçka personale është bërë në Kuvendin e Kosovës, duke filluar nga kreu i Qeverisë e deri te më i vogli i Qeverisë, duke filluar nga kryesuesi i Kuvendit më herët, ke bërë mirë që ke ardhur Kryetar, se pak i ke ndaluar, se ka qenë spektakël. Unë kisha pasur dëshirë të lidhem edhe me këtë çështjen e fundit, kur flitet për abetaren.

Nuk ka nevojë Qeveria e Kosovës t'i blejë fëmijës tim, t'ia jep falas librin, unë e kam pagën 1000 euro. Qeveria e Kosovës duhet të hartojë politika sociale dhe e ka skemën e politikave sociale, ku i di rastet sociale dhe duhet ditur kujt t'ia falë librin. Fëmijën tim, nëse Qeveria ia blen librin, ka për të ma lënë pa shkolluar, sepse e ka librin falë, e shqyen më shpejt dhe nuk mëson hiq. E ka dëmtuar rëndë tregun e punës në Kosovë edhe bizneset që janë të regjistruara në Kosovë. Me qindra librari i ka mbyllur Qeveria e Kosovës, është kundër bizneseve në Kosovë. Edhe, përfundimisht e them edhe tjetrën, në qoftë se ka nevojë për t'ua blerë Qeveria një libër fëmijëve të Kosovës, ato janë paratë e tyre, nuk janë paratë e Qeverisë. Janë paratë e secilës familje që e krijon këtë buxhet të shtetit dhe i ka paratë e veta dhe nuk merret për lëvdatë e Qeverisë kjo çështje, janë paratë e qytetarit të vet, nuk janë paratë as të miat, as të Kryeministrit, as të askujt hiq, janë paratë e vetë qytetarëve, nuk kemi nevojë të merremi me një lëvdatë dhe të përcaktojmë çmimin. Sa i paguajmë ne tatim këtij shteti, edhe të na mbushësh krejt Kuvendin libra, nuk mund të na dalësh haku, ministër!

Edhe tjera, është kështu, zoti Koci më herët tha se këtu ka deputetë që kanë ardhur për herë të parë e nuk di a kanë shqyrtuar ndonjëherë raporte buxhetore. Keni harruar, zoti kryetar i Komisionit për Buxhet, po të them në emër të profesionalizmit që jeni kryetar i Komisionit, duhet ta dini se neve jemi për herë qëparë këtu për shkak se ju nuk keni punuar mirë e është dashur të vijmë ne e herëve tjera do të vijnë edhe më shumë këtu për t'i ndryshuar tjerat sende.

Tjetra, u fol shumë për investimet në Kosovë, se po lëshohen për të mos i përsëritur kolegët, u tha edhe nga zëvendësministri i telekomunikacionit se në Rrafshin e

Dukagjinit janë investuar mbi 20 milionë mjete buxhetore në investime kapitale. Nuk di ku i kanë çuar, unë po flas për komunën e Deçanit në këtë rast. Në vitin 2008 ka qenë në projekt ndërtimi i rrugës Deçan, thuhet në projekt, kufi Mali i Zi, ne i themi Deçan – Plavë, kur është dorëzuar një projekt i ndërtimit të kësaj rruge.

Te alokimet i ka vendosur 4.594 euro, shihet një shifër në pozicionin buxhetor, ndërkaq te shpenzimet dhe zotimet zero-zero, e në këtë vit e ka hequr krejt.

Rruga Ratishë-Irznik ka kushtuar 588.880 euro. Prej krejt këtyre zotimeve, kanë mbet edhe 52 euro pa u shpenzuar.

Janë 40.000 një rrugë në Polan apo Bergj, është investim komplet i qytetarëve, e njoh mirë atë trevë, në qoftë se kanë ndihmuar, ka ndihmuar Qeveria me një shumë shumë të vogël ose e kanë kapitalin investiv të komunave, e kanë përfshirë këtë rast dhe do ta përvetësojë Qeveria.

20.000 është objekti i administratës komunale në Strelle, ai është vendlindja ime, ndihmë prej Ministrisë së Komuniteteve, që etnikisht është i pastër, Strellci është një prej fshatrave më të mëdha në Kosovë, tjetër investim Qeveria s'ka bërë aty.

Thotë 50.000 euro - rregullimi i qendrës së qytetit. Asnjë investim nuk është bërë në rregullimin e qendrës, projekt nga Ministria për komunitete. Ku kanë shkuar ato mjete nuk e di, nuk ka më investim tjetër aty.

Është për të të ardhur keq kur lëshohem në këtë, po flasim edhe tjera... Në emër të këtij raporti nuk ka kurrëgjë, as nuk e ka paraparë Ministria asnjë segment për diasporën tanë, asnjë zyre, asnjë cent, asnjë shpenzim nuk ekziston në Kosovë për qytetarin tanë që jeton jashtë vendit. Një zyrë nuk e ka hapur për t'i pritur, se a dëshirojnë ata të investojnë në Kosovë, a jo, dhe dihet se dy dekada këta qytetarë kanë qenë shpresa e vetme e ndihmës së përgjithshme që kanë ardhur për Kosovën.

Te pensionet. Dihet pensionet, nuk ka rritje. Kemi folur për vitin e kaluar.

Te arsimit, përpos 8 euro që janë kanë marrë vesh Sindikata e arsimit me Qeverinë për t'ua rritur, edhe vlera e tatimit që është zbritur për 10% te pagat, ajo është rritja e vetme buxhetore në këtë mes.

Po lëshohem komplet te Deçani edhe një herë. Gjithsej Qeveria për dy vite, edhe për këtë vit, se këto investime janë kah vazhdojnë edhe tash, është vlera buxhetore 698.228 euro, por po e fusim edhe komunitetin, po edhe participimin e komunës 30%, po i vendosim qysh është paraparë me ligj, po i bashkojmë të dyja bashkë, 429.888 euro janë investuar për dy vjet në Deçan. 5.000...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë Shkumbinit, pasi ka pritur shumë!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Do të thotë, as gjysmë milioni nuk kemi investime për dy vjet në Deçan, 5 milionë thotë Kryeministri janë investuar për një vit në komunën e Kamenicës, Dardanës, po i marrim si komuna dy motra. 8 milionë thotë në komunën e Pejës, zëvendësministri. 20 milionë në Rrafshin e Dukagjinit, t'i shohim këta parametra

inventivë se sa ka përfituar komuna e Deçanit, do të thotë as gjysmë milioni për dy vjet, me një buxhet prej 3 milionë e gjysmë, ku prej grandeve qeveritare dihet sa është shuma e tyre, ku financohet edhe arsimi, edhe shëndetësia, edhe pagat e zyrtarëve komunalë, të shohim me çfarë buxheti mund të lëvizë komuna e Deçanit në këtë rast. Keni përfituar shumë prej kësaj, zoti Kryeministër sot, po fatkeqësisht nuk ka udhëheqës atje. Se po të isha unë kryetar i kuvendit komunal, me 60.000 qytetarë ta kisha nxënë derën e Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministri, fjalën tash. Mos përmendni emra, se na mbyttë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë mendoj se ky është një debat tepër..., zoti Shkumbin, ke durim t'i dëgjosh shifrat dhe faktet. Është fat se këtu ka deputetë të të gjitha komunave të Kosovës, qofshin të pozitës qofshin të opozitës.

Unë të ftoj që të vish në inaugurimin e rrugëve të reja, të shkollave të reja, të kanalizimeve dhe të ujësjellësve edhe në komunën e Deçanit.

Kam përshtypjen dhe më vjen keq se mos je duke qëndruar më tepër në Prishtinë dhe je shkëput nga elektorati. Unë jam në kontakt me qytetarët. Unë i di ato projekte. Të ftoj të jesh pjesë e atij inaugurimi dhe atij gëzimi. Këtu ka edhe deputetë tjerë të Deçanit. Apo dikush dëshiron të flasë në emër të Rrafshit të Dukagjinit. Urdhëro, bëri krahasimet komunë për komunë, në gjithë Kosovën, nuk dëshiroj të flas Llap e Gollak, Anamoravë e Drenicë e Dukagjin. Ai është primitivizmi ynë nëse flasim ne me krahina. Për mua është një program, ai është programi i Kosovës, është programi i njëjtë i investimeve të njëjta në të gjitha territoret e Republikës së Kosovës. Natyrisht, çdo deputetë e ka obligim të prezantojë dhe të përcjellë vullnetin e elektoratit, por këtu jemi deputetë – parti, në emër të partive.

Zoti Shkumbin, e them këtu për herë të parë dhe dua ta them. Kryetari i Deçanit i ka refuzuar investimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky nuk është vullneti i qytetarëve të Kosovës. I ka refuzuar investimet në rrugë, në shkollë, në kanalizim, në ujësjellës. Është për të të ardhur keq për shkak të ngjyimeve politike të merren në qafë të gjithë ata njerëz, të gjithë ato mjete që kanë qenë dhe janë të zotuar për t'u realizuar dhe të gjitha investimet kanë ndodhur në mënyrë direkte, sepse ka refuzuar komunikimin, bashkëpunimin dhe i ka refuzuar investimet. Qeveria është e Kosovës, është e qytetarëve të të gjithë Kosovës dhe nuk ka të drejtë asnjë kryetar i komunës, i asnjë partie qoftë, të bllokojë apo të pretendojë së bllokuar investimet, megjithëse jam krenar që edhe në qytetin e Deçanit kam investuar për një vit më tepër se tri vitet e kaluara 2004 – 2007. Gjithashtu, dua të shpreh një shqetësim tjetër, që e them për herë të parë dhe dua të them, se qytetarët e Kosovës duhet ta dinë dhe ju duhet ta dini. Krejt për motivacione të ulëta edhe krahinore, dhe politike. Unë jam i bllokuar së realizuari projektin Deçan – Plavë – Guci apo Pejë – Plavë – Guci se s'mund të merren vesh. Të lutem! Ose primitivizëm krahinor ose është në baza të ulëta politike, dallimeve politike. Njëri, të lutem, njëri kryetar i komunës thotë - nuk bën nga Peja për Plavë e Guci, tjetri kryetar i komunës thotë - nuk bën nga Deçani në drejtim të Plavës dhe Gucisë dhe unë jam i bllokuar. Ngrite këtë çështje se ke obligim para njerëzve tu, para atyre njerëzve që vjen. Gjithashtu, ka pasur edhe pretendime tjera pse po investohet në Rugovë, pse po investohet në Shalë të Bajgorës, pse po investohet në Has, pse po investohet në zona të thella. Unë ju siguroj dhe garantoj se edhe në fshatin më të thellë do të ketë asfalt në Kosovë dhe shkolla dhe investime, projekte e kanalizime. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka për replikë, Shkumbin Demaliaj!

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Zoti Kryeministër,

Ne nuk folëm me emra, por folëm në raport deputet – kryeministër, por kanjonet shqiptare dhe alpet shqiptare është mirë ta njohim pak gjeografinë atje, se janë dy kanjone. Deçani me Plavën i ka shumë pak kilometra dhe është kanjon krejt tjetër me atë të Rugovës të Pejës. Prezencën time në komunën e Deçanit asnjë nga deputetët, përpos atyre që jetojnë në qytetin e vet, në Prishtinë, askush nuk i kthehet bazës më shumë dhe i njoh mirë investimet atje. Asnjë kanalizim, asnjë asfalt përpos rrugës Irzniq – Ratishtë që e ka shtruar Qeveria e Kosovës dhe ka qenë një segment i rrugës që ka mbetur përgjysmë në fshatin Strelle i Epërm, janë nja 70 metra rrugë të asfaltuara dhe ai i administratës të pushtetit lokal, që është me decentralizim që është objekt i administratës në Strelle të Epërm, 20.000 që i ka ndarë Ministria për Komunitete, që jam i befasuar pranë ndarjes, se ajo është detyrë e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk ka investime të qeverisë atje. Dihet, tash grandet shkojnë, që janë pagat edhe mëditjet dhe projektet investive, a për këtë pjesën tjetër unë nuk jam i njoftuar që nuk ka bashkëpunim komuna me Qeverinë. Kërkoj falje.

KRYETARI: Kryeministri!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari deputet,

Ju nuk jeni i vetmi deputet nga Deçani, këtu ka edhe tjerë të partive tjera dhe ritheksoj se Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë e bllokuar nga kuvendi komunal, kryetari i Kuvendit Komunal të Deçanit për të investuar në Deçan. Nuk i ka pranuar investimet, nuk ka kontaktuar me Qeverinë e Kosovës, me asnjë ministri. Ai kryetar nuk e njeh Qeverinë e Republikës së Kosovës, Qeverinë legjitime, të lutem!

Së dyti, sa i përket Alpeve, më vjen keq prej atyre qytetarëve të është sjellë ashtu. Tjetër, sa i përket Alpeve, Shkumbin, i nderuari deputet, ti e di se shumë mirë, shumë mirë i njoh edhe Bjeshkët e Rugovës, Alpet Shqiptare, edhe Bjeshkët e Junikut, edhe Sulbicën, se unë kam kaluar nëpër ato bjeshkë minimum nja 30 herë para se ta dije ti se çka po bëhet, para se ta dije ti që po vjen liria e Kosovës me gjithë kontributin e madh që ka ndodhur, që e ke dhënë edhe ti personalisht.

Prandaj, për mua është një Kosovë, por dua të them, shikoje mirë raportin, vlerësoje mirë raportin, lexoje mirë raportin, vizitoje më tepër regionin prej nga vjen dhe shih ndryshimet e iu gëzo atyre ndryshimeve, tash është pranverë, është ambient i bukur, gjelbërim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Është ora 17:00, një pauzë, 20 minuta pushim për kafe.

Drejtimin e seancës e merr zoti Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Po vazhdojmë debatin aty ku ka mbetur. Për replikë është lajmëruar Adem Grabovci, i ka 2 minuta.

ADEM GRABOVCI: Ju faleminderit, kryesues!

Unë, vetëm për informim, për një sqarim. Së pari, dua të them se e ndiej veten tepër mirë që i takoj një Kabineti qeverisës, i cili nuk punon në baza regjionale, por është një

kabinet që është i orientuar dhe gjithëpërfshirës. Investimet kanë ndodhur në tërë territorin e Kosovës. Asnjë komunë nuk është përjashtuar në këtë rast, duke përfshirë edhe komunën e Deçanit. Nuk është e vërtetë që në komunën e Deçanit janë investuar 588 mijë, por për projektin që flet deputeti Demaliaj, faza e parë e realizimit të këtij projekti, tërë ... ka qenë, vetëm për fazën e parë ka kushtuar kaq, ndërsa faza e dytë përfshin shifrën diku rreth 1 milionë euro. Është investuar në regjionin e Vokshit, është bërë një investim i vogël në fshatin e zotit Demaliaj, por duhet të kihet parasysh edhe investimet që janë bërë në mirëmbajtjen verore dhe dimërore për regjionin e Deçanit, që përfshin shifrën përafërsisht 1 milion e gjysmë euro.

Rruga për Deçan, Plavë

Ne kemi zhvilluar bisedimet edhe me Qeverinë e Malit të Zi, kemi kontakte dhe bashkëpunim shumë të mirë edhe me Shqipërinë, kemi qenë të përcaktuar që të fillojmë realizimin e këtij projekti. Është mosmarrëveshja në mes të dy komunave tona, por janë edhe problemet tjera politike, të cilat ka qenë dashur apo kemi qenë të detyruar t'i respektojmë dhe mos të fillojmë për momentin me realizimin e këtij projekti. Ndërsa, ky projekt gjithsesi është në prioritetet e Ministrisë së Transportit, gjegjësisht të Qeverisë së Kosovës dhe shpresojmë se në vitin e ardhshëm...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Grabovci! Për replikë është Gani Koci.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë kur thashë që do të duhej të dinim se si lexohen raportet, nuk e kisha për qëllim të fyej askënd dhe dua të them se nuk është tragjedi në qoftë se njeriu nuk di, tragjedia mund të jetë në qoftë se e di që nuk di dhe nuk do të mësoh diçka prej saj. Është mirë që sot ministri i Arsimit e prezantoi abetaren këtu, një abetare të re, që vërtet ajo nuk do të ishte e nevojshme vetëm për ata fillestarët në shkollë fillore, por do të ishte mirë që edhe ne të mësojmë bile abeceden sa për të lexuar raportet financiare të Qeverisë dhe të agjencioneve tjera buxhetore.

KRYESUESI: Ju faleminderit, nuk jam i sigurt, zoti Selmanaj a është për replikë apo diskutim? Je i paraqitur, a ke replikë a diskutim? Mirë, më vonë je. Replikë nuk ke ti. Hajde, po tash deri në mëngjes mbesin me replikë kundër... Mirë, zoti Demaliaj, kundër replikë 1 minutë e ke.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Unë po ndihem shumë ngushtë kur një rrugë 2 kilometra kushton mbi 1 milion euro, ura nuk ka pasur aty, rruga ka qenë krejt e trasuar, unë në bazë të kësaj çka jam bazuar, në dokumentet që janë, është 588 mijë edhe ajo shumë është shumë e madhe. Ka pasur një rrugë tjetër, rruga Deçan-Maznik, që përfshin një aks prej 6 kilometrave, ka po atë shumë për t'u rregulluar, sepse nuk ka ura që kalojnë shumë nëpër rrugët e Deçanit dhe nuk është realizuar ai projekt fare dhe është projekt ministror, ndërministror që lidhet me projektet komunale, ndërkaq rruga Irzniq-Ratishë është një rrugë krejt rurale, bukur investim, është kryer rruga. Nuk jemi kundër që rrugët të kryhen, por është puna që po trajtohen me shifra shumë të mëdha dhe ai investim aq i madh në një rrugë rurale ka mund t'i rregullojë edhe shumë projekte tjera.

Ndërkaq, me atë çka flet zoti Koci, nuk dua të merrem me atë, sepse nuk e vlen të hyjë as te dyert e Parlamentit ajo fjalë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues! Unë kam diskutuar në emër të Grupit Parlamentar, prandaj do të jem shumë i shkurtër dhe ta them me sinjeralitetin më të madh do ta ndryshoj edhe për atë çka desha të diskutoj, sepse desha pak të kyçem në raportin financiar në tërësi, por pasi kaloi në një temë ndryshe, pak menaxheriale, do të ceku vetëm për ato që kam qenë personalisht i involvuar, do me thënë në shpenzimet e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, si deputet në bashkëpunim me ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Në fshatin Strellec, të komunës së Deçanit, janë bërë këto investime: 183.000 euro shkolla e Strellcit të Ulët, aneks-shkolla e re; 143.000 euro shkolla, riparimi i shkollës në Strellcin e Epërm; 53.000 euro ka kushtuar projekti i ndërtimit, që ne e quajmë atje të komunës, ndërsa ato 24.000 euro janë dhënë direkt nga Ministria e Pushtetit Lokal, zotëri Sadri Ferati, 110.000 është shtruar rruga. Për sqarime të mëtejshme mundet zëvendësministri Adem Grabovci, i cili ka qenë direkt i kyçur këtu, ndërsa edhe 60.000 do të bëhet ambulanca, është në procedurë, donacion nga Ministria e Shëndetësisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse debati u stërzgjat, unë do ta tërheq fjalën time dhe do të pres që në pikën tjetër të rendit të ditës, e cila do të vazhdohet për Kornizën afatmesme të shpenzimeve, të flas dhe t'i them edhe për këtë disa fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Numan Baliq, e ke pasur emrin, t'u hoq prapë, unë nuk po të marrë vesh po e shtyp apo çka është puna jote. Nuk e ke këtu, pse po e shtyp atë nga dy-tri here?

NUMAN BALIQ: Xhavit, të faleminderit, se derisa m'u drejtove si ... ti je Xhavit dhe vazhdojmë si kam qenë më tutje, ishalla!

NUMAN BALIĆ: Samo želim da kažem kratko vezano za prijavu. Javio sam se za riječ još kada je govorio ministar Ahmet Shala, i da, evo čekam 5 sati ili 6 za riječ, koju mi niste dosada dali, i da obratite pažnju da se to ne dešava drugi put.

A oko ovog pitanja, naravno da sam se javio odavno i želim da govorim nekoliko riječi koje smatram opravdanim. Nažalost, diskusija se jako razvukla, svela se na personalne odnose, međustranačke rivalitete i tako dalje i dobrim djelom izgubila na svojoj virjednosti, ali uprkos tome, ja ću riječi nekoliko glavnih riječi koje smatram da su bitne i vezao bi ih uglavnom za krupne odnose koje se tiču finansijskog izvještaja za 2008. godinu.

Finansijski izvještaj za 2008. godinu nije bitan samo zbog 2008. godine, nego je bitan i izbog ove godine i narednih godina i ukupnog rada Vlade oko pitanja finansiranja, njenog odnosa prema javnim poslovima, preduzimamju javnih poslova i pokretanju pitanja od opšteg društvenog značaja. Ono što smatram važnijim jeste da tri glavna pitanja imaju vezano za dobar rad Vlade po ovom pitanju. Vlada jeste napravila značajan iskorak, Vlada jeste pokrenula niz značajnih poslova koje su spomenuli mnogi i neću ih ponavljati i na sve strane se zaista vidi da se radi i vide se rezultati rada i to niko pametan ne treba i ne može poreći, i moram da kažem da je to možda više proizvod vještosti i umijeća Vlade ka iskoristi postojeće okolnosti koje je ona jeste bolje iskoristila od prethodnih Vlada. Dakle, činjenica je da je postojeća Vlada bolje

iskoristila mogućnosti koje je imala od prethodnih vlada uprkos, naravno onih fakata koji stoje da je preniyet jedan deo budžeta i drugih fakata koji su spomenuti. Ali, krupne stvari na koju bi vlada trebala da poradi, da bude historijska vlada, nažalost još nisu uradjene. Vlada je dakle napravila iskorak, ali ne takav da bi se mogla nazvati istorijskom vladom. I mi nažalost na Kosovu još uvek čekamo tu istorijsku vladu koja će napraviti istorijske zaokrete. Da bi to uradila, ona treba da napuni kesu, državnu kesu, blagajnu, Budžet Koksova, državnu kasu, narodnu kasu, kako god hoćete.

Budžet u cijelosti se mora u najmanju ruku udvostručiti, jer on i dalje zaostaje za budžetom najbližih okolnih zemalja, to smo pominjali mnogo puta i neću više da spominjem da se radi eto o jednoj mali Crnoj Gori ili Makedoniji koje imaju veći budžet nego Kosovo. Dakle, prva stvar je da se mora udvostručiti budžet.

Druga stvar je vezano za prihode koje imamo. I dalje imamo najveći broj prihoda, najviše para dolazi od carina, ali uopšte nije iskorišćena mogućnost dobijanja novca iz poreske administracije, iz oblasti poreza, taksa i drugih dažbina, te mogućnosti nisu iskorišćene. 200 miliona eura, koliko ovdje stoje, odnosno 20 i nešto posto nije dovoljno od poreza i taksa. Vlada mora da čini dodatni napor da se taj broj, da se količina tog novca najmanje udvostruči. Slično je i sa opštinskim prihodima, koji naravno moraju biti mnogo veći. Zašto? Zato što postoji mnogo nelegalnih tokova novca. Umjesto da novci idu tamo gdje treba legalnim tokovima, putem ubiranja poreza, preske administracije, opštinskih prihoda, nažalost novac završava u paralelnim tokovima, u ilegalnim tokovima, sivoj ekonomiji, švercu, organizovanom kriminalu i tako dalje, svim onim stvarima koje jesu prisutne u regiji i koje ne može niko da porekne, i koje na kraju krajeva imputiraju najvažnije finansijske, evropske i međunarodne organizacije.

Druga stvar koju želim da istaknem jeste kapitalne investicije, naravno da je napravljen značajan napredak. Medjutim, ogroman broj, najveća količina novca je uložena u kapitalne investicije. Veoma malo je uloženo u plate, u penzije i socijalna davanja. Taj se odnos mora promijeniti. Mora se Vlada, i ja sam siguran i sada to kažem, Vlada ako želi uspješno završiti ne 2008.godinu, nego ovaj mandat, mora najmanje udvostručiti plate. Ne pomaže opravdanje. Plate za policiju, za sudove, za nastavno osoblje, za zdravstvo, za socijalne službe, za penzione službe, za djecu palih boraca, za šehide, jer ima razlike između šehida i boraca, nisu se svi borili na isti način, moraju se mnogo uvećati...

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! E kreve. Për fjalë është lajmëruar deputeti Gani Buçinca.

(Numan Baliq, kërkon vazhdimin e fjalës)

... Jo , jo, e ke kryer, 5 minuta. Gani Buçinca e ka fjalën!

GANI BUÇINCA: I nderuari, zoti kryesues,
Të nderuar kolegë deputetë,
Vërtet do të mundohem të jem shumë i shkurtër. Mirëpo, sot si deputet i Kuvendit të Kosovës jam gjendur në mes dy motiveve pozitive. Në vazhden e analizave, psiko-analizave të mia, unë kisha pasur dëshirë të jashtëzakonshme që sot të solidarizohem me opozitën. Duke e parë gjendjen e saj emocionale, duke e parë frustrimin e saj të vërtetë dhe duke qenë vetë pjesë e opozitës 30 vjet, unë do të dëshiroja që të solidarizohem me opozitën. Mirëpo, duke qenë dhe si motivi tjetër pozitiv që Qeveria aktuale, përkatësisht koalicioni qeverisës duhet të punojë për qytetarët e Kosovës, për interesat e tyre, unë

nuk kam si mos të solidarizohem me Qeverinë aktuale dhe koalicionin qeverisës. Kështu që, më vjen keq që nuk do të mund të jem në anën e asaj pjese të opozitës e cila dëshpërimin e vet e paraqet si alternativë politike, e cila nihilizmin e vet e paraqet si alternativë politike në Kosovë. Mua më vjen shumë keq.

Unë, mund t'ju them kolegë të nderuar, se teoria politike ka mjaft studime të cilat i identifikon tipin, llojin dhe funksionin e opozitës. Ne kemi të bëjmë në Kosovë me një opozitë, një pjesë të saj, të thuhet janë edhe ... personal me një opozitë tipike komuniste, e cila nga pasioni për pushtet nuk sheh asgjë të mirë gjatë periudhës të cilën po e trajtojmë të qeverisjes. Unë mund t'ju them këtyre kolegëve, se disa prej tyre thanë se Qeveria duhet ta ndërrojë strategjinë dhe vizionin e vet politik. Unë ju them në rast se dëshirojnë të vijnë në pushtet, ata duhet ta ndërrojnë edhe vizionin dhe strategjinë për të ardhur në pushtet në Kosovë. Faktet janë shumë kokëforta dhe nuk mund t'i mohojë askush. Në Kosovë janë ndërtuar rrugë, janë ndërtuar spitale e shkolla dhe ajo çka është më pozitive për vetë stabilitetin politik të Kosovës, është se koalicioni qeverisës po funksionon shumë bukur dhe, të them të drejtën, po funksionon shkëlqyeshëm. Unë e kuptoj një pjesë të madhe të opozitës që janë të shqetësuar nga kjo gjendje se po e shohin se pushteti po ju largohet çdo ditë e më shumë, përderisa kjo Qeveri ka manifestuar këtë vullnet dhe këtë vizion politik për ta ndryshuar Kosovën.

Unë ju them me sinqeritetin më të madh se përkundër faktit që dëshiroj të jem solidar me ju, nuk mundem dhe do të jem shumë i shkurtër. E përgëzoj Qeverinë të vazhdojë me këtë ngulm, të punojë me këtë përkushtim, koalicionin qeverisës dhe të ketë parasysh ato vërejtje të arsyeshme të një pjese të opozitës ku unë jam solidar me ta, se duhet t'i kushtojë një vëmendje më të madhe gjendjes sociale në Kosovë. T'i ndryshojë, t'i rishikojë politikatat sociale. Në këtë drejtim, unë jam solidar dhe falënderoj opozitën që ia tërheq vëmendjen Qeverisë aktuale, që gjatë rishikimit të buxhetit të ketë kujdes dhe të bëjë përpjekje që së paku ky qytetar i ndershëm i Kosovës, i cili ka dhënë shumë për këtë gjendje, të ketë edhe një përmirësim në xhepin e tij personal. Kurse sa i përket programit qeverisës dhe vizionit, që u tha këtu disa herë, mua më vjen keq, për të njëjtin vizion dhe program qeverisës e pati edhe Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Obama, i cili tha: ne do të ndërtojmë rrugë, do të ndërtojmë spitale, do të ndërtojmë shkolla dhe mua më vjen keq se ky vizion i qytetarëve të Kosovës po përputhet edhe me vizionin e njeriut të parë të Botës dhe Qeverisë së tij për të nxjerrë Amerikën nga kriza, kështu që nuk mund të mos i dëshiroj sukses koalicionit aktual qeverisës dhe duke ia dhënë një porosi dashamirëse, që nuk ka Qeveri në botë që punon aq mirë sa që nuk mund të punojë edhe më mirë, mos të kalojnë në vetëkënaqësi dhe ministrat duhet të jenë të gatshëm të dëgjojnë edhe ato gjëra që nuk kanë dëshirë t'i dëgjojnë si ministra. Unë mund them se këtu sot u zhvillua një debat inxhitë politik dhe këtu ndodhi sot demokracia për arsye se ligjërimi politik me demokraci zhvillohet nëpërmes tensioneve...

(duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi dy të lajmëruar për replikë. Deputeti Gani Geci, 2 minuta i ka replikë. Jo, nëse s'je për replikë, atëherë prite radhën. Okej. Zoti Gashi, a je për replikë apo e do fjalën. A ke diskutua njëherë? Nëse ke diskutuar, replikë 2 minuta. Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, është e pashmangshme ndonjëherë pa u provokuar edhe prej diskutimeve të palës tjetër dhe në këtë rast nuk u ndjeva shumë mirë si deputet i Kuvendit të Kosovës me kualifikimet që bën zoti Buçinca për të gjithë, pa bë dallime këtu. Unë e kuptoj se të gjithë nuk e kanë nivelin e tij të bëjnë psiko-analiza, po ne nuk jemi këtu për të bë psiko-analiza, po sot kishim në rend të ditës një raport për të cilën u diskutua këtu, dikush me më shumë kompetencë profesionalizëm, dikush me më pak, por megjithatë po thuaj secili, ndoshta më së pakti ata që zoti Buçinca i mori në mbrojtje, folën lidhur me raportin, promovuan, sepse ne ju dhamë shpeshherë rast, promovuan edhe atë që s'e kanë bërë, e promovuan se e kanë bërë dhe sigurisht që është mirë për ta që arritën, sepse ne ua mundësuam ndonjëherë, me mospërgatitjen tonë si opozitë. Por, nuk ka qenë paraqitja, performanca e ekspozitës e atij niveli sa që të alegorizojë zoti Buçinca në mënyrën si e bëri. Dhe, natyrisht, një vërejtje për ju, zoti kryesues, që asnjë fjalë nuk e foli lidhur me raportin dhe ju e latë që të përfundojë 5 minutëshin e tij, pa i ndërhyrë që t'ia tërhiqni vërejtjen që të flasë konkretisht për raportin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ky është debat për buxhetin, gjithkush ka folur çka ka dashur. Njeriu është ngushtë me ju, se kur ua ndërpreni fjalën, bëni ankesa, kur e respekton Rregulloren, prapë bëni ankesa, nuk di. Unë, nuk e kam ndërmend t'ia ndërpres askujt 5-minutëshin që e ka. Kundër replikë, Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Unë kam respekt për profesorin e nderuar Ibrahim Gashi dhe besoj që ai e di, më mirë se ndoshta të gjithë ne që jemi këtu, se teoria politike identifikon opozitën në bazë të mënyrës se si ligjëron politikisht dhe si vepron politikisht. Unë nuk jam absolutisht as në sferë e psiko-analizës, po në sferën e teorisë politike, gjë që jam i bindur, nëse do ia citoj edhe literaturën, të cilin ky e njeh shumë mirë. Kaq. Unë kam respekt për kolegun.

KRYESUESI: Faleminderit, fjalën e ka deputeti Ibrahim Selmanaj.

IBRAHIM SELMANAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të them të drejtën, nuk e pata në plan të paraqitem, por Kryeministri më ka shtyrë që me drejtë të flas diçka për Deçanin, sikur ka mbetur Prishtina e Deçani, e nuk ka mbetur asnjë qytet tjetër. Po e humbim gjithë ditën duke diskutua për raportin vjetor financiar dhe qëllimi është se si janë shpenzuar mjetet, si janë shpenzuar paratë, si janë menaxhuar, ku janë defektet ose sa munden deputetët e Parlamentit të kontribuojnë që në një të ardhme mos të kenë gabime të tilla, sepse ka, janë evidente dhe u panë.

Më së paku patëm nevojë ta dimë historinë ose gjeografinë se ku janë Bjeshkët e Nemuna, ku janë Alpet shqiptare, se Kosova është sa grima, Kosova është vend i vogël. Më erdhi keq edhe është për keqardhje që të thuhet se kryetari i komunës së Deçanit ka bojkotuar Qeverinë e Kosovës, e vërteta është krejt ndryshe. Është një kontinuitet i pushtetit që në vazhdimësi, ekspertë të cilët janë në komunë, pavarësisht bindjeve politike, në vazhdimësi kanë sjellë projekte në Qeverinë e Kosovës dhe mund t'ju them me përgjegjësi të plotë se janë 10 projekte të detajizuara në Ministrinë e Postë-Telekomunikacionit.

Kryetari i komunës së Deçanit në të gjitha takimet, përjashtuar një takim që ka ftua Kryeministri me kryetarët e komunave, kryetari i komunës së Deçanit ka qenë në takime me Kryeministrin. Ka qenë në tri takime me zëvendëskryeministrin e Kosovës, në prezencën e zëvendëskryeministrit të Kosovës është takuar me ministrin e Financave.

Kryetari i komunës së Deçanit ka bërë një kërkesë për kanalizim të qytetit të Deçanit dhe iu ka drejtuar ministrit të Mjedisit dhe personalisht është takuar në zyrën e tij. Ka pasur mysafir ministrin e Pushtetit Lokal dhe të njëjtën kohë e ka pritur të shtunën ministrin e Postë-Telekomunikacionit dhe zëvendësministrin në inaugurimin e rrugës së famshme Tratishtë.

Jam i obliguar, sepse u fol për të parin e qytetit të komunës sonë dhe janë 65 mijë banorë që e shohin me keqardhje këtë diskutim dhe këtë debat. E drejta është se fjala publike është fjalë publike, e sidomos nga njerëz përgjegjës dikush duhet shkuar në burg për këto që folën. Jemi në Parlamentin e Kosovës, askush nuk ka të drejtë ta thotë atë që nuk është e vërtetë.

Kam drejt të them edhe një diçka tjetër, se nuk është kjo gjendja që u prezantua nga Kryeministri i Kosovës. Raportet e Aleancës me Partinë Demokratike të Kosovës në Deçan janë shumë të afërta dhe që nga pas lufta jemi në koalicion dhe nuk kemi mosmarrëveshje. Kjo nuk duhet të transmetohet te qytetarët si bindje e vet personale e njeriut të parë të ekzekutivit dhe këtë duhet ta dijë secili nga qytetarët e Kosovës. Por, duhet ditur edhe një fakt. Qyteti i Deçanit nuk ka kanalizim, as një metër nuk është futur e ujësjellësit në këtë vit. Këto janë të vërteta, por duhet t'i sanojmë këto defekte dhe duhet të kem kujdes te fjala e lirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! fjalën për replikë Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Shiko, prapë u detyrova ta marrë fjalën, se me të vërtetë rreth Deçanit u diskutua pak tepër, çka është për t'u shqetësuar.

Unë po them se vetë, me kërkesën e Kryeministrit të Kosovës, jam detyruar që të shkoj së bashku me ekip në komunë të Deçanit, kam kontaktua me kryetarin e komunës dhe kam kërkuar që me vlerë prej 3 milionë deri 3 milionë e gjysmë euro janë mjetet e dedikuara për infrastrukturën rrugore në Deçan. Mua nga kryetari i komunës së Deçanit më është kërkuar që të investoj në Drumin e telit, një rrugë e vjetër, kostoja e të cilës kalon mbi 20 milionë euro. Mundësitë tona financiare për të gjithë janë të qarta se ka qenë e pamundur. Kjo është e vërteta rreth këtij projekti.

Tjetër, është një përfitim i komunës së Deçanit edhe për kanalizim, që i është dhënë premtimi nga zëvendëskryeministri dhe janë zhvilluar procedurat tenderuese, besoj se janë në përfundim e sipër.

Prandaj, nuk dëshiroj që të spekulohet në këtë drejtim se Qeveria e Kosovës e ka përjashtuar ndonjë pjesë të territorit të Kosovës nga investimi. E thashë më parë, po e ritheksoj. E ndiej veten dhe më bën vërtet të jem shumë i lumtur që i takoj një Kabineti qeverisës, i cili është në shërbim të qytetarëve të vendit. Në komunën e Deçanit, e them me përgjegjësi, kam qenë më tepër se sa shumë deputetë që janë të po asaj komune.

Për realizimin e projektit të Ratishit, është e pavërtetë se nuk ka ...

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër replikë Ibrahim Selamanaj.

IBRAHIM SELMANI: Faleminderit, kryesues!

Shumë sinqerisht po them, shumë pak është kah më bën përshtypje ajo sa është investuar dhe çka është investuar. Dilemën duhet ta heqim. Përderisa zëvendësministri e ka

vizituar kryetarin e komunës së Deçanit, në çka do të bazohemi ne tash, a e pranon kryetari i komunës së Deçanit Qeverinë e Kosovës. Këtu tash ka ardhur dilema, te ky element. Absolutisht është shumë pak për mua, më bën përshtypje a është një urë a janë dy ura. Këtu është krejt tema ndryshe tash dhe po del e kundërta e fjalës së Kryeministrit. Këtu është problemi për mua.

KRYESUESI: Adem, nëse vazhdoni kështu, tepër është. Një minutë Adem Grabovcit.

ADEM GRABOVCI: Shiko, tërësia territoriale e Kosovës është një. Kemi një kryeministër dhe nuk ka askush që mund të dalë mbi autoritetin e tij, këtë duhet ta kemi të qartë të gjithë. Është çështje tjetër gatishmëria e bashkëpunimit të pushtetit lokal me pushtetin qendror. Unë e them me përgjegjësi të gjithanshme, se përjashtim në këtë drejtim ka bërë komuna e Deçanit, e cila nuk ka tregua gatishmëri të bashkëpunimit. Pse nuk them, nuk e ngrejë këtë problem për komunën e Gjakovës dhe komunën e Pejës, të cilat që të dy këto komuna i takojnë të njëjtit subjekt politik, nëse lind nga përkatësia e subjektit politik. Përkundrazi, këto dy komuna kanë qenë shumë bashkëpunuese dhe kanë qenë shumë përfituese nga investimet që ka bërë Qeveri e vendit. Po të kishte ndjekur këtë politikë edhe komuna e Deçanit...

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të them sinjerisht, nuk kam pasur ndërmend të marrë fjalën në këtë debat, por kur dikush e akuzon Qeverinë ose e akuzon opozitën për komuniste, unë nuk kam qare pa i thënë disa fjalë.

Po flas me fakte. Ne e dimë mirë kush është marksist dhe kush është leninist, po e dimë mirë edhe kush është titist këtu. Prandaj, nuk kemi çka të flasim në këtë drejtim, sepse e dinë mirë, të gjithë ne e dimë. Nëse doni t'i përmend me emra atyre që neve ua kemi thanë - poshtë Marksi, ua përmendi, po s'po dua.

Po dua të flas tash për temën që jemi duke e biseduar, nuk e pata ndërmend, por u ndërldha shkurt.

Të nderuar deputetë,

Qeveritë e kaluara ose flasim për buxhetin e vitit 2003, i ka pasur 600 milionë euro. Nëse në buxhetin e kaluar dikush ka vjedhur njërin nga këta ujë, ka qenë 50%. Nëse në Qeverinë e tashme dikush nga 200 i vjedh 20, është hiq më pak se 10%, po 20 herë më shumë se ai tjetri. Dhe, kjo është ajo që do të flasim për buxhetin. Ne kemi sy, ju lutem! Nëse keni ju sy, dilni te elektorati, dilni te popullata, se truprojat e ministrave dhe të Kryeministrit, fëmijët e tyre vozitin Q7, që kushton hiq më pak se 70 mijë euro. Dhe, nëse i llogaritim kah i kanë marrë mjetet, po ju them sinjerisht që në fshatrat e tyre as dhitë s'kanë çka hanë. Dhe tash, ky është realiteti, ky është realiteti i Qeverisë, edhe i të kaluarës, edhe i tanishmes. Nëse ne i hymë dhe duhet të hymë që në Ligjin për prejardhjen e pasurisë, të kthehemi në dhjetëvjeçarin e fundit dhe secili të tregojë cent për cent ku e ka marrë një euro dhe ku e ka investuar atë euro dhe kah e ka bërë këtë pasuri që e ka tash 10 vjet ...

Prandaj, nëse flasim për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës, ai duhet të shpenzohen racionalisht në të gjitha qytetet e Kosovës, sepse të gjitha qytetet e Kosovës janë të

Kosovës dhe Kryeministri i Republikës së Kosovës është i krejt Kosovës. Ne duhet të jemi parimor, duhet të jemi parimor sepse qytetarët kërkojnë prej nesh të jemi parimor. Nuk kërkojnë qytetarët prej nesh që ne të tregojmë në Kuvendin e Kosovës se Qeveria po sillet si komuniste, se unë jam ai që bëj psiko-analiza të të gjithë deputetëve këtu dhe unë jam ai mjeku që e di se cili deputet vunë prej syri e i cili deputet vunë prej këmbë dhe, në fakt, ai vetë si person nuk di as çka bën, nuk di as çka flet në foltoren e Kuvendit të Kosovës, edhe më herët, edhe tash dhe gjithmonë nxit replika të panevojshme në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi deputetë këtu që janë komunistë në opozitë, po kemi deputetë këtu që kanë qenë titistë dhe kemi deputetë këtu që kanë qenë marksistë-leninistë dhe fotografinë e Evner Hoxhës e kanë hala në shtëpinë e tyre.

Prandaj, ju lutem, ne jemi duke biseduar për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe nuk jemi duke u marrë me analiza dhe ata që merren me analiza, le të shkojnë te mjeku, le t'i bëjnë analizat për veti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Për fjalë është paraqitur deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, koleg, zoti Haliti, kryesues!

Është mirë që më në fund jemi në fund në këtë diskutim mjaft të gjatë e të gjerë, i cili ka dalë moti nga motivi themelor i diskutimit, po kështu e ka kur deputetët bëjnë, pak a shumë dëshirojnë që ta derivojnë edhe në pyetje tjera.

Unë, megjithatë, kam dëgjuar shumë sugjerime që janë substanciale, pa marrë parasysh që ato janë mbytur nganjëherë në replika të trefishuara. Unë do të shtroja, sepse e kemi ministrin këtu, përgjegjës in e resorit, vetëm në formë pyetjesh. Meqë kjo është filozofia e harxhimit të parave publike në zhvillim në një vit tjetër, sepse këtu në diskutim e sipër është biseduar edhe në mënyrë futuriste edhe kah e ardhshmja e afërt, e tashmja, e ardhshmja shumë e largët, por ne kemi të bëjmë me një evidencë, a mendojnë këta që do ta vazhdojnë, siç tha Kryeministri, me konsekuencë atë që ai e quan si vizion, unë do ta quaja politikë konkrete, sepse është një kohë e kaluar, këtë formë të harxhimit të mjeteve, që konsiston në ndërtime superstruktura, në ndërtime rrugësh, u tha, dhe është e vërtetë që harxhimet kryesore kanë shkuar edhe atje dhe në shkolla, pak a shumë, këta dy sektorë që kapin dy ministri, apo kur mendohet për zhvillimin social, që pati reflektim te dy diskutues, më duket i fundit ishte Baliqi, që të provohet që investimet e parave të mbledhura publike të shkojnë të provohet kah ato degë dhe resorë ku prodhohet dhe ku krijohet vendi i punës, kjo është pyetja e parë.

Dhe, pyetja e dytë, për të mos u regjionalizuar, po është e pamundshme të mos ndodh kjo, sa para i ka dhënë kjo Qeveri për komunën e Podujevës dhe sa asfalt i ka shtruar, sa metra apo sa kilometra edhe vjet, edhe sa i ka planifikuar sivjet, kjo është pyetja ime e dytë. Faleminderit, shumë. Suksese!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të jem i shkurtër, por konsideroj se qytetarët e Kosovës nuk ndihmohen duke mos i pranuar projektet që tanimë kanë përfunduar në Kosovë. Sot nuk e kemi mundësinë as t'i rrisim pagat e pensionistëve, as të policëve të Kosovës, as të Forcës së Sigurisë, por sot jemi duke shqyrtuar një raport financiar, për të cilin duhet mbikëqyrur se si janë harxhuar mjetet e buxhetit të Kosovës.

Dhe, unë po i ndaj vetëm tre zëra të buxhetit dhe ta bëjmë një krahasim. Me këta tre zëra të buxhetit, nëse i krahasojmë me vitin 2007, por edhe me vitet e tjera 2005, 2004, shumë lehtë mund të shihet se kush ka menaxhuar më mirë. Shumë lehtë mund të konstatohet se kush ka vjedhur dhe shumë lehtë mund të konstatohet se kush po punon që në Kosovë të ketë perspektivë, të ketë infrastrukturë, të ketë shkolla, të ketë gjithçka që është në interes të qytetarëve.

Më befason fakti që nuk po shihet një fakt. 159 milionë euro kanë qenë investime kapitale në vitin 2007. Në vitin 2008 janë 351 milionë investime kapitale. Është ndryshim shumë i madh, 100%, dhe gjatë gjithë kohës është diskutuar se taksapaguesit, taksapaguesit kanë paguar edhe në vitin 2002, edhe në vitin 2003, edhe në vitin 2004, do të paguajnë edhe në vitin 2020. Çështja është si janë menaxhuar mjetet. Në këtë Qeveri, së paku, nuk janë paguar me miliona euro pa e bërë asnjë ditë pune, asnjë kompanie. Në këtë Qeveri nuk po paguhen njerëz nga 5000 euro t'i marrin që rrinë në shtëpi për shkak të largimeve politike që janë bërë. Është mirë që ne si deputetë, nëse duam ta mbikëqyrim Qeverinë, është mirë ta mbikëqyrim jo duke ngritur çështje a kanë nevojë nxënësit për libra. Nëse nuk ka nevojë një deputet, të gjithë fëmijët në Kosovë kanë nevojë për libra dhe duhet bërë pyetje pse nuk është zbatuar Ligji në vitin 2002, t'ju blihen librat, e mos të pengojnë pse blihen librat në vitin 2009. Unë nuk po di si po doni t'i fitoni votat kur tërë kohën keni kërkuar dhe keni vepruar në kundërshtim me interesat e qytetarëve në këto debate, po them sinqerisht. Askush nuk po e përmend faktin pse të gjitha komunat e Kosovës kanë të hyra më shumë 50%, çka ka ndryshuar, po ata punëtorë janë të komunës, por është një menaxhim shumë më i mirë dhe ky është fakti. Pse të rriten 50%, po ata inspektorë financiarë janë dhe kjo ndikon pozitivisht për qytetarët.

Po deklarojeni se nuk ka vende të punës. Nuk mund të mos ketë vende të punës kur janë 170 projekte ose 1700 projekte ose kur harxhohen të gjitha shpenzimet kapitale. Unë po e bëj vetëm një dallim. Nëse në vitin 2004 të gjitha ministrinë e Qeverisë së Kosovës i kanë pasur shpenzimet kapitale më së shumti deri në 50% të harxhuara, ka pasur ministri që ka pasur 10%. Tani e kemi një fakt shumë publik, shpenzimet kapitale janë shfrytëzuar 80%, 85%, bile, bile mua po më befason fakti që dikush nga deputetët e ngriti çështjen pse në gjashtëmujorin e parë është shfrytëzuar buxheti 20%. T'i mësojmë pak procedurat. Buxheti fillon të shfrytëzohet në Kosovë muajin e tretë dhe investimet kapitale, shpenzimet kapitale kanë procedurë dhe ato asnjëherë nuk po përfundojnë brenda afatit të paraparë ligjor. Janë edhe shumë çështje tjera, hyrje, pse nuk ka raporti hyrje. Po ndaluni te përmbajtja, se nuk ka nevojë të ketë hyrje. Ne po na intereson si janë zhvilluar procedurat. U përmend edhe një fakt se tenderët si janë shfrytëzuar dhe u përmend edhe OSHP-ja. Mua nuk po më intereson për çështje tjera, por po më intereson në raportin që e kemi pasur të OSHP-së, 85% e tenderëve publikë kanë qenë të hapura, kanë qenë të hapura, është procedura më demokratike që e kërkon Ligji i prokurimit. Ne nuk jemi avokatë...

(ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit është Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,
Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Vërtet, disa herë e kam potencuar që niveli i komunikimit parlamentar, niveli dhe cilësia e debateve që po e zhvillojmë në organin më të lartë legjislativ të vendit është për shqetësim dhe këtu dikush e ka përgjegjësinë se kahet e debatit, po edhe të polemikave, po edhe të parashtrimt të çështjeve në këtë Parlament janë zhgënjyese për ata njerëz, për qytetarët e vendit që na kanë sjellë këtu. Sot është vërejtur një logjikë e viteve të 33-ta të shekullit të kaluar, në kohën e Al Kapones. Mos harroni që një nga prioritetet e kësaj qeverie që ka të bëjë edhe me raportin vjetor të shpenzimit të buxhetit është edhe implementimi i statusit. Vallë, po e bëj një pyetje tani si qytetar: në 30% të territorit të Republikës së Kosovës Kushtetuta nuk pyetet fare dhe është vetëm term juridik, s'bëhet fjalë fare për vënien dorë të institucioneve të Republikës së Kosovës atje. Por, a kemi nevojë që ta copëtojmë Kosovën edhe në një 4-5 regjione, si është polemizuar sot këtu kur kemi diskutuar për një temë të shpenzimit të parasë publike, të taksapaguesve të varfër të Kosovës për vitin 2008. Ju lutem, Parlamenti i Republikës së Kosovës ka nevojë emergjente për ndryshimin e logjikës së komunikimit parlamentar, pa marrë parasysh a jemi pozitë apo jemi opozitë.

Dikush del flet këtu, që është zyrtar i lartë institucional, një nga krerët e shtetit në kohën e ardhshme, mënyra dëshirore se do të bëhet kjo a do të bëhet kjo, kurse edhe disa deputetë tjerë i japin një pike të caktuar të rendit të ditës, që është e limituar korniza, për çka janë deputetët të thirrur të flasin për atë debat të cilin e ka miratuar Qeveria, ka ardhur përmes procedurave në Parlament. Dhe, logjika e tillë e tipave të debatit të shekullit të kaluar dhe të logjikës së fiseve e dëmton demokracinë, e dëmton shtetndërtimin dhe e fundos, e ngulfat logjikën moderne dhe qytetare të ndërtimit të një shteti normal dhe demokratik.

Tani po flas jo si deputet i opozitës, por thjesht dua të shpreh indinjatën time për uljen e nivelit të debatit, për uljen e vlerës të neve si deputetë dhe si pjesëtarë të organit më të lartë legjislativ të vendit.

Se çka ka bërë Qeveria, investimet kapitale, prioritetet dhe ato, është dëshmi cilësia e jetës në Kosovë. Mos të flasim për elemente tjera. Nuk dua të hyj me qëllim të përmendi shifra këtu, sepse për dikë shifrat ishin ashtu, kurse për dikë tjetër kështu dhe vërtet u banalizua çdo gjë.

Unë kërkoj nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nga Qeveria, e posaçërisht nga mazhoranca që ta ruajnë dinjitetin e këtij Kuvendi, sepse kështu qysh është filluar dhe qysh faktikisht është kah vazhdon një logjikë e tillë e punës së Kuvendit, po i zhgënjëm qytetarët. Na kanë dalë në vota 42%, rrezikojmë t'i humbim edhe atë 42%.

Unë dua t'i dëshiroj këtij parlamenti një punë normale, logjike, konform Kushtetutës, konform Rregullores së Punës të Kuvendit dhe të rendit të ditës dhe do të jenë votuesit ata që do ta cilësojnë edhe punën e këtij koalicioni qeverisës, po edhe angazhimet e opozitës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Ne nuk mund ta bëjmë të kurdisur demokracinë. Demokracia, do të thotë, është edhe pozita, edhe opozita. Njerëzit kanë të drejtë të shfaqin mendimet e tyre, kanë të drejtë të kërkojnë prej komunave e tyre, dikush ndoshta ka të drejtë të kërkojë edhe për fshatin e tyre. Natyrisht, Qeveria e shikon interesin e të gjithë qytetarëve dhe shpërndarjen e mjeteve financiare në interes të gjithë qytetarëve në çdo komunë, e ka obligim edhe kushtetuese edhe me ligje. Prandaj, ne nuk mund ta detyrojmë një deputet ta thotë një fjalë a mos ta thotë. Konsideroj se deri më tani

Kuvendi i Kosovës realisht ka bërë një debat, ndoshta ne do të dëshironim një debat në një nivel tjetër intelektual dhe politik, por mendoj që nuk është për t'u fyer ky debat që është zhvilluar sot, edhe pse ka pasur dallime pozitive - opozitive dhe për mua kjo është krejt e natyrshme. Kështu është zhvilluar dhe kështu zhvillohet demokracia, jo vetëm në Kuvendin tonë, por në të gjitha kuvendet, do të thotë në të gjitha rregullimet ku parlamenti e ka rolin e vet që e ka, pra edhe i yni. Natyrisht, unë e kuptoj që edhe në vendet që ka një traditë të madhe, demokracia dhe debatet dhe kundërshtitë në parlament kanë pak aktrizëm, por jeta është, ndoshta vetë jeta ka pak diçka nga teatri. Fjalën e ka kërkuar Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI: Zoti Kryetar!

Të nderuar ministra, deputetë,

Mendoj që kemi zhvilluar një debat të frytshëm në interes të zhvillimit të demokracisë në Kosovë, në interes edhe të përplasjeve pozitive – opozitive, që janë krejt normale, në interes të përkujtimit për Qeverinë, për projektet që duhet t'i kryejë, ashtu siç edhe Qeveria bëri shumë mirë që na sqaroi për të gjitha të arriturat e derisotme dhe projektet që i ka për të ardhmen e zhvillimit të Kosovës.

Dalja nga tema bosht e rendit të ditës, edhe ajo i ka të mirat e veta, por unë kësaj radhe me qenë se janë ezauruar të gjitha bisedat, të gjitha temat për segmente të veçanta të shpenzimeve të buxhetit, kisha që për t'i ngrehur dy çështje. Meqenëse u tha që Qeveria për zhvillimin e ardhshëm duhet të parashih edhe vende të reja pune, do të thosha që Kosova ka resurse turistike malore dhe do të kërkoja për të ardhmen që Qeveria t'i ketë parasysh këto, veçanërisht turizmin malor me zonat e bukura, do t'i quaja, të Kosovës, të cilat krahasuar, nuk po i krahasoj as me Austrinë, as me Zvicrën, sepse kapaciteti ynë është minor krahasuar me ato, por rrugica nëpërmes të cilave mund të lëvizin njerëzit mund të bëjmë.

Dhe, si çështje të dytë, desha që t'ju përkujtoj që është dhjetëvjetori i ndërhyrjes ose i çlirimit të Kosovës dhe kisha kërkuar që sot t'i japim një rekomandim Kuvendit Komunal të Prishtinës që ta ndajë një shesh në qytetin e Prishtinës për ta bërë një përmendore kushtuar forcave të NATO-s dhe ndërhyrjes së NATO-s me rastin e dhjetëvjetorit të ndërhyrjes. Të njëjtën gjë e kisha kërkuar nga Qeveria e Kosovës që ta mbështesë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konsideroj se debati është shteruar nga ana e deputetëve. Radha është e ministrit për Ekonomi e Financa, zotit Ahmet Shala. Mundësisht, rrumbullakojë sa më...

AHMET SHALA: I nderuari zoti Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeverisës, të Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Më vjen keq që sot nuk kam pasur kohë që tërë ditën të jem këtu bashkë me ju për ta dëgjuar secilin veç e veç, për hir të agjendës që kishim me Komisionin Evropian, por jam përpjekur që në kohën maksimale t'ia kushtoj një vëmendje përcjelljes të debatit, nëse mund të them, për Raportin financiar të Buxhetit të vitit 2008, buxhet të cilin ju e keni aprovuar këtu dhe i cili ka shpreh strukturë dhe politikat e Qeverisë së Kosovës ndaj planeve të veta zhvillimore. Pra, është buxheti që ju e keni aprovuar, bashkë me neve, natyrisht, dhe i cili reflekton mundësitë tona financiare dhe ekonomike të gjendjes në Kosovë dhe ju e dini, i cili është aprovuar diku më 28 shkurt të vitit të kaluar dhe ka mund të fillojë të ekzekutohet më 26 mars të vitit të kaluar. Pa marrë parasysh të gjitha

sfidat që i kemi pasur, qofshin në rrafshin politik, të sigurisë e tjera, një deputet këtu e tha me shumë saktësi se shifrat janë kokëforta, evidentet janë kokëforte dhe nuk dëgjojnë as përpjekjet minimizuese, as ato të panevojshme maksimizuese, ato janë të sakta, flasin vetë. Nuk dua të ekzagjeroj, dua vetëm të reflektoj ato shifra të cilat janë në raport në të cilin Ministria e Ekonomisë dhe Financave është përpjekur që në mënyrën më profesionale të mundshme të paraqet realitetin pa asnjë devijim të standardeve profesionale që i kërkon një raport financiar dhe ato konsideroj që nuk është as e njerëzishme, as e moralshme, as profesionale të bëhen përpjekje të minimizohen dhe nuk ka nevojë as të rriten. Ato janë fakte dhe faktet, më lejoni vetëm t'i shpjegoj dhe do përpiqem t'i them vetëm tri gjëra, duke u përpjekur t'i rrumbullakoj shqetësimet e juaja që u paraqitën.

Konsideroj që pati edhe vërejtje profesionale, të cilat sigurisht ne do t'i marrim parasysh që në raportet tjera financiare t'i reflektojmë maksimalisht. Por, më tepër u fol dhe më vjen keq që u ekzagjeruar shumë tema, u fol për tema të cilat mbase nuk i takonin fare temës për të cilën jemi mbledhur sot. Unë, si ministër i Ekonomisë dhe Financave, dua të përgjigjem në dy gjëra: Raporti i përmbush standardet profesionale të raportimit financiar, absolutisht, në të gjitha standardet profesionale.

Dy, përmbajtja e tij reflekton realitetin në terren, i cili shpreh shumë sende, se 13,7% janë rritur të hyrat, nuk kontestohet kjo, pa marrë parasysh, e dini sa problemet që i kemi pas në kufij në veri, e dini sa jemi në situatë të vështirë për të realizuar sundimin e ligjit në gjithë terrenin dhe megjithatë shifra është ajo dhe kemi një ngritje 46,3% në nivelin komunal. Se si janë menaxhuar paratë në agjencitë buxhetore, konsideroj se sot u fol së tepri, ende pa u dëgjuar raportet e auditimit dhe këtë e cilësoj jo profesionale dhe jo etike për të keqpërdor një foltore dhe shfrytëzuar, e kam fjalën një moment elektoral për secilin nga ju dhe duhet të presim auditorin për të vlerësuar se si janë shpenzuar këto para publike nga secili ministër, përkatësisht secili udhëheqës i buxhetit. Unë shpresoj shumë fuqishëm se ato do të reflektojnë realitetin i cili, besoj, të paktën në bazë të drafteve që i kemi marrë, është shumë, shumë më i mirë se sa vitin e kaluar ose shumë më i mirë se para disa vite dhe kjo tregon një progres për të gjithë qytetarët e Kosovës, natyrisht, me një lidhësi të qartë të Qeverisë së Kosovës.

Më lejoni vetëm dy elemente, dy përgjigje t'i jap sa i përket – një, duke e respektuar shumë profesorin e nderuar, Sabri, për komunën e Podujevës dhe mbase nuk kam qenë prezent fizikisht gjithë herë, po kam edhe disa përgjigje të veçanta ndaj disa deputetëve.

Profesor i nderuar, unë do t'i shfletoj vetëm disa të dhëna të cilat i keni ju raport për komunën e Podujevës. Në buxhetin e aprovuar, komuna e Podujevës ka pasur 2.394.614 euro në buxhetin e vet të drejtpërdrejtë dhe....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ia vazhdoni kohën!

MINISTRI AHMET SHALA: ... i ka shfrytëzuar 99,2% të mjeteve. Vetëm në shpenzime kapitale ka pasur 2.157.000 euro, ndërsa në financime së bashku nga qeveria qendrore përmes Ministrisë së Transportit ose të ministrive tjera, ka edhe ekstra 4 milionë të tjera, të cilat reflektohen në raportet individuale të secilës ministri e që reflekton përafërsisht mesataren e investimeve nëpër komuna karshi proporcionit të popullsisë ose nevojave që ka pasur në projektet e veta.

Dy gjëra mbeta t'i shpjegoj, që u paraqitën dhe që dhanë konfuzion mbase, sidomos në ruajtjen e parave dhe se ku janë investuar paratë publike të Kosovës. Ju, të nderuar deputetë, me Ligjin që e keni aprovuar, keni miratuar se menaxhues i parasë publike në Kosovë dhe jashtë Kosovës është Banka Qendrore e Kosovës, e cila investon paratë e buxhetit të Kosovës, paratë e fondeve të tjera konform praktikave më të mira dhe mundësive më të mira, qofshin ato në Kosovë, qofshin ato jashtë Kosovës. Unë sugjeroj që për informacione më të sakta, pa dhënë ndonjë konfuzion se Ministria e Financave... apo tjetër është organ i juaj, ju e thirrni kryetarin e bordit ose guvernatorin dhe ai ju paraqet se në bazë të ç'kasë dhe të cilave politika jeni duke i shfrytëzuar ato para dhe si janë duke u shfrytëzuar ato para ose si janë duke u investuar në botën e jashtme.

Ana tjetër e jona është që, si Qeveri, ne po përgatisim Ligjit mbi huat dhe ligjet e tjera të cilat do t'i sjellin këto para në vendin tonë dhe këtë vit, shumë shpejt, këtu në Parlament besoj që brenda dy javë dite do të vijë Ligji për huat publike, i cili paraqet edhe menaxhimin, përkatësisht përpjekjen për të kthyer paratë e investuara jashtë Kosovës, atë q e kemi premtuar.

Edhe një diçka tjetër dhe po e përmbylli. Unë sinjerisht i kam marrë me shumë seriozitet të gjitha sugjerimet dhe kritikën konstruktive dhe do përpiqem që me stafin tim t'i reflektojmë në raportet e ardhshme për çështjen e politikave investuese, politikave ekonomike, mënyrave të rialokimeve të tjera, ato janë tema tjera të cilat në ndonjë seancë që saktësisht i adresohet temës së caktuar, mund të debatojmë. Ne do përpiqemi që rregullisht të informojmë këtë audiencë të nderuar dhe, përmes juve edhe popullin e Kosovës dhe të gjithë të interesuarit, për të gjitha zhvillimet që janë bërë në Kosovë në mënyrë që vetë të përmirësohemi dhe vetë t'u japim mundësi të tjerëve të na sugjerojnë dhe kritikojnë.

Kam kënaqësinë gjithëherë që, siç e keni vërejtur, në çdo raport kemi përmirësime edhe në aspektin profesional, por edhe në aspektin e strukturës së materialeve, por edhe të menaxhimit të parasë publike. Tek e fundit, flasin raportet e institucioneve ndërkombëtare sa i përket kësaj, flet raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili për herë të parë në dhjetë vitet e fundit është raporti më pozitiv që ka pasur ndonjë qeveri e Kosovës.

Me kaq po e përmbyll, duke shpresuar që në seancat e tjera do fokusohemi më shumë për temën se sa për mënyrat tjera. Tek e fundit, është çështje e secilit individ për të debatuar, por po të ishim më racional, sigurisht nuk do të kishim mbetur duke debatuar kaq shumë për këtë temë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Edhe unë të falënderoj për gjuhën demokratike që e ke shfrytëzuar. Falënderoj edhe opozitën, mendoj që gjuha ka qenë në kufij të demokracisë dhe është mirë që po krijohet një traditë e debatit pa zhurmë të mëdha. Është koha që vërtetë të shkojmë, do të thotë t'i respektojmë rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili ka sjellë dy rekomandime. Në rekomandimin e parë thotë se raporti i plotëson standardet financiare dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe rekomandimi i dytë është që kërkon nga Kuvendi që të miratohet Raporti financiar i Buxhetit të konsoliduar të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2008. Andaj, është koha që ta qesim në votim.

Lus deputetët dhe regjinë, të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Në sallë janë 70 deputetë.

A ka pa kartela? Një! “Për”.

“Kundër” a ka pa kartelë? Një. Faleminderit!

Me 44 vota “për”, 22 “kundër” 2 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin e shpenzimeve për vitin 2008.

Të nderuar deputetë, ju e dini që nga seanca e kaluar na kanë mbetur dy pika e pak më tepër. Nëse jeni dakord, i vazhdojmë sot.

Atëherë, kemi propozim, nesër ose të enjten e ardhshme. Të enjten e ardhshme, data 18.06.2009, në ora 10:00, vazhdimi i seancës së djeshme. Ju falënderoj dhe mirë u pafshim të hënën!

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale